

PARATHËNIE

Fillojmë me emrin e Zotit, Dhurues i Pashoq, Mëshirues i Pashembullt.

Dëshmoj me zemër dhe vërtetoj me gojë se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut dhe robi i Allahut.

O i Madhi Zot! Derdhi bekimet Tuaja mbi Profetin Muhammed, familjen e tij dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë besimtarët e sinqertë dhe na bëj prej tyre!

Dy prej parimeve të të gjitha feve qiellore janë:

1- Besimi në një Zot të Plotpushtetshëm, që nuk ka nevojë për askënd dhe që çdo krijesë varet prej Tij e ka nevojë për Të.

2- Besimi në Jetën tjetër, ku çdo njeri do të gjykohet dhe do të jetë përgjegjës për veprat e veta në këtë botë. Po të ketë bërë mirë, do të shpërblehet dhe po të ketë bërë ligisht, do të ndëshkohet.

Sikur njerëzimi të besojë në këto dy parime dhe të veprojë sipas tyre, do të sigurojë lumturinë në të dyja botët.

Në numrin 34 të “Bibliotekës Muslimane Shqiptare” botuam dhe mblodhëm në një libër predikimin dhe shpjegimin e sures së Fatihasë, të bërë nga dijetari dhe patrioti i mirënjohur, Haxhi Vehbi Dibra, që u shtyp për herën e parë në një seri artikujsh në “Zani i Naltë”, Tiranë.

Sot kam nderin t’u paraqit lexuesve të “Bibliotekës Muslimane Shqiptare” përmbledhjen e konferencës së mbajtur në njërën prej xhamive të Tiranës në muajin e shenjtë të Ramazanit nga dijetari i shquar Haxhi Hafiz Ismet Dibra, që u shtyp dhe kjo në seri artikujsh në revistën “Zani i Naltë” me titullin: “*A KA DYSHIM NË QENËJEN E ZOTIT?*”, një predikim me të

vërtetë madhështor në pikëpamje fetare dhe filozofike e me vlera të posaçme në kohën e sotme.

Për ruajtjen e këtij predikimi dhe të atij të Haxhi Vehbi Dibrës i detyrohemi të ndjerit Haki Sharofi, i cili pati mirësinë të mbante shënime dhe t'i botonte në revistën “Zani i Naltë”, që ai drejtonte.

Në këtë libër, përveç konferencës kemi botuar dhe një artikull të H. H. Ismetit me titull: “Ç’është Kur’ani”, marrë nga një numër i posaçëm i “Zanit të Naltë”, shtypur në muajin e shenjtë të Ramazanit të vitit 1933 dhe një jetëshkrim të shkurtër të H. H. Ismetit, shkruar nga Haxhi Faik A. Kasollja. Në këtë rast, e ndiej për detyrë të falënderoj zonjushën Nexhatije Bulej që mori mundimin të fotokopjonte pjesët prej “Zanit të Naltë” që më mungonin dhe z. Inxh. Amr Ez-Zejni, Kryetar i Zyrës së “Shoqërisë Mirëbërëse Botërore” të Kuvajtit në Tiranë, që pati mirësinë të lërë në dispozicionin e saj makinën kopjuese të zyrës së tij. Zoti i shpërbleftë me të mira!

Vetëm prej Zotit kërkojmë ndihmë dhe vetëm prej Tij presim sukses në ndërmarrjet tona fetare e kombëtare.

1 Dhul Ka’de 1413

23 Prill 1993.

Imam Vehbi Ismail


Haxhi Hafëz Ismet Dibra

Gjatë vjetëve 1932 - 1939 kam pasur rast të njoh pedagogun Haxhi Hafëz Ismet Dibra, i cili ishte edhe drejtor i Medresesë së Përgjithshme të Tiranës. Ajo atëherë ishte një shkollë e mesme me shtatë klasë, që ishte themeluar dhe mbahej nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Në atë shkollë të mesme pranoheshin me bursë nxënës, që kishin mbaruar shkollën fillore pesëvjeçare (më pas katërvjeçare). Në atë institucion arsimor, ku krahas lëndëve fetare zhvilloheshin në gjuhën shqipe edhe lëndë të tjera jo-fetare sipas programeve të shkollave të mesme të atëhershme të Shqipërisë, si edhe anglisht e arabisht, Haxhi Hafëz Ismeti dallohej midis pedagogëve të tjerë për kulturën e gjerë dhe autoritetin e tij. Këto përshtypje të mira për Haxhi Hafëz Ismetin kishte edhe vëllai im, Vexhhi Demiraj, i diplomuar në Universitetin e Kairos në degën e filozofisë dhe ish-pedagog në Medresenë e Përgjithshme deri në vitin 1945.

Haxhi Hafëz Ismeti ishte njeri fjalëpak, serioz, shumë i sjellshëm dhe me ndjenja shqiptarie, prandaj gëzonte një nderim të veçantë. Kishte kryer studimet e larta në Stamboll për teologji dhe njihte mirë, përveç turqishtes, edhe arabishten e persishten. Krahas punës drejtuese, në klasat e larta të Medresesë së Përgjithshme ai zhvillonte edhe lëndën e logjikës (arabisht) si edhe Gjylistanin e Saadiut (sipas origjinalit persisht), çka dëshmon se i njihte mirë këto dy gjuhë. Kishte një admirim të posaçëm për Saadiun dhe për letërsinë e vjetër persiane në përgjithësi. Por nuk di nëse ka lënë ndonjë dorëshkrim për lëndët, që zhvillonte, ose për ndonjë studim tjetër, që mund të ketë kryer. Në atë kohë nuk ishte bërë traditë që pedagogët t'i botonin ligjëratat e tyre qoftë edhe në formë dispensash. Në rast se ka lënë ndonjë dorëshkrim, është mirë që të botohet, jo vetëm për të nderuar kujtimin e një dijetari me vlerë, por edhe për të pasuruar fondin e trashëgimisë sonë kulturore.

Tiranë, 18.02.2007

Shaban Demiraj



Fjala e Fondacionit

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

يُؤْتِي الْحِكْمَةَ مَنْ يَشَاءُ ۚ وَمَنْ يُؤْتَ الْحِكْمَةَ فَقَدْ أُوتِيَ خَيْرًا

كَثِيرًا ۚ وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٦٩﴾

**Ai (Zoti) ia dhuron urtësinë atij
që do e kujt i është dhënë urtësia,
i është dhuruar mirësi e madhe;
por këtë nuk e kupton tjetërkush,
përveç njerëzve të mençur.**

(Sure “El Bekare”: 269)

Kur’ani i Shenjtë është libri më i fundit dhe më i ploti i Allahut, i cili ka zbritur për udhëzimin e njerëzve. Ky libër është krejtësisht në përshtatje me natyrën dhe logjikën e njerëzve.

Historia dëshmon se në çdo kohë, kur njerëzit, në përgjithësi dhe myslimanët, në veçanti i janë drejtuar Kur’anit, kanë fituar qytetërimin, lumturinë dhe krenarinë. Por, historia dëshmon edhe se kur ata u larguan nga Kur’ani, ose kur u mjaftuan vetëm me kuptime sipërfaqësore të tij, nuk kanë arritur t’i gjejnë qytetërimin, lumturinë e krenarinë e kërkuar. Allahu (që qoftë i Madhëruar!), me mirësinë e Tij, nuk i ka lënë njerëzit në asnjë kohë pa udhërrëfyes, që t’i drejtojnë ata

drejt vlerave të larta njerëzore e morale. Këtë mirësi të Allahut e kanë shijuar edhe shqiptarët gjatë shekujve, veçanërisht në të shkuarën, kur në gjirin e tyre ka pasur njerëz të shquar e të ditur. Edhe pse kushtet dhe situatat e atëhershme kanë qenë të vështira, pena e tyre nuk ka pushuar së shkruari për Islamin dhe për kulturën islame. Është nder i madh që t'i përkujtosh e t'i përmendësh dijetarët e shkuar, sepse njihemi edhe më shumë me ta dhe me punën e tyre aq të madhe.

Siç dihet, Fondacioni i Kur'anit në Tiranë, krahas veprimtarive për përhapjen e kulturës kur'anore, po tregon një interesim të veçantë për ribotimin e ringjalljen e trashëgimisë islame në Shqipëri. Për këtë arsye, pas botimit të librit “Ajka e kuptimeve të Kur'ani Kerijmit” të Hafiz Ibrahim Dalliut, këtë radhë, Fondacioni sjell në duart dhe në bibliotekën e shqiptarëve librin me titull “A ka dyshim në qenien e Zotit” të Hafiz Ismet Dibrës.

I ndjeri Hafiz Ismet Dibra, me dhantitë e dhuruara nga Allahu (që qoftë i Madhëruar!), edhe pse përballë me vështirësi të ndryshme, arriti të kishte suksese në veprimtaritë e tij të çmueshme për edukimin kur'anor të brezave me shkrime, botime, hytbe, vaze e leksione të ndryshme. Të gjitha veprimtaritë e tij të çmuara e kanë burimin te lidhja e tij e përzemërt me burimin e përhershëm - me Kur'anin: Ismet Dibra ishte hafiz Kur'ani. Hafiz Ismet Dibra ishte i ditur e largpamës në mendime. Kjo dije e kjo largpamësi duket edhe në këtë libër: ai merret me emra të njohur dijetarësh botërorë.

Nuk ka dyshim se nderimi i këtij personaliteti do të thotë nderim për mësimet e Kur'anit dhe lartësim i urdhrave e i porosive të Allahut, siç thuhet në Kur'an: ***“Kush i madhëron shenjat e fesë së All'lahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.”*** (Sure "El Haxhaxh": 32).

Sigurisht, në këto pak rreshta nuk mund të thuhet e tërë ajo që meriton kjo figurë e madhe. Por jemi të bindur se cilido që do ta lexojë këtë libër, do ta njohë më së miri atë.

Fondacioni i Kur'anit është krenar që paraqet te lexuesit një dritë. Është drita e një prej gjurmëve të këtij dijetari të madh e atdhetar.

Së fundi, duam të shprehim konsideratën tonë dhe falënderimet tona më të përzemërta për të gjithë ata e për të gjitha ato që punuan për përgatitjen e këtij libri, veçanërisht për mësuesin modest të Kur'anit, të nderuarin Faik Kasollja, i cili ka vjelë dhe tubuar tërë lëndën për botim.

Lusim All'llahun e Plotfuqishëm që të na japë sa më shumë mundësi që t'i shërbejmë Librit të All'llahut, Kur'anit të Shenjtë.

Drejtori
Hossein ASADI

Duke rrëmuar në kujtesë për një njeri të madh

Së pari, dua të falënderoj Fondacionin e Kur'anit, i cili, duke bërë ribotime të tilla, nxjerr në shesh vlerat e teologëve myslimanë, që kanë qenë nga më të shquarit e popullit tonë. E konsideroj veten të nderuar që ky Fondacion më zgjodhi edhe mua për të rrëmuar në kujtesën time dhe të shkruaj dy fjalë në respekt të këtij teologu të shquar.

Sa më tepër që njeriut t'i kalojë mosha, aq më shumë i dobësohet kujtesa dhe kjo shkon në përpjesëtim të drejtë edhe me nostalgjinë e viteve të hershme të rinisë, sidomos të asaj rinie që ka kaluar në shkollë të mesme. Në atë kohë njihesh me njerëz, merr dijeni që do të të shoqërojnë tërë jetën e si pasojë, të nguliten mbresa të pashlyeshme.

Sot, ne brezi i vjetër krenohemi që kemi mbaruar një shkollë të tillë, siç ka qenë Medreseja e Përgjithshme e asaj kohe, pavarësisht se kanë kaluar gati gjashtë dhjetëvjeçarë. Në atë shkollë ne u pajisëm me dijeni fetare, natyrisht, aq sa ishte programi, si edhe me programin e mësimëve të lëndëve të përgjithshme.

Për të zbatuar programet e veta, shkolla kishte një personel mësimor të papërsëritshëm më vonë. Pjesëtarët e këtij personeli arsimtarësh jo vetëm që ishin specialistë të zotë të lëndës që jepnin, por ishin po aq të aftë për të edukuar nxënësit e vet për ta përballuar jetën me ndershmëri. Çdonjëri prej tyre kishte karakteristikat e veta – përgatitjen e përgjithshme dhe të veçantë për lëndën që jepte, cilësi dhe virtyte të veçanta. Ndër ta, më ka mbetur në mendje njëri, që të bënte përshtypje si për paraqitjen e tij si hoxhë – me një veshje me shije të veçantë, që e dallonte nga hoxhallarët e tjerë, por, sidomos, për dijenitë e autoritetin, që të impononin respekt. Dijenitë e tij ishin të thella jo vetëm në teologjinë islame, por edhe në shumë tema të tjera të shkencave sociale, si filozofi, histori, letërsi etj. Na fliste për mendimet e

filozofëve grekë, duke shtjelluar shpesh parimet e *Aristos*, siç e thërriste Aristotelin. Ky ishte i ndjeri Hafiz Ismet Dibra.

Ka qenë një nga vendimet më të qëlluara të Komunitetit Musliman zgjedhja e Hafiz Ismetit si Drejtor i Përgjithshëm i Medresesë. Ai, për aq kohë sa qëndroi në krye të kësaj shkolle, e bëri atë model, si në hartimin e zbatimin e programit mësimor, unikal jo vetëm për vendin tonë, por në ato kohë edhe për Ballkanin, ashtu edhe në edukimin e nxënësve të saj.

Hafiz Ismetin do ta njihte çdo nxënës i Medresesë para se të fillonte të merrte mësim nga ai. Kjo ndodhte sepse për të do t'i flitnin me superlativa nxënësit e viteve të mësipërme. Kështu që respekti të ishte imponuar, para se të filloje të merrje mësim prej tij.

Me sa më kujtohet, në klasën tonë ai ka dhënë pak orë mësimi të gjuhës persiane dhe tefsir – koment Kur'ani. Megjithëse persisht kemi bërë rreth një vit me nga një a dy orë në javë, ai të tërhiqte në këtë lëndë, sepse e bënte mësimin interesant me tregimet e shkurtra, si fabula me përmbajtje filozofike etj. – karakteristika të kësaj gjuhe. Ndërsa komentet e Kur'anit i bënte shumë interesante. I emocionuar edhe vetë, ai, me

gojëtarinë që e karakterizonte dhe me shpjegimet që i bënte me një kompetencë për t'u patur zili, krijonte në klasë një mjedis sa të emocionuar, aq edhe të vëmendshëm; kështu, qetësia dhe vëmendja e nxënësve ishin absolute. Shpeshherë, për të dëgjuar komentet e tij, vinin edhe profesorë të lëndëve të tjera. Hafiz Ismeti gëzonte një respekt të jashtëzakonshëm te mësuesit e Medresesë, ndërsa nxënësit e konsideronin veten të privilegjuar sa herë dëgjonin *selamin* që jepte profesori i dashur.

Nga Hafiz Ismet Dibra më kanë mbetur kujtime të përgjithshme, që e bëjnë të pashlyeshme në kujtesë personalitetin e tij dhe e quaj veten, sikurse të gjithë të tjerët që kanë dëgjuar mësimet e tij, me fat që e kam pasur mësues dhe se mësimet e tij janë një nga faktorët e formimit të botëkuptimit tim teologjik islam. Zoti ia pastë shpërblyer!

Ndër kujtimet që më vijnë në mendje për të do të përmend dy – tre raste që më janë ngulitur fort në kujtesë. Kështu, kur Hafiz Ismeti u arrestua, ishte opinioni absolut dhe i përgjithshëm si i nxënësve, ashtu dhe i gjithë personelit të Medresesë se arrestimi i tij ishte i gabuar: ai ishte i pafajshëm. Të gjithë shprehnin keqardhjen e thellë për atë që po ndodhte

në shkollë me arrestime të edukatorëve tanë, për të cilët ishte e paimagjinueshme se mund të ishin mëkatarë në ndonjë fushë! E vërteta, megjithëse vonoi, doli në shesh – ata lloj arrestimesh, me ardhjen e demokracisë, u dënuan publikisht dhe institucionalisht nga opinioni publik – gjë që ne ish-nxënësit e kishim bindje që në kohën kur ndodhën.

Më kujtohet një rast, të cilin, unë për vete e konsideroj si habi, që dëshmon horizontin e gjerë të Hafizit në fushën e letërsisë. Nga fillimi i viteve '50-të të shekullit të kaluar, – në ato kohë unë kisha mbaruar dhe punoja në Medrese si drejtor konvikti, duke dhënë edhe lëndën e historisë së përgjithshme, erdhi në shkollë, i dërguar nga Instituti i Shkencave, punonjësi i atij Instituti, prof. Osman Myderrizi. Ai erdhi për të parë në bibliotekën e shkollës, që kishte rreth 3000 vëllime, nëse mund të gjente ndonjë material për “bejtexhinjtë” dhe punoi disa javë aty. Biblioteka ishte në një sallë së bashku me drejtorinë e shkollës dhe me sallën e pedagogëve. Një ditë u habita kur pashë Hafiz Ismetin duke biseduar me Osman Myderrizin për bejtexhinjtë. Ai i shpjegonte prof. Myderrizit se deri ku bejtexhinjtë u ishin përmbajtur parimeve të Kur'anit në krijimet e veta; pra, Hafiz Ismeti, jo vetëm që

kishte dijeni për krijimet e tyre, por u bënte edhe kritikën. Vite më vonë m'u dha rasti të bisedoja me prof. Osman Myderrizin duke ia kujtuar këtë episod. “Ai ishte klerik i kompletuar dhe çdokush ka dëshirë të bisedojë me klerikë të tillë”, – ma ktheu punonjësi shkencor i Institutit të Shkencave. Dua ta mbyll me një kujtim të fundit për këtë shkrim, por jo i fundit në kujtesë. Në fillim të viteve '50 të shekullit të kaluar, njëherë, një polic më rrëmbeu biçikletën për të ndjekur një keqbërës. Unë u detyrova të shkoj në Rajonin e Policisë ku, siç u informova, kishte përfunduar polici, keqbërësi dhe biçikleta. Po prisja jashtë në postbllok për të sqaruar çështjen. Kaloi i ndjeri Hafiz Ismeti dhe, sapo më pa, u prish në fytyrë dhe ma bëri me shenjë që ta ndiqja. Më pyeti “Si asht efendiu?” – e kishte fjalën për tim atë. Ndoshta, kishte menduar se do ta kishin arrestuar! Në ato kohë mund të ndodhte gjithçka dhe të vinte nga nuk e prisje. Iu përgjigja se ishte mirë. “Po ti ç'ban aty atëherë?!, – më pyeti. Ia shpjegova çështjen e biçikletës. “Lene fare dhe ik prej aty!” I ndjeri, kishte parë *mysybet* dhe nuk donte të kishte të bënte fare me organet qeveritare të asaj kohe.

Një pjesë e hytbeve dhe vazeve të Hafiz Ismet Dibrës, shumë të vlefshme se në to trajtohet çështja e monoteizmit, kanë ardhur deri në ditët tona, falë aftësive të publicistit të njohur Haki Sharofi, që ka qenë i pranishëm në ato hytbe dhe vaze, ka mbajtur shënime, të cilat i ka plotësuar duke biseduar në shkollë me të për gjërat që nuk kishte mundur të mbante shënim dhe i ka botuar në “Zanin e Naltë”. Në fillim të viteve ‘50-të Hafiz Ismeti predikonte për ditë të premtë te xhamia e Bërxollit – një xhami e vogël, në rrugën Ali pashë Gucia, që lidh Rrugën e Dibrës me rrugën “Katër Dëshmorët”. Xhamia mbushej plot shumë kohë para namazit të xhumasë. Njerëzit vinin të dëgjonin fjalët e Zotit, të predikuara nga njeriu i mirë dhe i ditur – Hafiz Ismet Dibra, ndjesë pastë!

Ali

Musa Basha

Maturant i Medresesë së

Përgjithshme

gjatë vitit shkollor 1950 – 1951

Tiranë, më 11 shkurt, 2007

H. H. Ismet Dibra, *A ka dyshim në qenëjen e Zotit?*

Ndër dijetarët e shquar në fushën e komentimit të Kur'anit (Tefsirit) është edhe Hafiz Haxhi Ismet Dibra¹. Në vitet '20 përkthyen e botuan Kur'an I. M. Qafëzezi e H. Ibrahim Dalliu. I pari përktheu 6 sure. I dyti përktheu e komentoj 7 sure. Në vitet '30 komenton Kur'an H. Ismet Dibra në sa e sa foltore e në revistën “Zani i Naltë”. Libri i tij që kemi në duar është “A ka dyshim në qenëjen e Zotit?”. Pjesa e parë e librit është argumentim teologjik, filozofik e shkencor; pjesa e dytë është shembullsim nga krijesat e Zotit. Me argumente nga Kur'ani² e me shembuj nga zbulimet shkencore (në parantezë, ai thotë se shkenca nuk ka zbuluar më shumë se ç'ka thënë Kur'ani), ai vërteton për një “mendje të vërtetë” (fjalët në thonjëza janë të tijat), se Allahu ekziston dhe është vetëm Një Zot. Ndonëse para 70 vjetësh, komentet e tij janë mjaft bashkëkohore e mjaft aktuale.

¹ Personaliteti i tij si teolog, si dijetar, si erudit, si mësues e si edukator pati ndikim të madh jo vetëm në rrethet klerikale islame, por edhe më tej. Nga botimet e tij në “Zani i Naltë”, duket se ka pasur rreth të gjerë lexuesish e dëgjuesish entuziastë. Shih për jetën e jetëshkrimin e tij në shkrimin e F. Kasolles, në H. I. Dibra, *A ka dyshim në qenëjen e Zotit?*, Albanian Islamic Center, Harper Woods, Mich., USA, 1993, f. 3-5.

² (Renditja e sureve dhe e ajeteve është sipas faqeve të librit):

Ngjyra e njerëzve 30:22; *Zoti* 14:10; 38:180; *Pyesni dijetarët* 16:43; *Këta njerëz* 2:7; *Uji* 21:30; 79:30-32; *Lajmet historike të Kur'anit* 12:111; *Peripecitë e profetëve* 11:120; *Namazi* 29:45; *Xhindet* 51:56; *Erërat* 2:164; 15:22; *Ringjallja* 26:79; 75:3,4; *I treti i të treve, jo*: 5:73; *Krijimi i njeriut* 23:115; *Devetë* 16:5; *Kur'ani* 41:53; 6:59; *Të njohim Zotin* 44:38, 39; *Një frymë e vetme* 7:189; *Vozitin në hapësirë* 36:40; *Më i ndershmi* 49:13; *Vetja* 2:286; 74:38; *Islami* 48:28; *Feja jonë* 22:78; *Drejhtësia* 16:90; 9:24; *Zekati* 2:195; *Fjala e Zotit e pafund* 18:109; *Kundërshtari* 2:194; *Profeti ynë, me mision universal* 34:28; *Mëshira e Zotit* 12:87; *Shpëtimi* 7:99; *Rruga (e drejtë)* 7:99; 24:46; 28:56; *Ai që di* 39:9.

Komenti i H. I. Dibrës nuk është vetëm për elitarë e lexues të formuar, por edhe për të tjerë. Ai është njëherësh edhe popullarizues. Është i hapur. Nuk ka deklarime të thata fetare, por vetëm argumentime e interpretime teologjike-shkencore. Ai bën thirrje të shihet e vërteta, të hiqen syzet e errëta. “Me syze të errëta, - thotë ai, kurrë nuk mund të shikohet e vërteta.” Besojmë të jenë të mjaftueshme ajetet që janë përmendur në libër nga autori. (shih te poshtëshënimi 2).

Receptimi i veprës së tij është i gjerë; çdo lexues e kupton. Një nga arsyt pse kjo receptohet gjerë është te veçoritë e ligjërimit të tij. Shpjegimet e komentimet janë të shkurtra, por aq të shkurtra sa ta japin të plotë e të kuptueshëm thelbin e ajetit a të çështjes. Ai ka një frazë të plotë e shumë shtjelluese. Konteksti i tij mjafton për të kapur kuptimin. Ai ka një rrjedhë, nuk ka shkëputje, as kuptimore e as formale. Nga mendimi në mendim, vepra ka një njësim të brendshëm.

H. I. Dibra përgatit mjedisin për koment. Paraqit temën e përgjithshme: një pyetje retorike, “A ka dyshim në qenëjen e Zotit?”. Vjen ajet pas ajeti, për të na përgatitur

për tekstin e tij. Secili tekst i tij lidhet me ajetin të cilit i referohet. Në vijimësinë e tyre mund të rroket pamja e përgjithshme e përmbajtjes së librit dhe përgjigjja: Ka Zot.

H. Ismeti përdor dijet e shkencës, si edhe përvojën e vet, por nuk ndërfit çështje a lëndë të pavend, që nuk lidhet me temën në komentet e tij. Ai merret me shkencëtarë të mëdhenj në polemikën e tij – me Dekartin e Njutonin, Maks Mylerin e Volterin, Demokritin e Pirhonin, Spenserin e Losipin, Aristotelin e Platonin etj. dhe i lë kokulur ata që mundohen ta kundërshtojnë qenien e Zotit.

Autori ndjek edhe komentues të tjerë – Hafiz Shirazin e Imam Gazaliun etj., por ka sjellë edhe mjaft gjykime të veta origjinale me vlera të konsiderueshme. Ai ka sjellë interpretime, komentime e shpjegime të qëndrueshme. Disa nga këto komentime e shpjegime mund të cilësohen me vlerë antologjike. Përveçojmë: ringjallja fizike e njeriut edhe me mollëzat e gishtave, përngjizja e botës, trupa të shkëputur nga amat e tyre, Islami si fe mendore, premiset e ekzistencës, ç'është hipoteza, yjet, hetimet e zbulimet zoologjike, skepticizmi, paganizmi, myslimani të përmirësojë e të plotësojë të dyja jetët etj.

Çdo ajet i dhënë për një argumentim të caktuar jepet me kuptim të veçantë dhe me kuptim të përgjithshëm. Mendojmë se veprohet drejt sepse kuptimi i përgjithshëm e edhe zbatimi i përgjithshëm i një ajeti mbeten të vërteta të përgjithmonshme. Nuk është as zbulim imi e as thënia ime: çdo lexues e studiues serioz i Kur'anit ka kuptuar se sa më shumë që ecën në leximin e studimin e tij, aq më shumë do të gjejë se si ky kuptim i përgjithshëm rritet duke u rritur aftësia e tij për t'i rrokur gjërat. Është si rasti i një alpinisti që, sa më lart ngjitet në mal, aq më larg sheh. Libri i H. Ismet Dibrës është një udhërrëfyes në ngjitjen tonë alpinistike. I tërë libri argumenton shkencërisht qenien e Zotit dhe na thotë se udhëheqësinë mund ta marrim vetëm nga Zbulesa e Zotit, nga Kur'ani.

Ia donte puna e komentimit që ajetet kur'anore t'i përkthente. Në këtë mënyrë, ai është edhe përkthyes Kur'ani. Përkthimi në shqipe bëhet krahas tekstit në arabishte. Njihen vështirësitë e përkthimit të arabishtes kur'anore, si gjuhë klasike e stilit të lartë. Megjithatë, teksti në shqipe nuk është një zëvendësim i thjeshtë i kësaj a i asaj

fjale të arabishtes, por shprehja më e mirë a më e saktë për kuptimin më të plotë që ka rrokur H. Ismeti nga teksti arab.

Në parathënien e botimit thuhet se “A ka dyshim në qenëjen e Zotit?” ka qenë një varg leksionesh, botuar më pas në revistën “Zani i Naltë”. Libri është një ese e fuqishme teologjike-filozofike. Në këtë a atë shkallë del karakteri polemik, karakteristik për esetë që fillojnë me pyetje retorike. Konstruktet pyetëse ekspresive edhe më tej, me cilësi retorike e përforcuese-emocionuese e rrisin tonin e esesë. Filozofemat islame e termat nga shkencat natyrore e bëjnë tekstin e tij ligjërimit të mirëfillt shkencor (shih terma të Islamit dhe të Kur’anit - *ajet, sure, Njitim, Ahiret, i Plotmëshirshëm* etj., të botanikës, të zoologjisë, të matematikës, të astronomisë, të gjeografisë, të fizikës, të optikës, të akustikës, të filozofisë etj.: *polenizim, fekondim, fiziolog, meteorolog, algjebër, trigonometri, doktrinë sociologjike, dogmë, subjektiv, objektiv, tezë, hipotezë, entitet, atom, amë (trupa të shkëputun nga amat e tyne), eterik (atome eterike), korelacion, proporcion, atomistik (teorika atomistike), dualizëm, çiftëzim, eliptikë (eliptika e diellit), atraksion (ligji i atraksionit), dogmë, subjektiv,*

objektiv, yje me dritë, yje pa dritë, yje rrotullues, yje qiellorë, monoteizëm, politeizëm, botëkuptim, sofizëm etj.

Stili i polemikës kërkon antiteza e antonime, aforizma, sinonime e epitete, ironi e patetikë, pyetje retorike, citime nga kundërshtari e edhe diskreditim të kundërshtarit etj. Ai përdor të parat³, por jo të fundit. Ai nuk e ironizon e as nuk e diskrediton kundërshtarin, sepse s'kishte nevojë, sepse ishte i mjaftueshëm argumenti (ajeti) i Kur'anit dhe argumentimi i tij teologjiko-shkencor, por edhe sepse kishte etikën fetare-shkencore. Ai nuk e përdor maksimalizmin stilistik të hiperbolizimit, sepse as Kur'ani, as argumentimet e tij nuk kishin nevojë për zmadhime; e vërteta nuk ka nevojë të zmadhohet. "Islami, - thotë ai, - asht fe mendore".

Në veprën e H. Ismet Dibrës nuk ka elemente të gjuhës së folur krahinore - bisedore, as të idiolektit të tij, as krahinorizma fonetikë të së folmes së tij, sepse ai e dinte se

³ Shih në libër të tilla antiteza, antonime, sinonime e epitete etj.: "Gjuha e të mençmit asht mbrapa mendjes, kurse mendja e të trashit asht mbrapa gjuhës" (thënie e Imam Aliut); // *tinëzisht / faqësisht; i sosun / i pasosun; // me syze të errëta kurrë nuk mund të shikohet e vërteta. // i shfaqun e i manifestuem; i padukun e i fsheftë; // mysliman i vërtetë, mbrojtësit e vërtetë, betime të thella, vëllazëria njerëzore, paurtësi e madhe dhe e pafalshme, hipotezë e gabuar, absurde, mendje njerëzore e pjekur, në kohën e lumnueshme, edukues i vërtetë, ndërgjegje e kullueme, e vërtetë e dështuar, dogmë e drejtë* etj. Ai shquhet për përdorimin e figurshëm të mjeteve shprehëse, me vlerë stilistike: *Kur'ani* – **kroi** i teologjisë; **gurra** e shumë diturive të tjera; **ka shkye perdet** e errëta; **shtegu** i arsytimit; **breshër** kritikash; **ra në tallazet** e dyshimit; e vërteta **i rrëshket** prej dore; merr **dritën** e arsytimit; përtej **gardhit** të shkencës etj.

kështu do të humbiste pesha e argumentimeve, kurse në përkthimin e ajeteve do të humbiste stili i lartë i arabishtes kur'anore. Autori shfrytëzon fjalë të gjithëpërdorshme të shqipes: *i shtangët* (ti shikon malet që duken të shtangët), *të madh* (perëndia me të madh të vet), *mollëz* (mollëzat e gishtave), *pajoj* (Zoti pajoi me mend), *tërthoras* (paralajmëron tërthoras), *lagje* (grup) (nji lagje atomesh), *krahinë* (të gjitha krahinat e botës), *nuse* për *nimfë* (në zoologji) (nga krimbi i fluturës del nusja), *motmot*, *shpërngulet* (në zoologji), *e shtrime* (përmasë) (*i mungojnë të tria të shtrimet gjeometrike*), *trajtoj* (formoj) (nuk mund të trajtojë trupa; janë trajtuar xehet), *fillor* (fillestar) (lënda fillore), *diktoj* (zbuloj; shoh, shquaj, dalloj) (*diktoj të vërtetën*), *mbëltoj* (mbjell; në kuptim të figurshëm: ngulit) (*këtë ndjenjë e ka mbëltuar*), *shtrohem* (*i shtrohem atij gjyqi*), *tëbanë* (*o thnegla, hyni në tëbanat tuaja!*) etj. Ndonjëherë përdor ndonjë fjalë të së folmes së tij (dibranishtes), por jo variant fonetik (*livroj* “lëviz”: *Dielli livron* etj.), që jo vetëm nuk e dëmton aspak kontekstin e tij, por është edhe me vlerë letrare potenciale për gjuhën shqipe standarde.

H. Ismet Dibra është njohës i thellë i gjuhës amtare e krijon ose gjen fjalë me brumin e shqipes e sipas rregullave të saj fjalëformuese; shih, p.sh.: *diktim (zbulimet dhe diktimet e reja)*, *i parakaluem (libra hyjnorë të parakaluem)*, *i përngjizun (bota asht e përngjizun nga ...)*, *paravumje, përzanëse, i prejshkaktuem (fenomene që u njohën si të prejshkaktueme)*, *patundshmëni, paurtësi, i hyjnueshëm, profetí, përngjitje e shqitje (në kimi / për bashkim e shpërbërje)*, *qenësi (fshehtësina të qenësisë)*, *prapësoj (teoria që prapësoi shumë figura të qenësisë)*, *parapamje ([kësaj teorie] nuk mund t'i mohohet dija dhe parapamja)*, *rregullues (Rregulluesi universal)*, *rregullimtar (Krijuesi rregullimtar)*; *shkaktues (agjent shkaktues)*; *faqësisht (tinzisht dhe faqësisht)*, *vendor (favorizime vendore e kohore)* etj.

Kujdesi i H. Ismet Dibrës për pastërtinë e gjuhës duket që tek titulli i veprës: ai nuk pëlqen fjalën e huaj *ekzistencë* por fjalën shqipe *qenëja*; në vend të *teuhid* parapëlqen termin shqip *njitim* e në vend të *insekt, kandërr* etj. Edhe kur përdor ndonjë fjalë të huaj, H. Ismet Dibra e përball me fjalën a me shprehjen shqipe në kllapa: *bon-sensi mendja e*

vërtetë; Ahiret jeta e amshuar; aksident e papritur; individualitet vetësi etj.

Sigurisht, për arsye gjuhësore dhe jashtëgjuhësore që dihen, nuk mund t'i kërkojmë H. Ismet Dibrës në vitet '30 të mos përdorte *polenizim, fekondim, korelacion, proporcion, korpuskul, atraksion, divinitet* etj., por përkatësisht *pjalmim, pllenim, bashkëlidhje, përpjesëtim, rruazë, tërheqje, hyjnorësi* etj.; por mendojmë se mund t'u ishte larguar disa fjalëve të huaja të panevojshme, sepse e ka njohur fjalën shqipe e ka edhe raste kur e përdor vetë diku tjetër në tekst: *eternel* për *i amëshuem (jeta eternele)*, *konviksion* për *bindje*, *evident* për *i qartë*, *deduksion* për *përfundim* etj. Mund të ishin shmangur edhe fjala *hyjnor (dekret hyjnor etj.)* dhe *Perëndi*. E para lidhet me *hyjninë*. Si *hyjnia*, ashtu edhe *perëndia* nuk e shenjojnë saktë konceptin *Allah*; hyjnitë e perënditë janë shumë; Allahu është vetëm Një. Megjithatë, këto dy vërejtje nuk e cenojnë aspak penën e tij të fuqishme dhe argumentimin e tij të fuqishëm.

Prof. dr. Hajri SHEHU

HAFIZ ISMET DIBRA, TEOLOGU, ATDHETARI, MËSUESI

1. Jeta dhe veprimtaria

Hafiz Ismet Dibra lindi në Dibër të Madhe, më 1886, kur armiq të tradicionalë përgatiteshin të gllabëronin copa të truallit shqiptar, kur jehona e Rilindjes Kombëtare kishte vënë në lëvizje çdo vatër arbërore, kur e gjithë bota shqiptare ishte ngritur më këmbë me pushkë e me penë për t'i dalë zot vatanit.

Mësimet e para Ismeti i nisi në Dibër. Mësimet e mesme i vazhdoi në Stamboll. Pastaj, me shumë zell iu fut studimeve të larta dhe u pajis me kulturë të gjerë në fushat e legjislacionit (shariatit) islam, filozofisë e logjikës, tefsirit (shkencës së komentimit të Kur'anit) e retorikës, historisë e shkencave të tjera islame, paralelisht me barasvlerësit e shkollave perëndimore të disa disiplinave mësimore, si: filozofia e

materializmit dhe historia e zhvillimit të tij etj. Atje përvetësoi në mënyrë të shkëlqyer gjuhët klasike të Lindjes: arabishten, persishten e natyrisht turqishten. Stambolli ishte qendra e mërgimtarëve shqiptarë. Studentët, tregtarët, klerikët e intelektualët me banim në brigjet e Bosforit ishin të parët që e kuptuan rëndësinë historike të Lëvizjes Kombëtare shqiptare. Hafiz Ismeti mbante lidhje të ngushta me veprimtarët rilindas të kryeqytetit turk dhe, nëpërmjet dibranëve që shkonin e vinin vazhdimisht, ishte i mirinformuar për gjithçka që ndodhte në Shqipëri.

Rol me rëndësi në formimin intelektual e atdhetar të tij kanë luajtur idetë e lëvizjes së vendeve të tjera islame. Një ndikim jo të paktë ai pati nga vepra “Islamizma dhe reformat në Egjipt” të dr. Çarls Adamsit (Charles Adams), që flet për njërin nga figurat madhore, Xhemaluddin Afganiun, i cili së bashku me nxënësin dhe bashkëpunëtorin e vet të ngushtë, shejh Muhammed Abduhun, kryemyftiun e Misirit, kishin udhëhequr Egjiptin në luftë kundër pushtimit anglez dhe kishin përgatitur reformën kundër besëtytnive e besimeve joislame, të futura me djallëzi nga misionarët e huaj me qëllim që të dobësohej Islami...

Pas mbarimit të shkollave, Hafiz Ismeti e zgjeroi shumë horizontin e dijes e të kulturës me studime vetjake dhe hyri shpejt në qarqet më në zë të njerëzve të ditur të kryeqendrës perandorake. Kjo ishte edhe arsyeja që njëra nga shkollat e larta të Stambollit i propozoi atij drejtimin e një katedre.

Takimet me bashkatdhetarët, bisedat e ngrohta e të mençura me ta, sjellja korrekte dhe e kulturuar ia rritën emrin e mirë (reputacionin) Hafizit. Në këto rrethana, më 1907-1908 ai fitoi një mandat përfaqësimi dhe u caktua delegat në Kongresin e Dibrës, (1909), ku përkrahu platformën kryesore, kundër ndonjë shfaqjeje të errët e të dëmshme për kombin. Këtë herë

Hafizi u prit me nderime, jo vetëm për misionin që kishte marrë mbi vete, por edhe si biri i njërës prej dyerve më të respektuara të qytetit. Tani, nuk ishte ai djali i rëndomtë, si të gjithë të tjerët; tani vinte në vendlindje njëri nga ata që përbënin ajkën e rinisë dibrane. Me vdekjen e babait, Hafiz Xhelalit, më 1919, Ismet Dibra e refuzoi detyrën e pedagogut në shkollat e larta turke. Pak a shumë, në këto vite që ngarkuar nga myftinia e Tiranës si ndërlidhës e për t'u kujdesur për dokumentacionin e vakëfeve në administratën turke; por ai nuk deshë të mbetej përgjithnjë në Turqi.

Pak më vonë, një grup intelektualësh atdhetarë që jetonin në Tiranë, e ftuan Hafizin të jepte ndihmesën e tij për organizimin e një instituti modern islam, për nevojat e Komunitetit Mysliman Shqiptar, për hapjen e medresesë së një tipi të ri, të një shkolle të mesme bashkëkohore. Hafizi pranoi dhe, me përkrahjen e pakursyer të Haxhi Vehbi Dibrës, Kryetarit të parë të atij Komuniteti, Mahmut Mahirit, Qamil Balës e Hafiz Ali Korçës, ia dolën mbanë më 1924. Pas vdekjes së Mahmut Mahirit, më 1929, drejtimi i Medresesë së Naltë iu besua Hafiz Ismetit. Më 1931 u përrua ndërtesa e re e medresesë (siç është sot) dhe shkolla u emërua: Medreseja e Përgjithshme.

Ai mblodhi rreth vetes pedagogë me përvojë, si Hafiz Ali Korçën, Shejh Qazim Hoxhën, Jonuz Buliqin, Haki Sharofin, H. Mahmud Dashin, Ihsan Qereshnikun etj.

Puna intensive në shkollë i hante shumë kohë, po ai e kreu me shumë përkushtim. Nga ato pak mbijetoja (relike) që ruajnë trashëgimtarët, të tërheq vëmendjen një fletore e vogël xhepi, fletore shënimesh me kapakë të zinj. Veç të tjerave, është një listë emërore e maturanëve të Medresesë të vitit shkollor 1950-1951, me notat që kishin marrë nxënësit në lëndët mësimore të Hafizit. Hafiz Ismeti nuk e njihte notën fiktive;

çdo nxënës e vlerësonte sipas meritës; dokumentet shkollore i plotësonte sistematikisht, edhe pse në atë kohë e kishte humbur detyrën e drejtorit (pas daljes nga burgu, siç do të thuhet më poshtë, ai bënte vetëm detyrën e pedagogut, derisa e nxorën në pension). Lëndët mësimore që kishte marrë përsipër i zhvillonte me pasion. Kështu, në mësimin e gjuhës persishte ilustrimet, shembujt, bisedat i zgjidhte nga veprat e klasikëve të letërsisë iraniane, si nga “Gjylistani” i Saadiut etj. Në lëndën e mësimin të Tefsirit (komentimit të Kur'anit) ai praktikonte një ecuri metodike origjinale:

1. Tekstin që do të përkthente fillimisht e shoqëronte me momentin historik dhe rrethanat e Zbulesës (Revelatës).
2. Pas shpjegimit të brendisë së ajeteve, bënte analizën e mjeteve gjuhësore e të figurave letrare.
3. Mendohej që për fjalët e vështira të sillte sinonime e antonime, me të cilat arabishtja është shumë e pasur. Hafizi kërkonte ta përforconte e ta përsëriste mësimin me qëllim që nxënësi ta përvetësonte atë.

Nga kujtimet e jetës shkollore, Imam Vehbi Ismaili, ish-Kryetar i Qendrës Islame të Shqiptarëve të Amerikës dhe të Kanadasë, ka shkruar:

“Unë kam pasur fatin të jem student në Medrese për katër vjet, kur ai ishte drejtor. Hafizi shquhej si një njeri i përvuejtë dhe shumë i drejtë me studentët, të cilët i donte si fëmijët e tij. Më kujtohet, një herë në një orë mësimi të historisë islame, ndërsa diskutonim rreth një ngjarjeje historike, i kundërshtova analizës së mësuesit. Këtë guxim timin mësuesi e quajti fyerje dhe meqë ishte kujdestar konvikti më dënoi që të mos dilja në qytet ditën e pushimit javor. Kjo masë m'u duk e padrejtë, prandaj shkova e iu ankova drejtorit. Duke qenë unë në zyrë, ai e thirri mësuesin. Porsa erdhi mësuesi, i tha:

- Pse e ke dënuar këtë student?
 - Më kundërshtoi në analizën e mësimit, - u përgjigj mësuesi.
- Atëherë H. Ismeti i tha:

- Ne këtu përpiqemi të edukojmë fetarë të lirë, të denjë për t'i shërbyer fesë islame.... Kur ne mendojmë se janë gabim, duhet të diskutojmë me ta, duke u sjellë prova për t'ua ndryshuar mendjen.... (Nuk dua të dëgjoj më dënime të tillat!) (Shih parathënien e librit “A ka dyshim në qenien e Zotit”, botim 1993, SH.B.A).⁴ Për gati 20 vjet që mbajti mbi supe detyrën e drejtorit, Hafiz Ismeti përpunoi dhe vuri në jetë një varg metodash të reja të mësimit, sepse ai thoshte: “Feja islame përdor njëqind mënyra për ta edukuar njeriun...”⁵ dhe këtij parimi didaktik i përmbahej në praktikën e punës së tij dhe e pasuronte vazhdimisht përvojën e vet në fushën e edukimit e të arsimimit të njeriut.

Ishte takti pedagogjik dhe bagazhi i tij kulturor që si studentët, ashtu edhe kolegët e respektonin dhe e ndjenin epërsinë e autoritetit të tij. Me sjelljen e tij ai të impononte respekt. Mes dijetarëve të Komunitetit Mysliman, Hafizi kishte një vend të privilegjuar. Vështirë ta paraqesësh figurën poliedrike të këtij intelektual bashkëkohor në tërësinë e vlerave njerëzore.

Ishte nisma e drejtorit dhe interesimi i drejtorit, që në inventarin e Medresesë të futeshin jo vetëm komoditete të jetës, të ushqimit a të fjetjes së konviktorëve, po edhe një sasi relativisht e madhe mjetesh mësimore. Ai pati krijuar laboratorët e lëndës së fizikës e të kimisë, mbeturinat e të cilëve i kemi gjetur edhe ende pas Luftës së Dytë Botërore.

⁴ “A ka dyshim në qenëjen e Zotit” përmban konferencën në disa seanca, mbajtur nga Hafiz Ismet Dibra përpara besimtarëve, intelektualëve e dëgjuesve të tjerë në vitin që u botuan, në disa numra të revistës “Zani i Naltë”. Imam Vehbi Ismaili i botoi këto biseda në një vëllim më vete në Michigan të Shteteve të Bashkuar të Amerikës, më 1993.

⁵ “A ka dyshim në qenëjen e Zotit”, f.32, MI., U.S.A., 1993.

Por ekzistonin vështirësi, gati të pakapërcyeshme. Siç dihet, leksionet e tyre pedagogët i paraqitnin me fjalë brenda një qarku të ngushtë nxënësish a studentësh dhe, sado të rëndësishme të ishin mësimet e tyre, nuk e kapërcenin pragun dhe nuk dilnin jashtë auditorit. Kështu, ndodh që shumë dijetarë të mëdhenj mbeten të panjohur, përderisa kërkimet e zbulimet e tyre s'i pasqyrojnë me të shkruar. Edhe diçka tjetër: materialet dokumentare sjellin të dhëna e sqarojnë shumë probleme; po, kur edhe këto mungojnë, puna vështirësohet më tepër. Deri diku kjo ka ndodhur me filozofin Hafiz Ismet Dibra. Leksionet, konferencat e artikujt në revistën “Zani i Naltë” e gjetkë na japin një ide disi të qartë lidhur me botëkuptimin e mendimin e tij shkencor e filozofik dhe pozicionin që mbante Hafizi në problemet që trajtonte.

Si iluminist, zhvillimin shoqëror Hafizi e shpjegonte në lidhje me momentin historik, me etapën e rrethanat historike të shoqërisë njerëzore. Ai shkruan: “...Për të njoftë doktrinën e Kur'anit, duhet me pa në histori gjendjen e shoqërisë njerëzore në ditët e para të kumtimit të Kur'anit...”⁶ dhe shton: “Islami pranon përtëritje (Texheddyd)..., por nuk duhet harruar se sendi ka një karakteristikë esenciale të vetën, e po qe se zhvishet nga kjo cilësi, sendi nuk mbetet më në shesh.”⁷

Hafizi komenton shpirtin e Islamit dhe për këtë thekson: “... (ne) nuk pranojmë besime që janë në kundërshtim me dituritë e qarta e të vërteta si në ato të matematikës, p.sh: e tëra është më e madhe se pjesa, ose se një send nuk mund të jetë njëkohësisht i ndodhshëm dhe i pandodhshëm, etj...”. Hafizi e thotë me guxim e me kompetencë mendimin e tij, sikurse di

⁶ Po aty, fq.19., U.S.A.

⁷ Polemikë me Mehdi Frashërin, “Zani i Naltë”, viti i pestë, nr.10, 11, 12, gusht-shtator 1928.

edhe të heshtë, ose t'i shmanget debatit, kur e sheh të arsyeshme. Pyetjes mbi reformat e Martin Luterit i përgjigjet: "...Përfundimi i kësaj reforme që rritja e privilegjeve të selisë papnore, prandaj e gjejmë ma të udhës t'ia lamë vëllezënve tanë të krishterë përgjigjen..." Në të njëjtën kohë, ai nënvizon: "...çdo mysliman e ka për detyrë feje me besue, se Krishti asht Profet i Naltë, që e kreu plotësisht misionin e tij..."⁸ Diku tjetër shkruan: "...Kur'anit përmban të gjitha dispozitat e Biblës së Hyjnueshme..."⁹ Hafizi e ka studiuar me vëmendje e seriozitet Biblën dhe e mban parasysh e, nxjerr konkluzionet e veta mbi përmbajtjen e saj. Mbështetur në informacionin e bollshëm që ka grumbulluar thotë: "...Testamenti i Vjetër, njerëzit mëkatarë e të pabindur i frikëson me fatkeqësi e aksidente të natyrës e të kohës..." krahasuar me mesazhin e Kur'anit lë shumë për të nënkuptuar. Edhe pse nuk e thotë fjalën e fundit për versionet e reja të Biblës, ai i përmend me nderim të gjithë librat e shenjtë autentikë të zbuluar profetëve të feve të tjera qiellore para Muhammedit duke i quajtur ata myslimanët paraardhës dhe profetë të mëdhenj (alejhimus'selamu ue ala resulina Muhammed). Këto probleme të mprehta për kushtet e vendit tonë, që përcaktojnë dhe raportet e bashkekzistencës paqësore të elementit kombformues me përbërje fetare heterogjene, Hafizi i trajton si çështje themelore dhe mundohet t'u japë udhë me pjekuri e largpamje; me këtë shpjegohet edhe fjala mjaft e goditur për të krishterët: **vëllezër**, sepse Atdheut i duhej solidariteti e kompaktësimi i të gjitha forcave njerëzore, pa konflikte e pa përçarje, çka është një tregues i atdhedashurisë së Hafiz Ismet Dibrës.

⁸ A ka dyshimfq.31.

⁹ A ka dyshimfq.3.

2. Figurë e vlerësuar nga personalitete të kohës

Hafizi ishte i kujdesshëm në veshje. Ai vinte në shkollë shumë i rregullt, i pastër, me rroba përherë të hekurosura, për t'u pasur zili. Nga goja e Hafizit nuk dëgjuam fjalë të pakontrolluara, kurrë nuk rrëmbehej, kishte humor të hollë, po nuk fyente kënd.

Ai e harmonizonte figurën e mësuesit fare natyrshëm me atë të edukatorit, mbështetur mbi normat e moralit islam.

Hafizi nuk e duronte dyfytërsinë (hipokrizinë), e për këtë citonte ajetin kur'anor (Sure "El Bekare": 44): ***“A i porositni të tjerët që të bëjnë vepra të mira dhe veten tuaj e harroni...?”*** Jeta private e Hafiz Ismetit nuk mund të shkëputet nga zhvillimet mbarëshqiptare. Si nacionalist, me ëndrrën e madhe të bashkimit të të gjitha trojeve etnike me mëmën Shqipëri, dëshironte që një ditë edhe Dibra e Madhe të shijonte gëzimin e lirisë.

Më 23 tetor 1932 u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së diplomave maturantëve të parë të Medresesë që njihej nga shteti. Me këtë rast kishin ardhur Ministri i Arsimit, Hil Mosi dhe Ministri i Drejtësisë, Milto Tutulani. Ndërsa u dorëzonte diplomat studentëve, Hil Mosi tha në fjalën e tij: “Sot ju, zotërinj maturantë të këtij instituti, të edukuar prej një trupi profesorësh shqiptarë, të udhëhequr prej një drejtori patriot të mirënjoftun, jeni pajisë me ndjenja kombëtare e morale...” (Nënvizimet janë tonat, - F.K) “...Hafiz Ismet Dibra, - shkruan Vehbi Ismaili, - ka qenë një prej shkollarëve islamë më eruditë që ka patur Shqipëria....”¹⁰

Hafiz Ismeti kishte letërkëmbim me personalitete e figura të shquara të botës islame. Numri i tyre u rrit kur vajti për të kryer detyrën e Haxhit, më 1935. Kjo ishte një arsye më shumë që Medreseja e Tiranës u bë e njohur në arenën

¹⁰ Imam Vehbi Ismaili, “A ka dyshim në qenien e Zotit”, Michigan, U.S.A., 1993, f. 7.

botërore e vizitohej nga turistë të huaj, delegacione fetare e shtetërore. Më 28 mars 1932 shkolla e Hafizit pati mysafirë Pasteur Jezequel në krye të delegacionit të Lidhjes së Kishave për Paqen Botërore me seli në Paris. Drejtori Dibra në fjalën e tij të përshëndetjes u tha: "...Kombi shqiptar është një provë e gjallë se fetë mund të bashkëjetojnë për të realizuar paqen në botë. Tre elementet (fetare - F.K.) të kombit shqiptar nuk kanë asnjë dasi e përçarje, gjithsecili ushtron lirisht fenë e vet dhe respekton fenë e tjetrit. Pa asnjë pengim a fanatizëm, njëri element merr pjesë në ceremonitë fetare të tjetrit për të asistuar në gëzimet e të vëllait..."

Kreu i delegacionit frëng la këtë shënim në Librin e vizitave të Medresesë:

"En Souvenir d'une tres cordiale..." "Në kujtim të një pritjeje tepër të përzemërt e tepër interesante që shpresoj se ka për të sjellë një bashkëpunim të vërtetë për kthimin e paqes botërore."¹¹

Jezequel i Parisit 28 mars 1932
Me kërkesë të ambasadorit amerikan në Tiranë, u organizua vizita e këtij diplomati të shquar. Ambasadori Hugh Grand erdhi në Medrese më 16 mars 1936.

Në një fotografi të pozuar me këtë rast, Grand ka qëndruar në mes autoriteteve të Komunitetit Mysliman e të personelit të Medresesë dhe ka lënë këtë shënim kortezie në kartolinë:

"Me komplimentet e Ministrit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës!"

Hugh Grand

Më 15 maj 1938, ambasadori Hugh Grand ka marrë pjesë në ceremoninë e Mevludit me studentët e Medresesë.¹²

¹¹ "Zani i Naltë", vëll.VI, nr. 9-10, maj-qershor, 1932.

¹² Zani i Naltë, vëll.XIII, nr.6, qershor 1938, f.169.

Si në deklaratat zyrtare e në intervista, ashtu edhe në shprehjen e bindjeve individuale private, çështjen e atdheut Hafizi e mbante si problemin kryesor sepse ishte frymëzuar nga porosia e Profetit islam, i cili ka nënvizuar: “Dashuria për atdheun është pjesë e besimit”. Hafizi e kundërshtoi pushtimin italian më 1939 dhe e refuzoi dekoratën që i kishin rezervuar fashistët.

Me vendosjen e regjimit komunist, Hafizi shikon disfatën e Islamit e të kombit, prandaj si demokrat përparimtar, e urrente atë. Po, as komunistët nuk e kursyen atë. Gjatë fushatës famëkeqe të ndjekjeve policore kundër intelektualëve e kuadrove fetare, Hafizi, ndonëse në moshë të madhe, u arrestua, u burgos e u dënua sipas një skenari të improvizuar me kujdes. Një pjesë të dënimit ai e vuajti në burg, po, për mungesë faktesh, u detyruan ta nxirrnin e ta linin të lirë.

Hafizi erdhi përsëri në Medrese. Po tani vetëm si mësues. Ai konsiderohej nga regjimi person i padëshirueshëm. Këtë trajtim Ismet Dibra e shikonte si dhembje vetjake, por edhe si fyerje të rëndë, të pafalshme kundër Islamit e kundër kombit dhe e parafrizonte me fjalët: “Nuk ka mundim më të madh për njeriun se sa kur e vë të diturin në mes të të paditurve.” Kështu, ai aludonte për vete dhe për shokët e tij që patën të njëjtin fat. Më në fund, e larguan edhe nga shkolla, me qëllim që ta izolonin e ta shkëpusnin nga njerëzit. Këto masa arbitrare Hafiz Ismeti i kapërcente me durim e stoicizëm.

Simpatizantët, miqtë e ish-studentët kurrë nuk e harruan. Në personin e Ismet Dibrës ata gjenin filozofin e urtë, mësuesin gojëmbël, myslimanin e mirëfilltë, i cili me shembullin vetjak e me këshillat e mençura kishte bërë për vete shpirtin e çdonjërit që kishte pasur fatin ta dëgjonte. Hafiz Ismeti u bë simbol i qëndresës e i durimit të atyre kohëve të zymta, ku

personaliteti i njeriut dhe të drejtat e liritë e tij demokratike shkeleshin me të dyja këmbët.

Hafiz Ismeti ndërroi jetë më 1955. Vdekja e tij u quajt nga populli si humbje kombëtare. Arkivoli me kufomën e të ndjerit u transportua në krahët e mijëra tiranasve, dibranëve, studentëve e qytetarëve, që kishin ardhur nga mbarë Shqipëria për t'i dhënë lamtumirën e fundit, me gjithë këmbënguljen e pushtetarëve për ta hequr vëmendjen nga kortezhi i gjatë, që drejtohej për në varreza.

Edhe në ditët tona emri dhe vepra e Hafiz Ismetit përkujtohen shpesh. Kështu, shkrimtari Arian Kadiu ka shkruar për të në librin “Dibra e Madhe”. Gazetat “Drita Islame”, “Rilindja”, “Hëna e Re” (El Hilal - Shkup) i kanë kushtuar shkrime të posaçme, duke e trajtuar si një figurë madhore të Islamit shqiptar. Kjo bëhet me qëllim që të plotësohet më tej e të dokumentohet më mirë jeta e veprimtaria e Hafiz Ismetit, pasi trashëgimtarët nuk kanë veçse pak gjëra: sepse biblioteka, letërkëmbimi, dokumentet e çdo gjë tjetër personale e të ndjerit u shpërndanë nga frika e bastisjeve të diktaturës dhe humbën. Është detyrë e së ardhmes, sidomos e jona, ish-studentëve të këtij personaliteti të shquar të arsimit shqiptar, të mbledhim të dhëna më të plota për mësuesin e teologun tonë të nderuar.

Faik Kasollja (Hoxha)

Ç'ËSHTË KUR'ANI

Kur'ani, ky libër i diturisë dhe i filozofisë së mjaftueshme, veç vlerave të tjera që përmban në vetvete, është edhe një pasqyrë e vërtetë e së kaluarës e një dritë e shkëlqyeshme për të ardhmen. Kur'ani, që është përmbledhësi i mistereve të Gjithësisë, sikur të mos ishte kumtuar, virtytet dhe moralet e larta të Profetëve të kaluar nuk do të ishin bërë të njohura dhe nuk do të ishin zbuluar vlera dhe nderi i tyre i merituar përpara arsyes dhe logjikës njerëzore. Gjithë Profetëve të mëdhenj iu shpifën disa të meta, faje e gabime të rënda që nuk pajtojnë fare me misionin e lartë të profetësisë, e cila është dhanëtia më e lartë e Allahut.

Këto shpifje të rënda, nuk mund t'ua veshësh jo më Profetëve të lartë të Zotit, por as njerëzve të thjeshtë, që kanë një besim shumë të përciptë, si të thuash, që besojnë vetëm në Zot e në Ahiret (në jetën e pasosur, të amshuar).

Në disa libra, jeta e asaj bote tregohet aq e shkurtër, saqë dituria edhe mendja nuk janë në gjendje t'i pranojnë, as duket se do t'i pranojnë. Kur'ani i ka korrigjuar këto gabime duke nxjerrë në pah e duke lavdëruar veprat e ndritshme e të virtytshme të kohës së kaluar e duke deklaruar hapur se Profetët e Zotit nuk kanë bërë kurrë gabime e gjithmonë kanë folur fjalë me mend e të arsyeshme, se kanë pasur sjellje të urtë e shembullore. Me këto deklarata Kur'ani ka bërë për vete të gjithë Profetët e nderuar dhe admiruesit e tyre.

Sa për kumtuesin e Ungjillit, për Hazreti Isanë (alejhis selam), Kur'ani i Madhërueshëm ka cilësinë e lartë të dëshmojë se ai u krijua jashtë ligjit të natyrshëm dhe është një Profet i lartë. Me këtë dëshmi, Kur'ani na ka ngarkuar detyrën të nderojmë edhe Hazreti Isanë, të qëndrojmë me nderim përpara tij; por duhet ta nderojmë edhe atë që do Hazreti Isanë, Kur'anin, pasi ky libër i lartësuar është dëftuar shumë bujar në të mirë të Krishtit (alejhis selam). Të mos duash Kur'anin do të thotë të

kryesh një krim përpara mendjes e arsyes. Kur'ani përmban dispozitat themelore të Biblës së hyjnueshme. Ai ka vërtetuar me argumente të forta filozofike, të pajtueshme e të përshtatura me çdo kohë se Gjithësia ka Krijuesin e saj të Lartë i Cili është i vetmi Veprues, e Vetmja fuqi që na shtyn në virtyte e në vepra të mira, që formojnë bazën e shëndoshë të qytetërimit të saktë e të lumturisë njerëzore. Disa nga këto vepra të mira janë: gjykimi me drejtësi, nderimi i prindërve dhe njohja e të drejtave të tyre e respektimi i të drejtave të tyre, dhembshuria për fëmijët, mëshira për të afërmit e farefisin, dashuria për atdheun dhe ndihma për shoqërinë, njerëzit etj. Kur'ani fisnik ka dokumentuar edhe realitetin e Gjyqit të Madh të Zotit që do të gjykojë veprimet e do të caktojë përgjegjësitë.

Si divinitetin (hyjnoren) ashtu edhe Ahiretin (jetën e amshuar) i ka sqaruar dhe i ka shpjeguar me një stil të lartë, të bukur e të fuqishëm, që bën për vete çdo mendje njerëzore të pjekur e të përsosur. Ajetet që i sqarojnë këto dy **egzigjenca** (kërkesa të mëdha) të njeriut kanë formuar bazën e diturisë së madhe që quhet teologji. Kur'ani nuk është vetëm kroi i teologjisë; Kur'ani është edhe gurra e shumë diturive të tjera, si misticizmi, morali, jurisprudenca, gramatika, sintaksa, fjalori e shumë degë të tjera të diturive islame. Veç teologjisë, Kur'ani ka përmbledhur edhe vlerën e higjenës. Gjysmëajeti i lartë, *“Kulu, uesthrebu ue la tusrifu...”* që ka kuptimin, *“Hani e pini, por mos e teproni...”* (Kur'ani, 7:31) është shpirti i mjekësisë.

Dispozita të detajuara të Kur'anit pajtohen plotësisht me rregullin e evolucionit. Dispozita kësodore shohim edhe në libra të tjera qiellorë. Në fillim, këto janë shumë të thjeshta e pastaj i gjejmë duke u përmirësuar sipas zhvillimit mendor të njerëzisë, derisa arrijnë të marrin trajtën më të plotë në Kur'an, i cili u kumtua në një kohë kur mendja e njeriut u poq e u

zhvillua në shkallën më të lartë. Kemi dy prova të fuqishme që vërtetojnë se dispozitat e Kur'anit përputhen plotësisht me arsyen dhe me mendjen e shëndoshë:

1- Nuk ka asnjë popull që të ketë mëtuar (pretenduar) se dispozitat e urdhrat e Kur'anit bien në kundërshtim me zakonet e tij, pasi t'i jenë kumtuar dhe shpjeguar mirë këta urdhra.

2- Ligjet e hartuara në vende të qytetëruara, ku edukata mendore dhe kultura kanë përparuar shumë, u afrohen mjaft dispozitave të Kur'anit; këto dispozita mirëpritën e mbahen me nderim nga personalitete dhe figurat e shquara të kulturës, të shkencës e të artit ndër ato vende.

Në fillim të këtij artikulli¹³ kemi thënë se Kur'ani famëmadh është dritë e shkëlqyeshme e së ardhmes. Po. Kur'ani i lartësuar sqaron në tekstin e tij që 13 shekuj më parë,¹⁴ se të gjitha zbulimet shkencore që kanë mundur t'i realizojnë dijetarët e shekujve të fundit, në kohën e lumnueshme s'i kanë rënë ndokujt ndër mend; prandaj themi se Kur'ani jep dritë të plotë për çdo kohë. Që ta vërtetojmë këtë, le të sjellim disa shembuj:

Astronomia moderne ka zbuluar se “Dheu nuk qëndron, por lëviz pa pushim duke u rrotulluar rreth boshtit të vet e rrotull Diellit, i cili lëvron në qendrën e tij rrotull boshtit të vet.”

Këtë zbulim të astronomisë së re e ka shpjeguar Kur'ani më se trembëdhjetë shekuj më parë me këto ajete:

وَالشَّمْسُ تَجْرِي لِمُسْتَقَرٍّ لَّهَا ۚ ذَٰلِكَ تَقْدِيرُ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ ﴿٣٨﴾

¹³ (Poshtëshënimet janë të redaksisë.)

¹⁴ (Ky studim i Hafiz Ismetit është botuar në revistën “Zani i natës” në vitet ’30 të shek. të kaluar.)

“Edhe Dielli lëvtron në qëndrën e posaçme që i ka caktuar i Plotpushtetshmi dhe i Plotdituri Zot.” (Sure “JaSin”, ajeti 38)

Dhe:

وَتَرَى الْجِبَالَ تَحْسِبُهَا جَامِدَةً وَهِيَ تَمُرُّ مَرَّ السَّحَابِ ... ﴿٨٨﴾

“Ti i shikon malet që duken të shtangët, kurse ata udhëtojnë e përshkojnë si retë.” (Sure “En Neml”, ajeti 88)

Këto dy ajete janë nga një llambë e ndritshme (13) shekuj më parë, për të dëshmuar të vërtetën që ka zbuluar shkenca e sotme.

Për ligjin e krijimit dhe të zhbërjes filozofët e lashtë kanë pandehur se varej nga disa elemente që gjenden në horizontin e Hënës, kurse zbulimet dhe diktimet e reja vërtetojnë të kundërtën e kësaj pandehjeje dhe thonë se kompetenca e këtij ligji, tokësor a qiellor qoftë, shtrihet mbi çdo trup: çdo gjë e natyrës gjithnjë shndërrohet e ndryshohet e nuk mundet ta ruajë një formë të prerë e përfundimtare. Me këtë shpjegim të ri, ky ligj pajtohet me atë që Kur’ani i madhërueshëm e ka thënë që në shekullin e lumnueshëm të Hazreti Muhammedit (alejhis selam).¹⁵

يَوْمَ تُبَدَّلُ الْأَرْضُ غَيْرَ الْأَرْضِ وَالسَّمَوَاتُ ۖ وَبَرَزُوا لِلَّهِ الْوَاحِدِ

الْقَهَّارِ ﴿٤٨﴾

“Ditën e Kijametit e gjithë lënda e dheut edhe trupat e qiellit do ta ndryshojnë formën e tyre në një formë tjetër

¹⁵ Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të!

***e atëherë mbarë njerëzia do ta shikojnë qartë
madhështinë e fuqisë së Allahut, që është Një i vetëm
dhe është Zhbërës i rreptë.***” (Sure “Ibrahim”, ajeti 48)

Me fjalën “**tebeddul** – ndryshim”, ky ajet i lartë ka përhapur dritën e vet drejt së vërtetës së pakundërshtueshme - **asgjë nuk humb** e me këtë mënyrë, ka shqyer perdet e errëta që kanë mbuluar të vërtetën.

Edhe teorinë që flet se shumë yje të qiellit kanë banorë si të dheut tonë, Kur’ani i madhërueshëm e ka forcuar me këtë ajet të ndritshëm:

وَمِنْ ءَايَاتِهِ خَلْقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَتْ فِيهِمَا مِنْ دَابَّةٍ ۚ وَهُوَ عَلَىٰ جَمْعِهِمْ إِذَا يَشَاءُ قَدِيرٌ ﴿٢٩﴾

***“Krijimi i qiejve dhe i Tokës në një trajtë të përbindshme
16 dhe zbulimi i tyre me shumë lloje gjallesash janë
prova e fakte që dëshmojnë Njësinë e Zotit.”*** (Sure “Esh-Shura”, ajeti 48)

Veçanërisht, “Dheu, si shumë të tjerë, është një trup qiellor i shkëputur prej Diellit”, thonë teoritë e zbulimet e reja dhe në favor të këtyre teorive, që para shumë shekujsh ka dhënë dritë Kur’ani i madhërueshëm me këtë ajet të kuptueshëm:

أَوَلَمْ يَرِ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ كَانَتَا رَتْقًا فَفَتَقْنَاهُمَا ۚ وَجَعَلْنَا مِنَ الْمَاءِ كُلَّ شَيْءٍ حَيٍّ أَفَلَا يُؤْمِنُونَ ﴿٣٠﴾

***“A nuk mendojnë mohuesit se Dheu në fillim ka qenë
ngjitur me qiell e ne i shkëputëm dhe çdo gjë të gjallë e***

¹⁶ Përbindëse, bindëse

krijuam prej ujit? A nuk duhet t'i mendojnë këto gjëra e të besojnë?” (Sure “El-Enbija”, ajeti 30)

Kur'ani i madhërueshëm, veç të tjerash, përfshin edhe dituritë e deritanishme, po edhe ato të pastajmet. Ky Libër, me elokuencën e tij të hollë ka fituar rekordin dhe i ka postatë¹⁷ krejt; me stilin e lartë, me larminë e figurave të holla dhe me dispozitat elokuate, ai qëndron kurdoherë në kulm të nderit. Po të shtyhem i të zgjatemi mbi vlerat e përgjithshme e të rëndësishme të Kur'anit, me gjithë pazotësinë (inkompetencën) tonë, kishin me u dashtë, jo një varg artikujsh si ky, por një libër mjaft i vëllimshëm. Prandaj ne zgjodhëm rrugën më të shkurtër dhe u kufizuam t'i shprehim mendimet tona vetëm me dy cilësi të vlefshme:

- a) Kur'ani famëmadh është “Pasqyra e së kaluarës”;
- b) Ai është "Drita e së ardhshmes"

InshaAll-llah, kur t'i vijë koha, do të përpiqemi t'ju japim korrent nga Drita e Kur'anit lexuesve të ndershëm të “Zanit të Naltë” që e dëshirojnë me nxehtësi shpirti këtë Dritë të Zotit (xhel-le sha'nuhu)¹⁸, prej të cilit vjen edhe suksesi.

Hafiz ISMET

A KA DYSHIM NË QENIEN E ZOTIT?¹⁹

¹⁷ I ka bërë të ndahen e të mendojnë.

¹⁸ Që qoftë i Lavdëruar!

¹⁹ Titulli i origjinalit është: “A ka dyshim në qenëjen e Zotit?” Jo vetëm titulli, por i tërë libri është sjellë në gjuhën shqipe standarde. Për ta bërë më të lehtë frazën, është zëvendësuar ndonjë fjalë a shprehje e huaj e panevojshme, ndonjë fjalë a shprehje kerabinore, janë ndrequr a përpunuar disa ndërtime sintaksore etj., pa e prekur aspak ligjëratën e këndshme e të fuqishme të Hafiz Ismet Dibrës. Kur është menduar si e nevojshme, është dhënë në fund të faqes ndonjë shënim tekstologjik. (poshtëshënimet janë të redaksisë)

Konferencë prej H. T. H. Ismet Dibrës Drejtor i Medresesë së Përgjithshme

Bini në salavat mbi Profetin e Resulin Besnik! Bini në salavat mbi Atë që u dërgua si mëshirë për Gjithësinë!

Bini në salavat mbi të lavdërueshmin, me titullin “Lavdi i të gjithë Profetëve!”

Allahu i amshuar, në Kur'anin e tij të lartësuar, në suren "Ibrahim" urdhëron:

"اعوذ بالله من الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ " قَالَتْ رُسُلُهُمْ أَفِي اللَّهِ

شَكٌّ فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۖ

“Profetët thanë “A ka dyshim në Zotin, që krijoi qiejt e Dheun...?” (Sure “Ibrahim”, ajeti 10)

Që ta ndiejmë e ta shijojmë kuptimin e lartë të këtij ajeti, ashtu si i ka hije Kur'anit, është e nevojshme të shpjegojmë disa hollësi paraprake për lartësinë e Kur'anit.

Kur'ani ka tri baza themelore:

a)- **Teuhidin**, *Besimi në Zotin*;

b)- **Dijanat**, *Dispozitat e fesë*;

c)- **Ihbarat**, *Lajme historike*.

E para, **Teuhidi**, njohja (besimi) në Allahun, në një Zot të vetëm. Ky besim është qëllimi i krijimit të njeriut.

Këtë qëllim na e njofton ajeti i lartë i Kur'anit

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

“Xhindet e njerëzit i krijova vetëm të më njohin Mua.”

(Sure “Edh Dharijat”, ajeti 56).

Kush mbetet jashtë këtij rrethi, e ka bjerrë rrugën, e ka humbur qëllimin e krijimit, natyrën njerëzore dhe ka mbetur vetëm me natyrën shtazore. Shtaza e papërgjegjshme e ka vendin në Xhehennem.

(Zoti na shpëtoftë!)

Dispozitat fetare na e pastrojnë ndërgjegjen nga veset e ligësitë. Për shembull, namazi është një detyrë feje që na ndalon nga të ligat e nga imoralitetet.

إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ... 

Kur’ani urdhëron: ***“Namazi ju ndalon nga të ligat e nga imoraliteti.”*** (Sure “El Ankebut”, ajeti 45.)

Agjërimi është një detyrë feje që mjekon sëmundjet trupore e shpirtërore të njeriut, sikurse urdhëron edhe Kur’ani me këtë ajet:

...كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ...



“Jua bëmë detyrim agjërimin, sikurse ua patëm bërë detyrim edhe popujve të kaluar para jush...” (Sure “El Bekare”, ajeti 183)

Lajmet historike parashtrohen për të marrë shembull, për t’u zgjuar e për t’u rezervuar në çdo rast të mundshëm. Këto na udhëheqin për të ndrequr të metat, për të plotësuar mungesat, për të përmirësuar sjelljet e për të rregulluar veprimet tona të kësaj jete e të Jetës tjetër. Këshillat e porositë kur'anore na

shpëtojnë nga padija (injoranca) dhe nuk na lënë të bëjmë gabime në jetën tonë.

Të gjithë sehabet (shokët) e Pejgamberit dhe arabët kishin dijeni të plotë për aforizmat, sentencat, maksimat që nënkuptohen nga parashikimi i lajmeve historike. Ata e dinin fare mirë se parashtrimi i ngjarjeve të kaluara nuk është bërë me qëllim që të kallëzojnë histori, por që të na bëhen shembull e bazë për të rregulluar veprimet tona. Këtë qëllim e vërteton ajeti:

لَقَدْ كَانَتْ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِأُولِي الْأَلْبَابِ... ﴿١١١﴾

“Lajmet historike të Kur’anit janë parashtruar me qëllim që të marrin ibret (mësim) e shembull njerëzit e mençëm.” (Sure “Jusuf”, 111).²⁰ Po këtë gjë Kur’ani e vërteton edhe me këtë ajet:

وَكُلًّا نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نُثَبِّتُ بِهِ فُؤَادَكَ ۚ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقُّ وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَى لِلْمُؤْمِنِينَ ﴿١٢٠﴾

“Kallëzimet e peripecive të Profetëve të kaluar janë gjëra që ju forcojnë zemrën, si edhe për t’u dhënë këshilla e për t’u kujtuar detyrën besnikëve.” (Sure “Hud”, ajeti 120.)²¹

Kallëzimet historike e artistike shpeshherë përsëriten në Kur’an me të njëjtin stil ose me një stil të përngjashëm. Kjo

²⁰ Shih edhe këtë përkthim të ajetit:

“Në tregimet e tyre (për ta) ka udhëzim për njerëzit që kanë arsye...”

²¹ Shih edhe këtë përkthim të ajetit: “Gjithçka që ta tregojmë ty për historinë e profetëve – është për të të forcuar zemrën: nga ata vjen tek ti e Vërteta, si edhe këshilla dhe mesazhi për ata që kanë besuar, që të kujtojnë.”

gjë, aty nga shekulli i 3-të i Hixhretit²² e prapa, bëri që disa njerëz të paditur (inJORantë) ta kritikonin Kur'anin duke thënë se kishte shumë përsëritje. Kritika e këtyre të paditurve mund t'i sjellë ndonjë mungesë Kur'anit, aq sa mund t'i sjellë ndonjë mungesë diellit ligështia e syve të lakuriqësit, e zogut të natës. Megjithëkëtë, intelektualët e çdo shekulli i kanë kuptuar pa vështirësi hollësitë karakteristike që parashtrojnë ndryshimet e rëndësishme që fshihen midis këtyre përsëritjeve. Ata e kanë kuptuar fare mirë se përsëritja e kallëzimeve historike në Kur'an nuk ka për qëllim të mësojmë kronologjinë e kohëve të kaluara, por ka për qëllim të na tregojë gabimet e të parëve, që të na zgjojë nga dremetja e të marrim ibret (mësim) që të mos biem edhe ne në ato gabime. Intelektualët që i kanë kuptuar këto hollësi, ushqejnë respekt të devotshëm përpara madhësisë së Kur'anit. Për ta provuar këtë, le të sjellim disa shembuj:

Thonë se Muhjiddin Arabiu kishte zotësinë të gjente në Kur'an burimin e çdo Hadithi sherif e çdo urdhër të Profetit mund ta përshtaste me Kur'anin dhe nuk gjente kundërshtim midis Kur'anit e Hadithit.

Filozofi i madh Muhjiddin Arabiu thotë se kishte kërkuar në Kur'an të **barabiste** përmbajtjen e Hadithit sherif: *"Shpirti i del besimtarit nga trupi, sikurse del qimja prej gjalpës,"* (domethënë, myslimani i vërtetë vdes pa mundim e pa ndier dhimbje) me ndonjë ajet nga Kur'ani. Për këtë Hadith sherif, siç thotë vetë Muhjiddin Arabiu, kishte gjetur ajetin 31 të sures "Jusuf", që urdhëron:

"Zelibaja thirri në pallat Zonjat që e kritikuan, i uli nëpër frone dhe u nxori fruta për t'i qerasur dhe nga një brisk që t'i qëronin. Kur Zonjat mikesha nisën të prisnin kokerrat e pemëve, Zelibaja u paraqiti Jusufin,

²² *Hixhret* emigrimi i të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nga Meka në Medine, në vitin 622.

bukuria e të cilit i habiti të gjitha aq shumë, saqë, duke harruar se kishin nëpër duar brisqet e mprehtë, prenë gishtat e duart pa ndier dhembje dhe të mrekulluara, thanë mbresat e veta:

... مَا هَذَا بَشَرًا إِنْ هَذَا إِلَّا مَلَكٌ كَرِيمٌ ﴿٣١﴾

“Jo, jo, ky nuk qenka njeri; mund të jetë vetëm ndonjë melek i bekuar.” (Sure “Jusuf”, 31).

Nga ky ajet mësojmë se bukuria e tepërt i vdes ndjenjat dhe atëherë nuk diktojmë dhembje. Përfundimi filozofik përmbledhet me pak fjalë: Kur bukuria e Hazreti Jusufit paska fuqi sa të na bëjë të mos ndiejmë dhembjen e thikës, po bukuria supreme e Krijuesit, që i shfaqet njeriut kur jep shpirtin? Ajo jo vetëm nuk shkakton ndonjë dhembje, por i siguron atij një vdekje të ëmbël, shija e së cilës është e amshuar dhe nuk harrohet kurrë. Zoti na e bëftë që të shijojmë një vdekje të këtyllë, me besim të plotë, me besim në Zotin (xh.xh.), në urdhrat e Tij, në Hazreti Muhammedin, Profetin islam e në ato që na porosit Kur’ani! Allahu, me të Madh të Vet, për të udhëhequr robtë e Vet në rrugë të mbarë urdhëron:

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ ... وَتَصْرِيفِ الرِّيْحِ ... لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿١٦٤﴾

“Në krijimin e qiejve e të Dheut, në ndryshimin e ditës e të natës ... e në rregullimin e erërave...ka argumente për të mençurit.” (Sure “El Bekare”, ajeti 164)

Siç shihet, në këtë ajet flitet për erën. Për erën flitet edhe në ajete të tjera. Po të vëmë re me vëmendje, do të shohim se përsëritjet e shpeshta të erës kanë qëllime të veçanta dhe krejt të ndryshme. Bie fjala, në ajetin e mësipërm, përmendja e erës është bërë në një mënyrë që astronomëve e meteorologëve u jep mësim me rëndësi.

Kur këndojmë ajetin 22 të sures së Hixhrit:

وَأَرْسَلْنَا الرِّيحَ لَوَاحٍ ... ﴿٢٢﴾

“I përcjellim erërat për pllenimin e bimëve në kohën e lulëzimit...” (Sure “El Hixhr”, ajeti 22), shohim se Kur’ani fisnik qysh katërmbëdhjetë shekuj më parë u mëson agronomëve njërën nga mënyrat e pjalmimit të bimëve, mësim që shkenca munda ta zbulonte vetëm tash vonë. I madhi Zot, për të udhëhequr robtë e Vet që të besojnë ringjalljen fizike, e përmend këtë (ringjalljen) në shumë ajete, porse kjo përmendje bëhet me një stil që secila përsëritje paraqet një mësim të veçantë filozofik. Për shembull, në suren “JaSin” urdhëron:

قُلْ يُحْيِيهَا الَّذِي أَنشَأَهَا أَوَّلَ مَرَّةٍ ۖ وَهُوَ بِكُلِّ خَلْقٍ عَلِيمٌ ﴿٧٩﴾

“Thuaji, O i Dërguar - kundërshtarit tënd - të vdekurin e ngjall Ai që e krijoi më parë. Ai i di të gjitha të fshehtat e krijimit.” (Sure “JaSin”, ajeti 79). Me këtë ajet, Zoti fuqiplotë na thotë se mosbesimi në ringjalljen fizike vjen ngase njerëzia nuk kanë njohuri për të fshehtën e jetës e të gjallërimit. Allahu ka fuqi ta ringjallë të vdekurin, Ai e di enigmën e jetës. Për këtë dukuri Allahu urdhëron përsëri në sure “El-Kijame”:

أَتَحْسَبُ الْإِنْسَانُ أَنْ نَجْمَعَ عِظَامَهُ ۖ بَلَىٰ قَدَرِينَا عَلَىٰ أَنْ نُسَوِّيَ
بَنَانَهُ ۚ

“A kujton njeriu se nuk mundemi t’ia mbledhim kockat e t’ia rindërtojmë skeletin? -Po, po, mundemi ta bëjmë këtë punë e të rregullojmë vijat e mollëzave të gishtave.”

(Sure “El-Insan”, ajetet 3, 4)

Me frazën e dytë të këtij ajeti, Kur’ani u jep mundësi fiziologëve që studimi i vijëzave nëpër mollëzat e gishtave të jetë një mjeshtri e hollë dhe e çuditshme. Sot, kjo veçanti të gishtat e njeriut shfrytëzohet praktikisht sidomos nga policia.²³ Shembujt që sollëm deri këtu kujtojmë se janë të mjaftueshëm për të provuar lajthitjen e atyre që thonë se Kur’ani paska shumë përsëritje.

* * *

Që të mos largohemi nga qëllimi i temës, le të kalojmë në një çështje tjetër.

Kur’ani është një libër i qartë që me shumë argumente shpjegon gjatë e gjerë se si të njohim e të besojmë një Zot, çka është qëllimi i krijimit. Që të mos rrëshqasim fare nga fusha e Teuhidit (besimit në një Zot), Kur’ani i lartësuar na mëson e na stërvit që të gjitha adhurimet e lutjet t’i bëhen vetëm Allahut. Këtë udhëzim na e jep ajeti i Kur’anit, El Fatiha, 5. Një tjetër ajet kur'anor, duke marrë në shqyrtim një gabim të palejueshëm në ndërtimin e besimit islam, thotë:

²³ Organet e policisë në vijat e gishtave i mbështesin hetimet e veta shkencore për të saktësuar identitetin e personit të dyshuar.

وَقَالَتِ الْيَهُودُ عُزَيْرٌ ابْنُ اللَّهِ وَقَالَتِ النَّصْرَى الْمَسِيحُ ابْنُ اللَّهِ...



“Jahudinjtë thanë se Uzejri është i biri i Zotit; Nasranitë thanë se Isai është i biri i Zotit...” (Sure “Et Teube”, ajeti 30). Koncepte të këtij lloji janë kundërshtuar e janë të palejueshme dhe konsiderohen nga mëkatet më të pafalshme, sepse i vihet Zotit shok e se janë kundër logjikës.

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ ثَالِثُ ثَلَاثَةٍ...

“Kanë bërë kufër ata që thanë se Zoti është 'I treti i treve'.” (Sure “El Maide”, ajeti 73). Ky ajet i lartë shemb fund e majë të gjitha llojet e instituteve pagane.

...لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ

“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai është Dëgjues e Vështrues.” (Sure “Esh Shura”, ajeti 11)

Edhe tek ajeti i cituar shohim si shembet ai lloj paganizmi që vjen nga imagjinimi i ndonjë shembulli material ose fantastik. Kur’ani, nuk e shpall Njëtimin e Zotit vetëm me shprehje letrare, por e provon këtë edhe me argumente e me fakte të pakundërshtueshme. Librat e mëparshëm të Allahut, siç i dinë ata që i kanë studiuar, nuk përmbajnë kaq prova logjike. Kur’ani i madhëruar e provon se krijimet janë lidhur me arsye e me qëllim dhe nuk bëhen kot më kot. Për të siguruar më shumë argumente, le të studiojmë edhe këto ajete:

أَفَحَسِبْتُمْ أَنَّمَا خَلَقْنَاكُمْ عَبَثًا ... ﴿١١٥﴾

“A kujtuat ju se ju krijuam kot së koti?” (Sure “El Mu’minune”, ajeti 115).

وَاللَّا نَعَمَّ خَلَقَهَا لَكُمْ ... ﴿٥١﴾

“Devetë, leshin e tyre, edhe dobitë e tjera i krijuam për ju.” (Sure “El-En’am”, ajeti 5).

Këto ajete na dëshmojnë se të gjitha krijesat janë lidhur me nga një qëllim, me nga një arsye, që përfundojnë në një stad të paraparë. Sikur të supozohet se në krijim nuk ka ndonjë qëllim të paramenduar, do të ishte i paarsyeshëm edhe urdhri i Kur’anit që thërret të rregullojmë dhe të administrojmë natyrën. Megjithëkëtë, Kur’ani i lartë, sado që të gjitha dukuritë e natyrës i lidh me nga një qëllim, këto qëllime i mbështet në Vetveten e Amshuar sipas këtij ajeti:

إِنَّ اللَّهَ يُمْسِكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ أَنْ تَزُولَا ... ﴿٤١﴾

“Është Allahu ai që i mban qiejt e Tokën që të mos rrëzohen...” (Sure “Fatir”, ajeti 41)

سَنُرِيهِمْ ءَايَاتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ ۖ أَوَلَمْ

يَكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٥٣﴾

“Do t’ju dëftojmë atyre provat tona objektive e subjektive, derisa t’u mbushet mendja se Kur’ani është hak, libër i vërtetë i Zotit, kumtuar prej Zotit të

24 Amshuar.” (Sure “Fussilet”, ajeti 53)

Ky ajet i lartë na shpjegon se Kur’ani është një libër që mbështetet në argumente, shpjegon që provat objektive e subjektive flasin për qenien e Zotit. Shpjegimi është sjellë në një mënyrë, që i bind të gjithë ata që e studiojnë se Kur’ani është libër i amshuar dhe nuk është krijesë e mendjes njerëzore.

Është gjallë historia e shekujve të kaluar të myslimanëve të vërtetë që çdo vepër të tyre e mbështesnin në Kur’an. Kjo histori e shkëlqyeshme na dëshmon me fakte se myslimanët e kohëve të lumnueshme ishin shtyllat e diturisë dhe mbrojtësit e saj të vërtetë. Ata ishin prijësit e botës në kimi, filozofi, astronomi, mekanikë...e tjerë. Ata shpikën algjebren dhe vunë në përdorim trigonometrinë. S’ka dyshim se aktiviteti i myslimanëve të parë në studimet teknike, shkencore e filozofike kishte për burim zbërthimin e problemeve kësodore që parashtron Kur’ani i lartë.

Kërkesat e ndodhura, hetimet e thella, zbulimet e shumta u shtonin dhe u forconin myslimanëve Doktrinën e Unitetit të Amshuar.

Në shekullin e sotëm ka përparuar shumë mjekësia. Po, a ka zbuluar ndonjë gjë më të madhe se përmbajtjen e këtij ajeti?

...وَوَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَقَدَرَهُ تَقْدِيرًا ﴿٢﴾

“Është Ai (Zoti) që krijoi çdo gjë dhe pajoi me cilësitë e veçoritë e nevojshme që pëlqeu Ai Vetë.” (Sure “El

²⁴ Shih edhe këtë përkthim: “Shpejt, Ne do t’ju tregojmë atyre Shenjat tona në zonat (më të largëta të Tokës) dhe në shpirtat e vet, derisa të shfaqet tek ta se kjo është e Vërteta.”

Furkan”, ajeti 2). Bie fjala, e krijoji njeriun dhe e pajoi me mend, me kuptim, me shikim, me gjykim e me aftësi që të mundet të rregullojë e të zbukurojë punët e veprat e veta. Të vërtetat shkencore të zbuluara deri sot nën drejtimin e dijetarëve nuk janë tjetër, veçse ligje të amshuara e të patundura që nuk prishen kurrë e që vërtetojnë madhështinë e Zotit të vërtetë. Me këto vepra, dijetarët nuk kanë mundur të zbulonin ndonjë gjë, nuk kanë bërë ndonjë punë të madhe, veçse kanë vërtetuar tekstin e këtij ajeti të Kur’anit:

وَمَا خَلَقْنَا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لِعَيْنٍ مَا خَلَقْنَاهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٨﴾

“Nuk i krijuam qiejt, Tokën dhe ç’ka në to kot, pa dobi e për t’u tallë, por i kemi krijuar me arsye të plotë, që të Më njohin se Unë jam Një dhe i Pashoq, kam fuqi të plotë dhe dituri të pasosur...” (Sure “Ed Duhan”, ajetet 38, 39)

Ka përparuar shkenca, por nuk ka mundur të thotë më shumë se ç’thotë ky ajet i lartësuar:

...وَجَعَلْنَا مِنَ الْمَاءِ كُلَّ شَيْءٍ حَيٍّ أَفَلَا يُؤْمِنُونَ ﴿٣٠﴾

“Dhe prej ujit kemi krijuar çdo gjë të gjallë.” (Sure “El Enbija”, ajeti 30.)

Ka përparuar shkenca, por nuk ka mundur të thotë më shumë se tekstin e këtyre tre ajeteve:

وَالْأَرْضَ بَعْدَ ذَلِكَ دَحَلَهَا ﴿٣٠﴾ أَخْرَجَ مِنْهَا مَاءَهَا وَمَرْعَهَا ﴿٣١﴾
وَالْجِبَالَ أَرْسَنَهَا ﴿٣٢﴾

“Pastaj e shtroi Dheun, i dha ujë e kullosë dhe e shtrëngoi me male.” (Sure “En Naziat”, 30-32.)

Ka përparuar shkenca, por nuk ka mundur të thotë tjetër gjë, veçse ka pohuar e ka përsëritur tekstin e verseteve kur'anore që parashtrojmë këtu poshtë e që janë kumtuar katërmbëdhjetë shekuj më parë:

هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَجَعَلَ مِنْهَا زَوْجَهَا لِيَسْكُنَ إِلَيْهَا
ص
... ﴿١٨٩﴾

“Është Ai (Zoti) që ju krijoi nga një frymë e vetme,²⁵ prej së cilës krijoi të shogën, që të qetësohet...” (Sure “El A’raf”, ajeti 189)

وَجَعَلْنَا فِي الْأَرْضِ رَوَاسِيَ ... ﴿٣١﴾

“Në Tokë bëmë malet, me të cilët të qëndrojnë Dheu.” (Sure “El Enbija”, ajeti 31.)

... وَكُلٌّ فِي فَلَكٍ يَسْبَحُونَ ﴿٤٠﴾

²⁵ njeri i vetëm.

“...Të gjithë trupat qiellorë lundrojnë në hapësirë.”

(Sure “JaSin”, ajeti 40).

Ajetet e larta kësodore janë me shumicë. Paralajmërimet e këtyre ajeteve, po të krahasohen me përparimet e zbulimet shkencore të derisotme, shihet të thonë se veprat e shkencës janë tepër të kufizuara përpara perspektivës së shkëlqyer e të lumnueshme që paralajmëron tërthoras Kur’ani i lartë.

Përpara kësaj madhështie të Kur’anit, a mund të qëndrojë ateizmi i pathemeltë?! Përballë elokuencës së mrekullueshme të Kur’anit të lartë, a është e mundur që të mos dalë në shesh kotësia e opinionit të gabuar të injorantëve që duan të atakojnë shenjtërinë e Kur’anit?! Duhet ta dimë, vëllezër se Kur’ani është fjala e Zotit, e Gjithësia me dukuritë e saj është vepra e Zotit. Midis fjalës së Zotit e veprës së Tij nuk ka kundërshtim. Fjala e Zotit përputhet me veprën e Tij. Zoti thotë atë që bën dhe bën atë që thotë. Zoti nuk është si njerëzit e pabesë (amoralë) e të degjeneruar, të cilët veprojnë në kundërshtim me fjalët që predikojnë. Mund të na lindë ndonjë paqartësi midis Kur’anit, Fjalës së Zotit dhe dukurive të natyrës, veprës së Zotit. Kjo paqartësi nuk është reale sepse mund të shkaktohet, ose pse nuk e kemi kuptuar mirë fjalën e Zotit, ose pse shkenca ende nuk e ka arritur atë shkallë që ta zbulojë aksh dukuri.

Kur’ani është ai libër i amshuar që ka përmbledhur në vetvete çdo gjë. Kulminacionet dhe aluzionet e Kur’anit po dalin në shesh krahas përparimeve që po bën shekulli modern. Në suren “El En’am” të Kelamull’llahit, Allahu urdhëron:

وَلَا رَطْبٌ وَلَا يَابِسٌ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿٥٩﴾

“Në Kur'anin gjëndet çdo gjë e njomë dhe e thatë...”

(Sure “El En'am”, ajeti 59)

Kur'ani nuk është vetëm vepër me të dhëna shkencore.

Bashkë me to, ai përmban edhe probleme shoqërore e të administratës politike. Për të njohur doktrinën sociologjike, politike dhe evolucionin që solli kjo doktrinë e shenjtë, duhet parë historia, gjendja e shoqërisë njerëzore në ditët e para të kumtimit të Kur'anit. Historia na dëshmon se në këtë kohë njerëzia ishin dy grupesh: feudalët dhe populli. Feudalët kudo, si në detyrat ashtu edhe në të drejtat, gëzonin privilegje të gjera e të garantuara me statut e me ligje; për arsye të këtyre privilegjeve, feudali e konsideronte popullin si skllav; pasuria, nderi e çdo gjë e popullit ishte e lejuar për feudalin, ndërsa klasa e mjerë e të varfërve nuk kishte të drejtë as të ankohej kundër feudalit për kurrëgjë - as civile, as penale qoftë çështja. I shkreti popull nuk kishte të drejtë as ta zinte në gojë dhunën që i bëhej e jo më të hynte në bisedë për këtë çështje.

Mu në këtë kohë kritike e të vështirë ia mbërriti Kur'ani i madhërueshëm duke deklaruar mëshirë të përgjithshme dhe duke vënë elementin e vëllazërisë njerëzore, garantoj qetësinë e përgjithshme dhe të drejtën e pronësisë. Kur'ani i lartë i anuloi privilegjet e feudalëve dhe vuri barazinë e vërtetë duke zhdukur edhe të ashtuquajturat parapëlqime (preferenca) ngjyre e race. Kur'ani i madhërueshëm ia la parapëlqimin vetëm virtytit. Shikoni për këtë ajetin:

...إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٣﴾

“Më i ndershmi juaj tek Allahu, është ai që ka virtytin më të lartë e veprat më të urta ...” (Sure “El Huxhurat”, ajeti 13).

I madhi Muhammed (alejhis selam) nuk mjaftoi vetëm duke e njoftuar këtë parim të drejtësisë; ai e zbatoi vetë në jetën e Tij, që të bëhej shembull praktik i çdo parimi që predikonte. Zotëria e Tij e pati marrë edukatën e vet prej Edukuesit të Gjithësisë, sikurse urdhëron ky hadith sherif:

ادبنى ربي فاحسن تأديبي

“Mua më edukoi Zoti im me edukatën më të bukur e më të lartë.” Ky Pejgamber i lartësuar nuk shihte ndonjë meritë apo preferencë as në vetvete, as në farefisën e tij për asnjë çështje, civile ose penale qoftë. Këtë parim Hazreti Muhammedi nuk e ushqente vetëm si një ide të thatë, por e zbatoi në jetën e vet me dorën e vet. Dy shembuj:

Një grua prej shtëpive të para të fisit Mahzumij kishte vjedhur dhe kjo vjedhje iu provua me fakte. Fisi i gruas, me qëllim që ta shpëtonin nga dënimi ligjor, kërkuan ndërmjetësimin e Usame bin Zejdit. Hazreti Muhammedi iu përgjigj me këtë frazë:

"انما اهلك الذين من قبلكم انهم كانوا اذا سرق فيهم الشريف تركوه و اذا سرق فيهم الضعيف اقاموا عليه الحد وايم الله لو ان فاطمة بنت محمد سرقت لقطعت يدها."

“Ndër popujt e kaluar, kur vidhte i ligu ²⁶i cili nuk kishte përkrrahje, dënohej në atë çast; kur vidhte i forti, tolerohej dhe nuk zbatohej ligji. Kjo sjellje e tyre e ky abuzim i tyre është shkaku i teposhtes (dekadencës) së tyre. Unë nuk mund ta abuzoj ligjin, por kisha me ia pre dorën edhe sime bije, Fatimes në qoftë se vjedh.”

Një ngjarje tjetër me rëndësi që tregon moralin e lartë të Hazreti Muhammedit është mënyra se si u hallallos me shokët

²⁶ një njeri i një klase të ulët.

e vet besnikë kur do të ndërronte jetë. Kur nuk kishte më fuqi të çohet më këmbë, i mbështetur mbi supin e imam Aliut (r.a.) e të Fadlit Abbasit (r.a.),²⁷ doli në xhami, e mbajti këtë fjalë para sehabëve:

“ايها الناس ان كنت جلدت ظهراً فهذا ظهري فليستقدمي و ان كنت شتمت له عرضاً فهذا عرضي فليستقدمني و من اخذت له مالاً فهذا مالي فليأخذ مني ولا تخشى الشرحاء من قبلى فانها ليست من شانى..”

“O popull, po të ketë ndonjë që t’i kem rënë, ja ku e ka shpinën time, le të vijë ta marrë hakun e vet! Po të ketë ndonjë që ta kem sharë, ja tek e ka dinjitetin tim; le të vijë të marrë hakun e vet! Po të ketë ndonjë që t’i kem marrë mallin, qe malli im; le të vijë ta marrë hakun e vet. Merreni hakun tuaj pa u trembur e mos kini frikë se po ju zemërohem, sepse kjo gjë nuk pajtohet aspak me karakterin tim!”

Profeti i lartë kështu e zbatonte Ligjin e Zotit. Sipas fjalës që na vjen nga e madhja, nëna jonë, Hazreti Aisheja (r.a.),
“Hazreti Muhammedi ka qenë Kur’ani i gjallë.”

Kur e kanë pyetur për moralin e Profetit, nëna Aishe është përgjigjur: *“Kane khulukuhu’l Kur’an”* **“Dispozitat e Kur’anit janë morali i Tij.”**

Kur’ani është burimi i drejtësisë dhe i mirësisë, është kushtetuta e barazisë dhe e lirisë. Kemi shumë arsye të themi se drejtësia, mëshira dhe liria që duken në popujt e Perëndimit, janë ndikimet e udhëzimeve të Kur’anit të lartë. Lartësia morale dhe virtytet shoqërore që shihen në popujt e qytetëruar janë transmetuar nga kalifët e Abbasidëve, nga Salahuddini Ejubija* e nga të tjerë kalifë të ndershëm të

²⁷ r.a. shkurtim i radijAll-llahu anhu/anha (Zoti qoftë i kënaqur me të!)

* **Salahuddin el Ejubi:** (Salahuddin “El Meliku’n Nasir” Ebu’l Mudhaffar, Jusuf Ejub). Salahuddini njihet në historinë e Islamit si themeluesi i dinastisë së ejubive dhe heroi i luftës kundër kryqëzatave.

Perandorive Islame. Ata që duan shpjegime më të gjata për këto tema, le të lexojnë historinë.

Periudhat e shkëlqyera që përmendëm, janë gatuar me dorën e dishepujve të Hazreti Muhammedit, të cilët janë yje të ndritshëm me dritën e diellit profetik.

“Dishepujt e mi janë si yjet që bëjnë dritë; pas cilitdo që të shkon, e gjeni rrugën e mbarë”, - ka urdhëruar Profeti i lartë.

Kur’ani na udhëheq që të njohim një Zot, të adhurojmë vetëm një Zot, t’i drejtojmë shpresat tona vetëm te një Zot, te Zoti i Amshuar.

Shumë ajete të Kur’anit janë formula që i garantojnë njeriut pavarësinë dhe lirinë e plotë, duke ia dëftuar detyrat dhe përgjegjësitë e fesë e të jetës. Ja disa ngakëto ajete:

كُلُّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ رَهِينَةٌ ﴿٣٨﴾

“Çdo person është peng i asaj që fiton.” (Sure “El Muddeth’thir”, ajeti 38.)

...لَهَا مَا كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا اكْتَسَبَتْ ﴿٢٨٦﴾

“Çdo njeri të mirën e ka për vete e të ligën kundër vetes.” (Sure “El Bekare”, ajeti 286)

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ﴿٧﴾ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا

يَرَهُ ﴿٨﴾

“Kush bën një të mirë sa një thërrime, e sheh. Dhe kush bën një të ligë sa një thërrime, e sheh.” (Sure “Ez Zelzele”, ajetet 7, 8)

Ka edhe shumë ajete si këto, të cilët e shpëtojnë njeriun nga pengimet e paarsyeshme e nga tiranitë e padurueshme të botës e të feve të pathemelta, që paraqiten si të vërteta. Këto ajete janë parime dhe udhëzime që ia sigurojnë njeriut pavarësinë e vërtetë dhe e lidhin me virtytin dhe me ndërgjegjen morale. Sikurse ajri atmosferik që ushtron ndikimin e vet mbi të gjithë, dashur pa dashur, ashtu edhe ligjet ushtrojnë ndikimin e vet pak a shumë mbi çdo popull, sikur edhe të mos i besojnë. Ishte ndikimi moral i Kur'anit që e kundërshtoi²⁸ tregtinë e indulgjencave, me të cilat ishte vënë në pjacë Xheneti!

Kur'ani është e atillë gurrë e begatë që zë vendin më të nderuar kudo ku ka kulturë e inteligjencë. Respekti që kanë për Kur'anin të gjithë dijetarët e Perëndimit pa përjashtim dhe lëvdatat që i kushtojnë vlerës filozofike e morale të ajeteve kur'anore këta dijetarë të nderuar, janë prova që dëshmojnë se Kur'ani dhe feja islame do ta hapin horizontin derisa të mos mbetet asnjë krahinë jashtë e në këtë mënyrë do të zbulohet sekreti i ajetit të lartë:

هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ

كُلِّهِ ... 

²⁸ e shfuqizoi.

“Allahu është Ai që e dërgoi Profetin e Vet me dritën e me fenë e së Vërtetës, që të triumfojë e të dallohet mbi të gjitha fetë e tjera...” (Sure “El Fet’h”, ajeti 28)

Kur’ani emërmadh, me parimet e veta është në gjendje ta administrojë botën derisa të zhduket jeta. Për probleme të veçanta të jetës, të politikës e ndonjë tjetër nuk ka ndonjë dispozitë të formuluar prerazi as në Kur’an, as në Hadith. Kur’ani e ka lënë hapur shtegun e arsyetimit (ixhtihadin) e, me këtë mënyrë nuk ka lënë nevojë për të kumtuar një tjetër libër nga Selia e Amshuar.

II

Javën e kaluar patëm dhënë disa hollësi për vlerat e larta të Kur’anit si edhe për disa shprehje letrare që kundërshtarët nuk i kuptojnë, ngaqë janë të paaftë ose ngaqë nuk duan t’i kuptojnë. Ata i ka verbuar smira e fanatizmi, prandaj lëshojnë një breshër kritikash të paarsyeshme e të palogjikshme kundër librit të Zotit të Amshuar. Ata shumë shpejt do të pendohen për këtë guxim të tepruar, atë ditë kur do të thirren për t’i dhënë llogari Krijuesit të lartësuar, të Cilit ia kritikojnë urdhrin, por kjo pendesë do të jetë tepër e vonë. Patëm shpjeguar gjerë e gjatë madhësinë e Kur’anit e në fund patëm thënë se për çështje e probleme që nuk përmenden në Kur’an e në Hadithet Profetike, është lënë hapur porta e Ixhtihadit, domethënë, dijetarët kompetentë lejohen të arsyetojnë e të vendosin me gjeninë e tyre. Me të vërtetë, Kur’ani e porosit këtë gjë në suren “Ali Imran”, ajeti 104, ku urdhëron e thotë:

وَلَتَكُن مِّنكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنكَرِ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿١٠٤﴾

“Le të jetë një parti prej jush (një grup njerëzish) që ta thërrasë popullin në hajr, ta udhëheqë kah e mira e ta largojë nga e liga; vetëm kjo parti ka gjetur rrugën e vërtetë dhe ka shpëtuar.” (Sure “Ali Imran”, ajeti 104)

Po për këtë qëllim urdhëron edhe ajeti 38 i sures "Esh Shura":

...وَأْمُرْهُمْ شُورَىٰ بَيْنَهُمْ ... ﴿٣٨﴾

“Puna e myslimanëve bëhet me bisedim.”²⁹

Këtë gjë, po me një mënyrë tjetër e ka porositur ajeti 122 i sures "Et Teube":

فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ ﴿١٢٢﴾

“Duhet të ketë ndër ju një grup të posaçëm që t'i mësojë e t'i kumtojë veprimet e fesë dhe shenjat (argumentet) islame.”

Këta urdhra të lartë të Kur'anit dëftojnë se në elementin mysliman kurdoherë e në çdo shekull duhet të ketë një klasë dijetarësh, të pajuar me kulturë të gjerë e me dituri e kompetencë të plotë, që të vendosin mënyrën e veprimit për çështje të reja që nuk janë zbërthyer.

²⁹ me bisedime, me këshillime.

Në punë të ixhtihadit, Kur'ani i lartë na shtyn të zgjedhim anën e lehtë praktike. Për shembull, në ajetin 185 të sures El Bekare na urdhëron:

استعِذْ بِاللّٰهِ: يُرِيدُ اللّٰهُ بِكُمْ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمْ الْعُسْرَ... ﴿١٨٥﴾

“Zoti, me madhëri të Vet ju dëshiron të lehtën e jo të vështirën.”

Në suren Haxh, ajeti 78 urdhëron:

استعِذْ بِاللّٰهِ: وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ ﴿٧٨﴾

“Zoti nuk ju ka ngarkuar ndonjë gjë të vështirë në punë të fesë.”

Po kaq e qartë dhe e kuptueshme është edhe porosia e Hazreti Pejgamberit (alejhis selam) me këtë hadith sherif:

(يسروا ولا تعسروا)

“Dëftoni lehtësi dhe jo vështirësi!”

Për të vërtetuar nevojën e ixhtihadit për çështje të reja që dalin ndër myslimanët, le të këndojnë këtë dokument historik që na ka mbetur i shkruar prej dorës së Omerit, (r.a), kalifi i dytë i Hazreti Pejgamberit (alejhis selam). Në këtë dokument, Hazreti Omeri i jep udhëzime ligjore gjykatësit të tij, Kadi Shurejhut:

...اما بعد فاذا جاءك شيء في كتاب الله فاقض به ولا يلتفتنك عدد الرجال فاذا جاء

امر ليس في كتاب الله فانظر سنة رسوله فاقض به وان جاءك امر ليس في كتاب الله

ولم يكن فيه سنة من رسول الله فانظر ما اجمع عليه المسلمون فخذ به

“Gjykimet e vendimet që do të japësh, duhet t'i mbështetësh në Kur'an. Në qoftë se do të qëllojë ndonjë çështje, për të cilën Kur'ani nuk flet

qartas, kërko ndonjë Hadith sherif që ta bazosh e po s'e gjete edhe këtu bazën, atëherë do ta mbështetësh gjykimin tënd aty ku do të bashkohen dijetarët kompetentë të Islamit. T'i vësh mendjen e mos të të prapsojë ndokush nga e drejta dhe nga e vërteta."

Ky dekret i Omerit e shpjegon shumë qartaz nevojën dhe mënyrën e ixhtihadit që duhet të bëjnë myslimanët sipas ndryshimit të kohës e të gjendjes. Veçse ka një çështje ku duhet të ndalohemi e të shpjegohemi pak, që të mos shpërdorohet ixhtihadi.

Ixhtihadi në fenë islame është detyrë dhe nevojë, por duhet ditur se është më e larta shkallë e diturisë.

Po ta mbyllësh fare e të mos ia japësh askujt këtë pozitë ³⁰ të lartë, është një gabim i madh që e dënon parimin islam si të paaftë kundrejt problemeve të mëdha që mund të sjellin shekujt. Është gabim edhe më i madh liberalizimi, lëshimet që mund të bëhen ndaj njerëzve me aftësi të përciptë kulturore, me njohuri të pamjaftueshme në fushat specifike e t'u lirosh frerin personave të pamërituar për këtë post të lartë, sepse njerëzit që nuk kanë zotësi, e ngatërrojnë të vërtetën. Prandaj, me këtë problem të rëndësishëm mund të merren vetëm ata dijetarë që janë të zotë dhe kanë dituri e kulturë të gjerë.

* * * *

Një tjetër virtyt i Librit tonë të shenjtë është porosia që jep për *drejtësi* e *bamirësi*, të cilën Kur'ani e shpjegon me terma të qartë e përfshirës. Le të këndojmë ajetin 90 të sures En Nahl:

²⁸ Shih edhe këtë përkthim: "Thuaj: Në qoftë se ndodh që baballarët tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj... janë më të dashur për ju se Allahu ose se i Dërguari i Tij ose se lufta (përpjekja) për kauzën e Tij – atëherë, prisni që Allahu të sjellë Vendimin e Tij..."

³⁰ Ta heqësh nga përdorimi dhe të mos e ngarkosh njeri me këtë detyrë...

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَايَ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ
الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿٩٠﴾

“I madhi Zot urdhëron drejtësi e bamirësi, urdhëron për të ndihmuar të afërmit dhe ndalon të ligat, të këqijat e prapësitë...” Le të vështrohet rëndësia e pikës së dytë, *“të ndihmuarit e të afërmit”*. Kjo frazë na jep një mësim të vërtetë për mbrojtjen e përkrahjen kombëtare. Për këtë pikë nuk do të qëndrojmë me shpjegime të gjata, meqenëse është jashtë temës. Në qoftë se ka ndonjë zotëri që dëshiron të marrë shkoqitje më të hollësishme, le të urdhërojë në një bisedë të veçantë, se jemi gati t’i japim njoftime të mjaftueshme. Ka urdhër të posaçëm kur’anor që na ndalon të neglizhojmë e na qorton kur tolerojmë të metat e vogla. Për këtë pikë le të dëgjojmë ajetin 24 të sures Et Teube:

“O i madhi Profet, kallëzoji popullit tënd se, ka mjerim për ata të cilët, luftës që duhet të bëjnë për mbrojtjen e së drejtës e të së vërtetës, (për mbrojtjen e rrugës së mbarë të Zotit e të Profetit) nuk i japin një vlerë më të madhe se vlerës që ata u japin prindërve, fëmijëve, pronave e tregtisë së tyre.”

²⁸ Porosia e Kur’anit, e këtij libri të shenjtë urdhëron e na mëson se zbatimi i urdhrave të Allahut që janë të drejta e të vërteta, nuk sigurojnë vetëm dobitë e jetës së pasosur, por garantojnë edhe lumturinë e kësaj jete.

Të shohim ajetin 66 të sures “Maide” që shpjegon një mësim tjetër të Islamit:

وَلَوْ أَنَّهُمْ أَقَامُوا التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ وَمَا أُنْزِلَ إِلَيْهِمْ مِنْ رَبِّهِمْ لَأَكَلُوا
 مِنْ فَوْقِهِمْ وَمِنْ تَحْتِ أَرْجُلِهِمْ ۚ ... ﴿٦٦﴾

“Ata që zbatojnë plotësisht dispozitat e librave të vërtetë të Zotit, fitojnë lumturi morale e materiale.”

Mund t’u duket e habitshme përmbajtja e lartë e këtij ajeti të shenjtë atyre që kujtojnë se realiteti i fesë është i përbërë vetëm prej adhurimeve individuale. Por ata që e dinë se feja e vërtetë është që t’ia njohësh dhe t’ia japësh gjithçkaje të drejtën që i përket, nuk mund të gjejnë fare pengesë që ta pranojnë e ta pëlqejnë madhështinë e përmbajtjes së këtij ajeti, qoftë edhe vetëm nga pikëpamja materiale.

* *
 *

Një nga virtytet e çmuara të Kur’anit është rëndësia e madhe që ai i jep jetës shoqërore. Siç dihet, shtylla themelore e jetës shoqërore janë marrëdhëniet e mira e të ngushta midis të pasurve e të varfërve. Kur’ani fisnik e ka përcaktuar bazën ligjore duke i ngarkuar myslimanët me detyrën që t’u japin të vobektëve pjesë nga pasuria e tyre. Për këtë janë kumtuar shumë ajete. Këshillat e porositë për ndihmën materiale (*Zekat, sadeka*) janë thelluar shumë (*u është kushtuar shumë vëmendje*), saqë të shtrënguarit e dorës në këtë detyrim titullohet rrezik.

Dhe, me të vërtetë, sikur të gjithë pasanikët t’i shtroheshin dispozitës së Zekatit, që urdhëron Kur’ani, shoqëria njerëzore

nuk do të përplasej në rrezikun e bolshevizmës. Dëgjoni, ju lutem, këtë ajet të ndritur:

استعِذْ بِاللّٰهِ: وَأَنْفِقُوا فِي سَبِيلِ اللّٰهِ وَلَا تُلْقُوا بِأَيْدِيكُمْ إِلَى التَّهْلُكَةِ ...



“Ushqeni të vobektët për riza (hir, hatër) të Zotit e mos e shtini veten në rrezik!” (Sure “El Bekare”, ajeti 195)

U bë një orë që po flasim për cilësitë e mrekullueshme të virtyteve të Kur'anit.

Ora u mbush e tema nuk u përfundua. Shpjegimit të kësaj teme, jo orët, ditët, muajt e vjetët, por as shekujt nuk i mjaftojnë. Ka 1400 vjet që njerëzit e ditur po shkruajnë vëllime të panumërta për lartësinë e Kur'anit e megjithëkëtë nuk mjaftojnë. Edhe tash, në këtë çast njeriut i lindin në mendje veçanti e virtyte të tjera që nuk i kemi pëmendur, sepse është Fjala e Zotit të pasosur. Këtë mrekulli e shkoqit vetë Kur'ani me ajetin:

قُلْ لَوْ كَانَ الْبَحْرُ مِدَادًا لِّكَلِمَاتِ رَبِّي لَنَفِدَ الْبَحْرُ قَبْلَ أَنْ تَنفَدَ

كَلِمَاتُ رَبِّي وَلَوْ جِئْنَا بِمِثْلِهِ مَدَدًا ﴿١٠٩﴾

“O Profet i dashur, kallëzoji njerëzisë se, sikur deti të bëhet bojë për të shkruar e për të shpjeguar fjalën e Zotit, deti soset, fjala e Zotit nuk soset.” (Sure “El Kehf”, ajeti 109)

Prandaj, duhet ta ngushtojmë qarkun e bisedës e ta përmbledhim me një konstatim më të përkufizuar: "Po të vështrohet me kujdes çdo ajet i Kur'anit, Ai (Kur'ani) ose

urdhëron për një virtyt, ose na tërheq vërejtjen për ndonjë ves e ligësi."

I madhi Zot na shkëlqeftë me dritën e lartë të Kur'anit! Amin!

III

Kur'ani, libri i shenjtë islam, e përmbledh fenë e lartë islame me një fjalë të vetme: **“Njëtim, Teuhid.”** Kjo fjalë është përkufizimi i fesë islame, sikurse Kristianizma që shfaqet me një fjalë të vetme, *Mëshirë*. Fjala “Mëshirë” është përkufizimi i Kristianizmës së vërtetë, sepse populli i Israilit, të cilit Zoti i dërgoi për Profet Krishtin, Hazreti Isanë (alejhis selam), në atë kohë kishte nevojë për mësimin e mëshirës. Misioni i Krishtit, meqë nuk ishte për çdo kohë e për çdo vend, u kufizua vetëm në mëshirë.

Sipas ungjillit të Shën Mateut, vetë Krishti urdhëron e thotë:

“Unë erdha për të udhëhequr vetëm grigjën e Israilit, që ka humbur rrugën.” Kjo deklaratë e Krishtit dëshmon se ai Profet i lartë nuk është dërguar për të gjithë njerëzinë, por vetëm për popullin e Israilit. Koha e atëhershme e kishte shtypur keq këtë popull, prandaj Krishti këshilloi mëshirë. *Çdo mysliman e ka për detyrë feje të besojë se Krishti është një Profet i lartë që e kreu plotësisht misionin e vet.*

Mirëpo feja islame nuk mund të jetë vetëm “mëshirë”, sepse Profeti i lartë Muhammed është dërguar me mision të gjithësishtëm (universal), për çdo kohë e për çdo vend. Për këtë mision universal flet vetë Kur’ani në ajetin e lartë:

اسعِذْ بِاللّٰهِ: وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِّلنَّاسِ ... ﴿٢٨﴾

“Ty, o Profeti Im i dashur, të kemi dërguar përmbi krejt njerëzinë.” (Sure “Es Sebe”, ajeti 28)

Në pikëpamje shpirtërore, të gjithë njerëzit nuk janë në një gjendje të barabartë dhe nuk kanë të njëjtën sjellje, prandaj disa herë e për dikë "mëshira" është edhe e dëmshme. Për këtë shkak feja islame nuk mund të shprehet me fjalën "mëshirë". Fjala e përshtatshme për këtë qëllim është "Njëtim-Teuhid", që është qëllimi i krijimit të njeriut. "Njëtim" do të thotë "besimi se Zoti është Një i Vetëm e nuk ka shok as me vetveten, as në attribute e as në vepra." Shkolla islame e edukon njeriun sipas nevojës me anën e njëqind emrave. Feja islame përdor njëqind metoda për ta edukuar njeriun. Natyrës së çdo njeriu do t'i përshtatet njëra nga këto njëqind metoda. Kështu, kjo fe e lartë përpiket për të siguruar përparimin e plotësimin e çdo njeriu si në këtë botë, ashtu edhe në botën e amshuar. Myslimani, që është i përgatitur për të edukuar e për të udhëhequr njerëzinë në rrugë të mbarë, kur takon një të pafuqishëm, të shtypur nga tirania, nga despotizmi barbar, kujton emrin e Allahut "*Rahman Mëshirues*"³¹ Fuqia e këtij emri e mbush me dhembje dijetarin edukues; atëherë, ai i kthehet mëshirës për të shpëtuar atë që vuan. Kur i del para një keqbërës, myslimani sjell ndër mend emrat e Allahut "*Adil*" i Drejtë e "*Muntekim*" Hakmarrës dhe kështu, për të futur në rrugë të mbarë këtë barbar, përdor drejtësinë me paanësi. Myslimani udhëhiqet prej emrit "*Rezzak*" Ushqyes, kur shikon një të varfër, të cilin e ndihmon pa kursim.

Kur shikon myslimani se armiku ia mësyn fenë e atdheun, i kundërpërgjigjet sipas kuptimit të këtij ajeti:

³¹ Në disa libra autorësh të tjerë, ky emër i Allahut jepet me "*Gjithëmëshirshëm*".

...فَمَنْ أَعْتَدَىٰ عَلَيْكُمْ فَأَعْتَدُوا عَلَيْهِ بِمِثْلِ مَا أَعْتَدَىٰ عَلَيْكُمْ...



“Atij, që ju ngacmon (ju cënon, ju sulmon, ju bie më qafë), përgjigjiuni po me atë masë, sikur ju nget.”(Sure “El Bekare”, ajeti 194)

Myslimani që kërkon t'i bëjë keq dikuj tjetër, qoftë edhe tinëz, sjell ndër mend emrat e Allahut “*Semië, Besir Dëgjues, Vështrues*” dhe kështu heq dorë nga e keqja që deshi të bënte. Myslimani që është mbytur në mëkate dhe pendohet për mëkatet e veta, sjell ndër mend emrat e Allahut “*Gaffar, Settar Falës, Mbulues*”, pasi, siç na mësojnë ajetet kur'anore, në këto cilësi të amshueshme gjen strehë ngushëllimi dhe njeriu mbushet me shpresë:

...وَلَا تَأْيِسُوا مِنْ رَّوْحِ اللَّهِ... 

“Mos e hiqni shpresën nga mëshira e Zotit!” Dhe: **“Mos u dëshpëroni nga e mira e Zotit!”**. (Sure “Jusuf”, ajeti 87)

Myslimani i mbështetur në mëshirën e Zotit, por që nuk i këqyr (i lë pas dore) urdhëresat e ndalimet e Zotit, kupton emrat e Allahut “*Kahhar, Shedidu'l-ikab Shkatërrues, Qortues i rreptë*” dhe duke menduar këto cilësi të Zotit të Amshuar, e përmbledh vetveten dhe bie në udhë të mbarë; nuk ka tjetër rrugë shpëtimi, siç na e vërteton ajeti:

...فَلَا يَأْمَنُ مَكْرَ اللَّهِ إِلَّا الْقَوْمُ الْخَاسِرُونَ 

“Nuk sigurohet kush nga ndëshkimi i Zotit veçse ai popull që ka humbur rrugën.” (Sure “El A’raf”, ajeti 99) ³²

Të mos gënjehet kush se i shpëton ndëshkimit të Zotit për mëkatet e veta. Vetëm ata që kanë humbur rrugën, kuptojnë se i shpëtojnë dënimit.

Shkurt, myslimani i vërtetë, pasi të besojë Njësinë e Zotit (pasi të besojë se ka vetëm Një Zot), e edukon dhe e përmirëson vetveten sipas cilësive të Zotit.

Myslimani është i detyruar të përmirësojë e të plotësojë të dyja jetët. Kjo bëhet duke ndrequr vetveten e duke u pajisur me të gjitha moralet e larta.

Feja islame, kjo fe kaq e lartë, e kumtuar prej Hazreti Muhammedit (alejhis selam), që njeh Një Zot me të gjitha cilësitë e larta dhe pa asnjë të metë, nuk ka dyshim se ka fuqi e aftësi për të administruar çdo klasë shoqërore në çdo kohë e në çdo vend që të jetë.

Përmbajtja e ajetit

Pasi dhamë, pak a shumë shkoqitje për disa hollësi të Kur'anit, le të përpiqemi të interpretojmë sipas kompetencës sonë të ulët, ajetin e lartë që kemi marrë për temë të këtyre konferencave.

Urdhëron, pra Zoti në këtë ajet:

قَالَتَ رُسُلُهُمْ أَفِي اللَّهِ شَكٌّ فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ

“Profetët e tyre u thanë: A ka dyshim në Zotin?” (Sure “Ibrahim”, ajeti 10.)

Sipas tekstit të ajetit, kuptohet se i Madhi Zot i dëfton Hazreti Pejgamberit disa ngjarje historike që u përkasin disa popujve të kaluar, të cilët e mohuan Zotin dhe nuk i dëgjuan këshillat e

³² Shih edhe këtë përkthim: “Të sigurt e ka ndëshkimin e Zotit...”

profetëve. Nisur nga zhvillimi i ngjarjes, vetvetiu del kjo pyetje: Po, a morën vesh ç'thanë mohuesit e Zotit? Po Profetët e ndershëm ç'përgjigje u dhanë, vallë?

Ajeti i përgjigjet kësaj pyetjeje dhe thotë: “Profetët e ndershëm, të habitur nga mohuesit idiotë, u thanë: A ka dyshim në Zotin?!”³³

Pyetja këtu nuk bëhet për të shfaqur dyshimin. Jo. Pyetja bëhet për të dëftuar se nuk është e mundur të dyshohet për diçka, për të cilën as nuk mund të imagjinohet dyshimi. Ajeti ka kuptimin: As që mund të imagjinohet, as që mund të çohet nëpër mend se nuk ka Zot. Në qenien e Zotit nuk ka dyshim. Ajeti ka edhe të tjera figura fjalësh e figura kuptimi, ku fshihen hollësi me vlerë, për të cilat do të flasim sipas rastit e nevojës. Fillimisht, po e nisim nga kuptimi i ajetit.

“A ka dyshim në Zotin?” është një tezë që duhet të vërtetohet. Edhe ne, insha-All'llah, me argumente që do të parashtrojmë, do të provojmë këtë tezë të vërtetë.³⁴ Për këtë parashtrim duhet të flasim gjatë e gjërë.

Në vendin tonë ka shumë veta që nuk merren me teologji. Ata nuk e shohin hyjnorësinë e qartë dhe Njësinë e Zotit; ata mbajnë syze të errëta, me të cilat kurrë nuk mund të shikohet e Vërteta. Sado që drita e së Vërtetës është në shesh, kur mbulohet me perde, nuk duket asgjë. Nga ana tjetër, filozofia materialiste, në shekullin e sotëm shkon duke falimentuar. Nga sa thamë më sipër, të mos kuptohet se ne këshillojmë e porosisim të rinjtë tanë që të mos merren me filozofi e të mos studiojnë doktrinën e materialistëve.

Jo, nuk e kemi këtë qëllim, sepse në fenë islame dituria është e lavdëruar dhe kjo lëvdatë kuptohet prej ajetit:

³³ Fjala është ndërtuar në trajtën e pyetjes retorike që në arabishte quhet *istifhami inqari*.

³⁴ Do të provojmë se ka Zot.

... هَلْ يَسْتَوِي الَّذِينَ يَعْمُونَ وَالَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ... ﴿٩﴾

“A mund të jenë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?” (Sure “Ez Zumer”, ajeti 9)

Sikurse feja që është fjala e Zotit, ashtu edhe shkenca është vepra e Zotit. Pra, fjala e Zotit me veprën e Tij kurdoherë janë në përputhje me njëra-tjetrën e në harmoni të plotë. Kundërshtimi që pandehet midis tyre rrjedh ose nga shkaku se feja nuk është kuptuar mirë, ose nga shkaku se shkenca nuk është zhvilluar ende në atë shkallë që shfaqet ky kundërshtim. Hazreti Muhammedi (alejhis selam) urdhëron e thotë:

من اراد الدنيا فعليه با لعلم ، ومن اراد الآخرة فعليه با لعلم ، ومن ارادهما فعليه با لعلم.

“Kush dëshiron këtë botë, duhet të ketë dituri; kush synon botën e pasosur, duhet të ketë dituri, kush i dëshiron të dyja, duhet të ketë dituri.” Pra, si njëra, si tjetra, si edhe të dyja bashkë mund të fitohen vetëm me dituri.

Në një tjetër Hadith sherif Hazreti Muhammdi (alejhis selam) urdhëron:

اوتيت علوم الاولين و الاخرين

“M’u dhanë të gjitha dituritë e popujve të kaluar dhe të popujve të ardhshëm.” Po të vështrohet më me kujdes ky hadith sherif, kuptohet se me çdo degë të diturisë që të merret njeriu, është pajisur me një cilësi profetike. E thënë me një gjuhë krejt islame, do të arrinim në këtë parafrazë: “Duhet të fitohet çdo dituri që të jetë e mundur; vetëm të mos harrohet qëllimi i diturisë, që është të zbuluarit e së Vërtetës.” Derisa të mos zbulohet e Vërteta, njeriu nuk ka pjesë në detin e diturisë, por në humnerën e injorancës.

Le të kthehemi në temë: ***Në qenien e Zotit nuk ka dyshim.***
 Filozofia islame e provon këtë tezë me argumente të shumtë,
 disa prej të cilëve po i rreshtojmë më poshtë:
 Mendja e pagabueshme, gjykimi i shëndoshë (*akli-selimi*)
 gjithmonë i bindet së Vërtetës. Për ata që mohojnë të
 Vërtetën, i madhërishmi Kur'an urdhëron këto ajete:

***“Nuk mund ta shtiesh ti në rrugë të mbarë atë që do ti,
 por është Zoti Ai që shtien në udhë të drejtë kë të dojë
 vetë.”***

Kur'ani na mëson se ***“nuk mund të bëhet dyshim në
 qenien e Zotit”,*** nuk mund të thuhet ***“ç’janë gjithë këta
 mohues që po shohim”,*** sepse teksti i Kur'anit që cituam do
 të thotë se ***“mendja e arsyeja nuk pranojnë dyshim në
 qenien e Zotit.”*** (Sure “En Nur”, ajeti 46 e sure “El Kasas”,
 ajeti 56)

Qenia e Zotit vërtetohet me dëshmitë e ndërgjegjes e të
 natyrës dhe me prova logjike.

Po përmendim këtu disa dëshmi natyrale të ndërgjegjes:

1- Në qoftë që goditet me shpullë një foshnjë që ka filluar të
 flasë, vëmë re fakte që dëshmojnë:

a) qenien e një krijuesi të pavarur e sovran; b) përgjegjësinë e
 njeriut; c) qenien e gjyqit të Zotit dhe ç) qenien e profetësisë.

- Qenia e krijuesit të pavarur sovran dëshmohet me këtë
 mënyrë:

Posa ta godasësh, foshnja qan e bërtet duke thënë: “Kush më
 ra?”

Kjo dëfton se për shpullën, që nuk ishte e doli në shesh, (*u
 zbatua veprimi i shpullës, u vu në jetë*) kërkohet dhe shihet nevoja
 për një veprues të lirë (*kërkohet autori i veprimit*).

Natyra e njeriut (për një gjë pa rëndësi, sikurse është shpulla), kërkon një veprues të pavarur. Atëherë, edhe për krijimin e Gjithësisë e të fenomeneve të saj, pa dyshim, shihet nevojë e domosdoshme dhe kërkohet ekzistenca e një agjenti Independent e Sovran.

- Përgjegjësia e njeriut dëshmohet me këtë mënyrë:

Foshnja që pësoi goditjen, pasi të marrë vesh se kush e qëllloi, pyet (pse e goditi?). Kjo dëfton se njeriu, për çdo vepër të vetën, pyetet, *pse e bën?* E, kësaj pyetjeje duhet t'i përgjigjet që ta përlligjë veprën. Kjo dëshmon atë që njeriu, krahas lirisë që gëzon, ka edhe detyra e përgjegjësi. Veprat e njeriut janë të kufizuara me urdhra e me ndalesa; njeriu nuk është krejtësisht i lirë të bëjë çdo vepër që dëshiron.

- Qenia e gjyqit të Zotit dëshmohet me këtë mënyrë:

Foshnja që u godit, i lutet babait: “Baba, rrihe këtë që më ra!” Kjo do të thotë se foshnja kërkon dënimin e fajtorit. Natyra e njeriut që për një faj të vogël dëshmon se ka një dënim dhe e kërkon zbatimin e këtij dënimi, është e natyrshme që vërteton se ka një gjyq për të gjykuar veprat e botës e për të dënuar fajtorët.

- Qenia e profetësisë vërtetohet me këtë mënyrë:

Foshnja nuk hesht pa e parë dënimin e fajtorit. Kjo dukuri shpreh nevojën për një njeri, për një specialist, për një personalitet që të dijë të caktojë dënimet dhe të shpallë dispozitat, në bazë të të cilave duhet të zbatohen dënimet. Në të vërtetë, njeriu që përcakton dënimet dhe njofton dispozitat sipas të cilave të zbatohen ato, është Profeti.

Nga shpjegimet që u parashtuan më sipër, njeriu që gjurmon të vërtetën, kupton se shpulla që iu dha foshnjës së vogël, ka hollësi që dëshmojnë se:

-Zoti është, *ekziston*;

-Njeriu është përgjegjës për veprat e tij;

-Ka një gjyq nga Zoti;

-Profetësia është një mision që ka ndodhur me të vërtetë.

IV

SHEMBUJ dhe FAKTE që provojnë se vetë natyra e njeriut dëshmon se ka një Zot.

1- Natyra e njeriut kurrë nuk pranon se është një ndërtesë e përshtatshme për të gjitha nevojat, e hijshme, e bukur dhe e stolisur, por pa pasur një arkitekt a një mjeshtër me zotësi të provuar që ta ketë projektuar a ndërtuar.

Pra, kur një ndërtesë e vetme nuk pranohet prej natyrës së njeriut që të jetë shpikur vetvetiu, si mund të pranohet shpikja e vetvetishme e kësaj Gjithësie të mrekullueshme, që, si nga pikëpamja artistike, ashtu edhe nga pikëpamja mjeshtërore nuk mund t'i shihet as e meta më e vogël?

Atëherë, a nuk dëshmon vetë natyra e njeriut se Gjithësia ka një Zot Krijues?

2- Shpesh qëllon që njeriu bie tepër ngushtë dhe i shuhet të gjitha shpresat e ndihmat që mund t'i vinin nga rrethi (njerëzit e afërm, farefisi etj). Në këtë çast të ngushtë, ndërgjegjja e njeriut thërret e kërkon ndihmë e përkrahje nga një fuqi morale e misterioze që ai nuk e njeh. Kjo thirrje që ndërgjegjja e rënë ngushtë i bën fuqisë së fshehtë, vërteton se natyra e njeriut vetvetiu dëshmon se ka një Zot.

3- Le të mendojmë një qenie. Kjo qenie ose ka, ose nuk ka nevojë për një agjent. Kjo qenie, po nuk pati nevojë për një agjent veprues e shkaktues, është ajo që ne myslimanët e besojmë për një Zot. Kjo qenie, po pati nevojë për një agjent veprues e shkaktues dëshmon se ka një plotësues të kësaj nevoje dhe ky plotësues i nevojave është vetë Zoti i Gjithësisë që besojmë ne myslimanët. Nga kjo del se me pak arsyetim, çdo njeri i çdo katogerie qoftë, vetvetiu dëshmon se ka një Zot dhe se mohimi i Zotit është absurditet.

4- Të vërtetuarit e Qenies hyjnore ³⁵ të pavarësisë së saj, të detyrave të njerëzisë (ndaj saj) dhe të jetës së amshuar, është një nevojë logjike, një sjellje e rezervuar. Pse? Sepse, *sikur të supozohej që nuk ka Një “Qenie hyjnore”, vërtetimi i ekzistencës së saj nuk shkakton ndonjë dëm. Por, në qoftë se ekziston “Qenia hyjnore” dhe ne e mendojmë atë, atëherë është një dëm shumë i madh dhe i pashmangshëm për ne.*

Është rezervim logjik të vërtetuarit e pavarësisë së Qenies hyjnore. Pse? Sepse, sikur ta zëmë që “Qenia hyjnore” nuk ka vullnet, por është e shtrënguar në veprën e saj, për ne nuk shkaktohet ndonjë dëm, po që se besojmë të kundërtën.

Përkundrazi është një dëm i madh që t’ia mohosh pavarësinë dhe ta determinosh (kushtëzosh) atë.

Po ashtu, është një rezervë edhe pohimi i detyrimit të njeriut me detyra, sepse në daltë e kundërta, nga ky pohim nuk kemi ndonjë dëm. Por në qoftë i vërtetë ky detyrim dhe ne besojmë të kundërtën, është dëm mjaft i madh dhe i pandreqshëm.

Kështu është edhe çështja e jetës së pasosur. *Në qoftë se nuk ka jetë pas vdekjes dhe ne besojmë, nuk shkaktohet asnjë dëm. Por, po të ketë jetë pas vdekjes, - dhe ka me siguri - e ne e mendojmë, është një dëm i madh dhe rrezik i pashmangshëm.*

Pra, besimi i Qenies hyjnore dhe i pavarësisë së saj, pohimi i detyrimeve të njeriut dhe vërtetimi i Jetës së përhershme bëhet për të shmangur një rrezik; shmangia e rrezikut është një nevojë e arsyeshme.

Të deklaruarit e ateizmit është një paurtësi e madhe dhe e pafalshme. Si merret vesh edhe nga këto shpjegime, vetë natyra e njeriut dëshmon në dispozitat islame. Këtë e vërteton edhe ajeti 30 i sures “Err-Rrum” në Kur’an:

³⁵ *Qenie hyjnore* Zoti.

فَأَقِمْ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا فِطْرَتَ اللَّهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا ... ﴿٣٠﴾

“Drejtuhu nga feja e vërtetë që është feja islame! Islami është natyra, me të cilën u krijua njerëzia.”

Edhe Profeti islam urdhëron në një hadith:

“ما من مولود الا يولد على فطرة الاسلام ثم ابواه يهودانه و يمجسانه .”

“Çdo i lindur e ka në natyrë të pranojë dispozitat islame, veçse edukata dhe mjedisi ia verbojnë këtë natyrë.”

V

Ta provojmë tani qenien e Zotit me argumente logjike, veçse nuk duhet harruar që vërtetimi i qenies së Zotit nuk do të thotë vërtetim i identitetit të Tij. Është jashtë fuqisë njerëzore të kuptosh indentitetin (*kunh-in*) e Zotit; Njeriut i mungon mjeti për të kuptuar veten e Zotit të Amshuar, sepse, siç e dimë, të vetmet burime të diturisë së njeriut janë shqisat dhe mendja, dy fuqi këto që mund të përfshijnë vetëm kontingjentet (krijesat e mundshme, *mumkinat*); përtej qarkut të kontingjentit, njeriu nuk mund të shtrihet kurrsesi. Në thelbin e gjërave që mund t’i kapin shqisat e mendja nuk ka ndonjë send nga fara (e të domosdoshmit, *uaxhib*) që të na përftojë një ide të saktë. Për këtë arsye të hollë Hazreti Pejgamberi (alejhis selam) ka urdhëruar:

تفكروا في آلاء الله و لا تتفكروا في ذات الله

“Mendoni për gjërat që ka krijuar Allahu si mirësi për njerëzit e mos mendoni për veten e Zotit.”

Shejhu i madh, Muhjidin Arabiu (kaddesAll’llahu sirrehu),

³⁶me frazën e tij

³⁶ *kaddesAll’llahu sirrehu* All-llahu ia shenjtëroftë të fshehtat!

كل ما خطر ببالك والله غير ذلك

“Zoti është ndryshe nga gjithçka që ju vjen nëpër mend”, ka dashur të shpjegonte se është e kotë të mendojë njeriu që ta gjejë me mendjen e vet se qysh është Zoti.

Nga shpjegimet që dhamë deri tani, mund të na dalë një pyetje: Islami është një fe e mendjes dhe urdhëron të pranosh atë që ta merr mendja, atë që ta kupton mendja. Nga ana tjetër po kjo fe urdhëron se nuk merret me mend qysh është Zoti. A nuk janë në kundërshtim me njëri-tjetrin këta dy parime?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje themi: Fraza “Islami është fe mendore” do të thotë: Islami nuk i pranon ato gjëra që në vetvete janë të pamundura mendërisht (*imtina’i akli*). Bie fjala, është e pamundur për mendjen që ta pranojë njëshin për tre e treshin për një; është e pamundur për mendjen që në të njëjtën kohë, ta quash edhe natë edhe ditë. Prandaj, po të ndeshë Islami në thënie të këtilla, i merr me kuptim alegorik dhe i interpreton (i bën *te’vil*) e, nga ana tjetër, pohon pazotësinë dhe varfërinë e mendjes së njeriut. Islami, dijetarët myslimanë e dinë mirë që kjo mendje e pafuqishme nuk mund ta përfshijë qyshjen e vetes së Amshuar. “سبحان الله”

(SubhanAll-llah) është një frazë me rëndësi, me të cilën myslimanët lavdërojnë Zotin e madhërueshëm. Është një thënie lakonike (*muxhmel*) që vërteton se myslimani e pohon me gojën e vet se mendja nuk ka fuqi ta kuptojë qyshjen e Zotit të Amshuar.

Tani, të vijmë e të vërtetojmë Qenien e Zotit të Amshuar sipas sistemit të teologëve islamë.

Teologët islamë e vërtetojnë Qenien e Zotit sipas katër sistemeve:

Sistemi i të pasardhjes (*mesleki huduth*); sistemi i mundësisë (*mesleki imkan*); sistemi i qëllimit përfundimtar (*mesleki gaje*); sistemi i shpikjes (*mesleki ibd" ue ikhtira*).

Sipas sistemit të *huduthit*, qenia e Zotit vërtetohet me dy mënyra.

1- Bota me gjithë lëndën e thërrimet e saj është e pasardhur, domethënë, nuk ka qenë gjithmonë, por është bërë. Çdo gjë e bërë (e krijuar) ka nevojë për bërës, pra bota ka një bërës, i Cili është qenie e domosdoshme, që vetë nuk është as e bërë, as kontingjente (*e rastësishme*).

Vini re, ju lutem, se ky argument që parashtruam, ka dy premisa (*mukaddime*): a) Bota me gjithë lëndën e thërrimet e saj është e bërë. b) Çdo gjë e bërë ka nevojë për bërës.

Në logjikë, premisa e parë quhet *minore* (*sugra*) dhe e dyta, *madhore* (*kubra*). Dihet se, po u pranuan këto dy premisa, vetvetiu do të pranohet edhe pasoja (*netixhe*).

Madhorja e këtij argumenti është evidente, e dukshme, e qartë, kurse *minorja* është teorike dhe duhet provuar.

Le ta provojmë, pra:

Po, bota me të gjitha thërrimet e substancat e veta është e bërë, sepse, siç dihet, bota përbëhet prej entitetesh, qenie objektive, realitete (*a'jan*) e prej aksidentesh, rrethanash, të papriturash (*a'rad*). Si entitetet, ashtu edhe aksidentet janë të bëra; prandaj edhe sinteza e tyre, që është bota, duhet të jetë e bërë.

Minorja e këtij argumenti (Bota përbëhet prej entitetesh (*a'jan*) e prej aksidentesh (*a'rad*)) është evidente, e dukshme, e qartë (*bedihi*), sepse nuk ka dyshim që bota është e përngjizur nga këto. Porse *Madhorja* (si entitetet, ashtu edhe aksidentet janë të bëra) është teori që duhet vërtetuar. Le ta vërtetojmë pra:

Po, entitetet dhe aksidentet, përgjithësisht janë të bëra, sepse e shohim edhe vetë me sytë tanë se disa aksidente bëhen paraneshe e disa tjera dëshmohen me prova:

Lëvizja që vjen pas pushimit, errësira që ndjek dritën, të ftohtët që vjen pas të nxehtit janë aksidente që i shohim me sy. Me këtë argument provohet vetvetiu edhe aksidentaliteti i (rastësia e) të kundërtave të tyre (*didd*), sepse objektit të pabërë nuk i përshtatet një gjë që bëhet e zhduket. Bie fjala, pushimi, po të kthehet në lëvizje, do të thotë se është zhdukur fare, duke u zëvendësuar me një gjë krejt të re e të kundërt. Pra, një gjë që duket, është e bërë, kurse zhdukja e Qenies së Amshuar (*kadim*) është e pamundur (*mumteni*).

Edhe kjo paravënia e fundit është teorike dhe duhet provuar: Zhdukja e Qenies së Amshuar është e pamundur, sepse kjo (Qenie e Amshuar) ose është e domosdoshme (*uaxhibul uuxhud*), ose është një gjë e mbështetur (objekt) për nevojë (*bil-ixhab*) ndaj qenies së domosdoshme.

Pamundësia e zhdukjes së Qenies së Amshuar është në shesh, sepse qenia, ose është një nevojë e esencës (*mukteda-i mahijet*), ose është ajo vetë (*‘ajn*). Shkëputja e nevojës së esencës nga esenca, me fjalë të tjera, shkëputja e gjësë nga vetvetja është absurde dhe e pamundur.

Po ashtu, është e pamundur edhe zhdukja e gjësë së mbështetur (*objektit*) me nevojë ndaj qenies së domosdoshme, se përndryshe duhet të ndryshojë pasoja me shkakun efikas (*illeti muxhibe*), që është e pamundur, sikurse është e pamundur zhdukja e frymëmarrjes prej njeriut të gjallë.

Nga këto shpjegime vërtetohet se pushimi është i bërë (*i krijuar*) sikurse edhe lëvizja e me këtë mënyrë, konsiderohet e provuar edhe paravënia jonë: *Si entitetet, ashtu edhe aksidentet janë të bëra (të krijuara).*

Këtu mund të na thuhet se nuk është i drejtë mëtimi (pretendimi) ynë kur themi se “realizimi i lëvizjes” shihet me sy e realizimi i pushimit dëshmohet me argumente, sepse çdo gjë është në lëvizje dhe pushimi nuk ekziston fare, e meqenëse nuk ekziston pushimi, nuk është e drejtë të thuhet se lëvizja është e bërë. Gjithashtu, meqenëse pushimi nuk ekziston, nuk është e drejtë të thuhet se “pushimi u kthye në lëvizje, e pra u zhduk, e për këtë shkak është gjë e bërë”, pasi gjëja e amshuar nuk mund të zhduket.

Ne përgjigjemi: Po i pranojmë këto teori: “Çdo gjë në botë është në lëvizje dhe pushimi nuk ekziston fare.” Mirëpo është provuar se lëvizja që duket nëpër trupa e nëpër substancat nuk është origjinale, por aksidentale, sepse fizika na ka vërtetuar se trupat e substancat kanë një veçori që quhet *inerci* e kështu, lëvizja është aksidentale. Prandaj, edhe sikur ta pranojmë që bota me të gjitha llojet, pjesët, thërrimet e format e saj është në lëvizje, kjo lëvizje është e bërë (*e krijuar*), meqenëse pushimi është origjinal. Porse, pasi edhe pushimi po u zhdukka, vetvetiu del në shesh se edhe pushimi nuk është i amshuar, por i prejardhur, domethënë, i bërë. Me këtë mënyrë vërtetohet se pretendimi ynë është i arsyeshëm dhe kritika që na u bë është pa vend.

* * *

Pasi u vërtetua se aksidentet janë të bëra (*të krijuara, të prejardhura*), nuk mbetet dyshim që edhe entitetet janë të bëra (*të krijuara, të prejardhura*), sepse entitetet që trajtojnë ³⁷ botën lëndore janë dy duarsh:

a) atomet dhe elementet; b) trupat e ngjeshur prej tyre.

Të parat, domethënë, atomet dhe elementet, që janë të bërë, është në shesh (*kuptohet lehtë që atomet dhe elementet, janë të bërë, janë të prejardhur, të krijuar*), sepse materies nuk i mungon

³⁷ Fjalën *trajton* autori e përshtat me kuptimin “krijon”.

lëvizja, e cila, sipas argumenteve të parashtruara më sipër, është e bërë, sepse është aksidentale (rastësore). Pra, gjëja që mban me vete një send të bërë, është edhe vetë e bërë se, po ta pranojmë si të amshuar, duhet të jetë i amshuar edhe sendi që qëndron me të. Mirëpo të bërën (*krijimin, procesin, fenomenin e krijimit*) është e pamundur ta konsiderosh të amshuar.

Atëherë, na mbetet që së njëjtës gjë t'i mbështetim edhe amshim, edhe bërje, e kjo është absurde.³⁸

Pasi u provua se materia është e krijuar, nuk ka vend për të dyshuar që nuk janë të bëra edhe të gjitha elementet e të gjithë trupat e tjerë, sepse elementet janë ngjeshur prej atomesh, e trupat janë ngjeshur prej elementesh. Meqë u provua bërja e pjesëve (krijimi), është e sigurt që edhe e tëra, që është sinteza e pjesëve, është e bërë (e krijuar), sepse kjo vjen mbas pjesësh. Pra, u vërtetua se, si entitetet, ashtu edhe aksidentet janë të bëra; atëherë edhe *bota, që është e përbërë prej tyre, doemos është e bërë*.

Arsyetimet logjike na dhanë mundësinë të arrinim të provonim se: *Bota është e krijuar, e bërë dhe se Krijuesi i saj, Bërësi është Zoti i Amshuar*.

VI

VËRTETIMI I QENIES SË DOMOSDOSHME ME NJË ARGUMENT TË DYTË SIPAS SISTEMIT TE PREJARDHJES (h u d u t h).

Çdo gjë në botë e ndërron dhe e tjetëron fytyrën e saj. Fara³⁹ kthehet në gjak; gjaku në gjak të zënë,⁴⁰ gjaku i zënë kthehet në mish, mishi në dhjamë... etj.

³⁸ Është krejt e pamundur të pranojmë që e njëjta gjë të jetë njëheraz edhe e amshuar, e përjetshme, edhe e krijuar, e prejardhur.

³⁹ Besojmë se autori e ka fjalën për *spermën*.

Ndryshime e tjetërsime duken edhe ndër yjet, ndër elemente, ndër metale, ndër bimë, etj. Këto ndryshime janë rrjedha e veprës së një Vepruesi të Vërtetë, i cili është Një i Vetëm, Krijuesi i Gjithësisë edhe Qenie e Domosdoshme.

Të gjitha këto vepra të habitshme, të gjithë këto trajtime të mrekullueshme (krijime) kanë mahnitur filozofët e dijetarët e urtë.

Këto kurrë nuk do të kishin ndodhur po të mos kishte një Veprues të Vërtetë, me dije e kuptim të plotë.

Që të shkoqitet e vërteta si duhet, le të parashtrojmë këtu mëtimet dhe argumentet e ateistëve e pastaj t'u përgjigjemi ashtu si e kërkon nevoja e arsyetimit dhe e logjikës.

* * *

Materialistët thonë se bota, si grimcë, si pjesë e si lëndë nuk është e bërë. Si formë mund të jetë e bërë, por si lëndë e si fuqi nuk është e bërë. Që të dyja këto, lënda edhe fuqia, janë të amshuara e të pashqitshme njëra me tjetrën. Lënda e përbërë prej grimcash është aq e hollë saqë nuk mund të mendohet, një thjeshtësi tjetër më përtej. Ajo është më e imët se grimcat. Kësaj lënde origjinale i thonë **eter**. Fuqia që duket në këtë lëndë është lëvizja e vazhdueshme e grimcave të saj. Në çdo grimcë qëndronte një forcë e përhershme tërheqëse e përzënëse (shtytëse). Me këtë fuqi të përhershme grimcat, duke u rrotulluar me rregull të plotë rreth boshtit të vet, vazhduan me harmoni e disiplinë të madhe lëvizjen e tyre në hapësirën e pasosur pa u përplasur kurrë midis tyre e pa e humbur ekuilibrin; me këtë mënyrë këto grimca nuk dilnin nga qarku i lëvizjes së tyre. Duke vazhduar kështu, pa pandehur, një ditë, njëra grimcë doli nga qarku i saj dhe u përplas me një grimcë tjetër. Këto dy grimca u ngjitën midis tyre dhe zunë të tërheqin edhe shoqet e tjera pranë vetes së

⁴⁰ Gjak të mpiksur.

tyre; kështu u prish disiplina e harmonia dhe filloi kaosi.

Atëherë të gjitha grimcat zunë të shoqërohen njëra me tjetrën dhe trajtuan (formuan, krijuan) grumbuj të panumërt. Çdo grumbull i trajtuar në këtë mënyrë filloi të vendosej në hapësirë duke formuar qark të pavarur larg njëri-tjetrit, me largesë (distançë) prej miliarda kilometrash.

Çdo grumbull nisi të rrotullohej rreth boshtit të vet e brenda qarkut të vet, derisa më në fund trajtoi një diell. Yjet fiks të qiellit janë nga një diell i këtillë. Këta diej, duke udhëtuar në rajonet e tyre me rrotullime periodike zunë të shpërndajnë copa të shkëputura prej tyre, ku më të mëdha e ku më të vogla. Çdo diell, me copat që shpërndau, trajtoi një sistem diellor më vete. Një të këtillë sistem trajtoi edhe dielli ynë që na jep dritën jetëdhënëse. Duke vazhduar rrotullimin e vet, dielli ynë u bë një lëng i zjarrtë, prej të cilit u këputën disa copa që u shpërndanë miliona kilometra larg. Edhe copat e shkëputura nisën rrotullimet rreth diellit, e pa asnjë ndërprerje, e vazhdojnë edhe sot, prandaj u quajtën rrotullues. Njëri nga këta rrotullues është edhe rruzulli ynë tokësor, Dheu, mbi të cilin ne vazhdojmë të banojmë. Dheu u largua prej diellit rreth 140 e ca milionë kilometra larg dhe vazhdon të rrotullohet rreth tij duke ruajtur largesën. Natyrisht, edhe Dheu në fillim ishte një lëng i zjarrtë, por u ngurtua dhe zuri sipër një lëvore, nga shkaku që hapësira ku fluturonte Dheu kishte temperaturë prej njëqind e dyzet e dy gradë nën zero (-142). Kjo lëvore po nga ajo arsye, vijoi duke u trashur palë-palë derisa arriti në gjendjen e sotme. Pasi u kalua kjo periudhë, në planetin tonë, së pari filluan të duken mineralet, pastaj bimët, më vonë shtazët e në fund njeriu. Po kjo dukuri ndodhi edhe te botët e tjera. Të vetmit agjentë që ia dhanë Gjithësisë këtë formë janë “material” dhe “fuqia”, të cilat janë të amshuara; këto janë shkaku i gjithë shkaqeve (‘il-letul-‘ilel), ose shkaku

fillestar “il-leti-ula”. Të gjitha shkaqet e tjera e kanë burimin te materia e te fuqia, mbi të cilat nuk mund të imagjinohet më tjetër fill më përtej, meqenëse nuk mund të mendojmë qenien e diçkaje që nuk e shohim. Prandaj, është një vepër idiote (*hamaka*) të besosh, - si thonë teologët, - se përveç lëndës e fuqisë ka një qenie të domosdoshme e të amshuar.

* * *

Kjo që parashtruam është shkurtimisht doktrina e gabuar dhe absurde e materialistëve.

Kjo doktrinë rrëzohet me mënyrat që paraqisim:

1.-

Vetë materialistët thonë se trupat janë ngjeshur prej atomeve (*xhuz-i-ferd*) dhe atomet (thërrimet) kanë rrjedhur prej asaj lëndës fillestare që quhet eter.

Mirëpo atomet, sikur thonë edhe sot, janë njëzet herë më të vogla se trupat më të vegjël që mund të shikohen me mikroskopët më modernë. Prandaj është e pamundur që të shikohen atomet. Meqë atomi nuk mund të shikohet, vetvetiu del se edhe eteri, që është lënda përbërëse e atomit, nuk mund të shihet.

Midis teorisë që parashtrojnë materialistët për mënyrën e krijimit të botës, - duke besuar një lëndë si eterin e një trajtesë të saj si atomin, që, as njëra, as tjetra nuk qenka e mundur të shihen me sy, e, midis mëtimit (pretendimit) të tyre që thonë se përtej lëndës e fuqisë nuk mund të imagjinojmë një veprues suprem, pasi nuk e shohim me sy, ka një kundërshtim flagrant. Ata, nga njëra anë, me teorinë e tyre vërtetojnë se ekzistojnë gjëra që s'i shohim me sy, - sikurse besojnë në ekzistencën e eterit dhe të atomit që, pa pandehur e harroi rrugën dhe i dha shkak që të trajtohet Gjithësia në formën që e shohim; nga ana tjetër, mëtojnë se nuk mund të imagjinojmë një veprues të mbinaryrshëm, me të vetmen arsye sepse nuk u shihka me sy.

A nuk janë kundër njëri-tjetrit këta dy gjykime?

2.-

Teoria e atomit, që papandehur e humbi ekuilibrin, e ngatërroi rrugën dhe na u bë shkak për krijimin e Gjithësisë së pasosur e të mrekullueshme, është një hipotezë më e thatë, së cilës i mungon çdo provë. Teorirat pa prova e pa dëshmi janë absurde e nuk dëgjohen.

3.-

Meqenëse (siç u pranua) çdo atom paska në vetvete dy fuqitë harmonike – tërheqëse (*xhazibe*) e përzënëse (shtytëse) (*dafi'a*) e për këtë arsye e ruajtka ekuilibrin e vet, si ndodhi që pa ndonjë shkak, njëri nga këto atome e humbi ekuilibrin, e ngatërroi rrugën dhe nisi të bashkohej me të tjerët? Meqë pasoja pa shkak është absurditet, si rrodhi kjo pasojë?

4.-

Si ndodhi që, pasi u ndanë atomet eterike nëpër grumbuj, pa ndonjë shkak, grumbujt u larguan prej shoqi-shoqit me miliarda kilometra dhe secili zuri nga një vend të posaçëm e me këtë mënyrë, pastaj u trajtua Gjithësia e mrekullueshme me harmoninë e bukurinë që e shohim? Këtë vepër madhështore a mundet që t'ia mbështetësh një rastësie? A nuk është ky gjykim vulgar dhe i ulët, që mund të dalë vetëm nga injorantët? Grumbujt e atomeve eterike, me vëllimet e mëdha jashtë mendjes së njeriut, a thua e dinin se duhej të largoheshin nga shoqi-shoqi me miliarda kilometra e të zinin nga një qark të caktuar e të posaçëm, që kështu të mos takoheshin midis tyre sistemet yjore që do të trajtoheshin e, gjithësecili t'i administratonte me rregull pjesët vartëse?

5.-

Pas shndërrimit të grumbujve të atomeve eterike në lëngje të zjarrtë, është e pamundur që, pa vepruar një agjent, të shkëputen disa copa, të cilat, vetvetiu të largohen në distancat

që kanë e të zënë vendet që kanë sepse çdo atom i këtyre grumbujve e ka të barabartë fuqinë tërheqëse me fuqinë shtytëse (përzënëse). Kështu, është e pamundur shkëputja, jo e shumë copave, por edhe e një cope të vetme pa ndërhyrjen e një agjenti të jashtëm. Është, gjithashtu e pamundur që këto (copa të shkëputura) t'i ndryshojnë vendet e tyre dhe të mos i zmadhojnë ose të mos i zvogëlojnë largesat që kanë, në qoftë se nuk vepron agjenti i jashtëm.

6.-

Edhe mëtimi i materialistëve se “fuqia është vetë lëvizja” është absurditet, sepse fuqia është shkak ndërsa lëvizja është pasojë, shkak dhe pasoja nuk mund të jenë një gjë e vetme.

7.-

Hapësira ka një temperaturë 142 gradë nën zero. Një të ftohtë i tillë bëri të ngurtësohen e të kthehen në shtangie copat që ishin lëngje të zjarrita, të shkëputura nga amat e tyre e të vendosura në distancat e sotme. Vallë si u ndodhi që kjo hapësirë kaq e ftohtë, më përpara nuk e bëri këtë efekt, po bëri të kundërtën, domethënë, i ktheu në lëngje të zjarrtë grumbujt e atomeve eterike që u trajtuan nga prapësia e një atomi të vet?

Si ndodhi që ajo temperaturë, që në fillim nuk mundi t'i ndalonte trupat e ftohur që të nxeheshin e të bëheshin lëngje të zjarrtë, më vonë mundi ta shuante këtë zjarr, sikurse do të shuajë më tutje edhe të gjithë diejt?

Cili veprim është më i lehtë: shuarja e një shkrepseje, apo shuarja e disa depove të mëdha që kanë marrë zjarr, më e vogla e të cilave është dielli, - sikurse thonë astronomët?

8.-

Le të themi një herë edhe ne se Gjithësia u krijua sipas teorisë së materialistëve. Porse kjo nuk na provon se përtej lëndës e fuqisë nuk ka më tjetër agjent, tjetër veprues, që kështu lënda

e fuqia të pranohen si fill i parë i Gjithësisë. Sikurse e kemi thënë më parë, lënda e fuqia janë të pasardhura e të krijuara; pastaj, edhe bërja e tyre ka ndodhur rrotull kohës.⁴¹

Vetë materialistët thonë se lënda e parë (eteri) ishte shumë i thjeshtë e shumë i hollë aq i thjeshtë e i hollë, sa përtej kësaj thjeshtësie e hollësie nuk mund të imagjinohet një thjeshtësi e një hollësi më e madhe. Pastaj, lënda e ndërroi këtë gjendje dhe mori njëra pas tjetrës forma të tjera, derisa mori trajtë⁴² bota që shohim.

Në qoftë se është e vërtetë kjo teori e materialistëve, duhet që forma e parë e lëndës të jetë e pasardhur në kohë, sepse, po të ishte e amshuar forma e parë e lëndës, atëherë - sikurse e kemi shkoqitur kur kemi provuar se aksidentet (rastësitë) janë të pasardhura - është e pamundur që ajo të zhdukej prandaj, forma e parë nuk do të hiqej kurrë nga lënda e për rrjedhim, Gjithësia nuk do të krijohej kurrësi.

Pra, pasi forma e parë u zhduk dhe në vend të saj erdhën njëra pas tjetrës disa forma të tjera, derisa Gjithësia mori trajtën që shohim, kuptohet se forma e parë qenka e pasardhur dhe për këtë shkak nuk ka dyshim që edhe lënda duhet të jetë e krijuar, sepse shkëputja e lëndës nga forma dhe shkëputja e formës nga lënda është absurde. Gjithashtu, është e pamundur që lënda të ketë pasur më parë një formë tjetër, sepse është e pamundur të imagjinohen forma më të holla se forma e parë, që t'i kenë ardhur lëndës pa u cënuar amshimi i saj.

9.-

Sikur edhe të pranohet amshimi i lëndës, prapëseprapë lënda e fuqia nuk mund të jenë filli i parë, sepse çdo lëvizje ka nevojë për një lëvizës; prandaj, edhe lëvizja e lëndës ka nevojë për një

⁴¹ në raport me kohën.

⁴² *mori trajtë* u krijua, u formësua.

lëvizës e sendi që ka nevojë për tjetrin, është i krijuar esencialisht; edhe lëvizja pra, është e krijuar esencialisht (*buduth dhati*). Atëherë, nuk mbetet dyshim se edhe lënda është e krijuar esencialisht, sepse ndodhet nën ndikimin e një lëvizësi. Ajo gjë që ndodhet nën ndikimin e një vepruesi, pa dyshim, nuk mund të jetë kurrë fill i parë, shkaku i parë (*'il-letul-'ilel*). Pra, lënda e fuqia kanë nevojë për një veprues të amshuar, për Qenien e domosdoshme që është Zoti.

* * *

Filozofi anglez, Spenseri, me qëllim që ta këpuste vargun e Gjithësisë nga Krijuesi, thotë: “Është absurd që vargu i Gjithësisë të përfundojë te Qenia e domosdoshme, sepse njerëzia ka parashtruar dy teori për Gjithësinë. E para thotë se “Gjithësia është vetiu.” Më pastaj u vërtetua se kjo teori ishte e gabuar; prandaj, më vonë u besua se Gjithësia është e bërë (e krijuar) prej një tjetri (prej një agjenti tjetër). Veçse ithtarët e teorisë së dytë rrëshqitën si të parët, duke kujtuar se ky “tjetri” që e bëri Gjithësinë, është qenie e domosdoshme që qëndron vetvetiu.

Nuk menduan se si ky tjetri, mund të jetë qenie e domosdoshme që qëndron vetiu, kur dihet se teoria e qenies së vetvetishme është e rrëzuar. Prandaj edhe ky tjetri nuk mund të jetë vetvetiu, por ka nevojë për bërës.

Kësaj kritike të Spenserit ne i përgjigjemi kështu:

Me të vërtetë, sot njerëzia e kanë kuptuar se teoria që “Gjithësia është vetiu” është hipotezë e gabuar dhe absurde dhe nuk mund të besohet më. Vallë, cili qe shkaku që e shtyri njerëzinë të besojë se Gjithësia nuk është prej vetiu? Nuk ka dyshim se shkaku është shumë i arsyeshëm: njerëzia hetuan realitetet e gjërave e, në hetim e sipër, panë se nuk ka asgjë në botë që të ketë shpëtuar nga ndikimi e nga ndryshimi. Kështu, mbi gjërat që pësojnë ndryshime nuk mund të zbatohet teoria

e qenies së vetvetishme. Prandaj u gjykua se: Gjithësia qëndron me fuqinë e një Tjetri e, ky Tjetri është Qenie e domosdoshme që qëndron vetvetiu dhe për këtë shkak njerëzia thanë se vargu i Gjithësisë duhet të përfundojë te një Qenie e domosdoshme dhe e vetvetishme.

Atëherë si mund të gjykohej absurditeti i teorisë së qenies së vetvetishme edhe mbi qenien e domosdoshme, kur dihet që “Qenie e domosdoshme” ka kuptimin “Qenie e vetvetishme”? Të besosh se nuk është vetvetiu Qenia e vetvetishme, a nuk është një *kontradiktë* (*tenakud*)? A nuk është një mendim krejt jashtë arsyes që pasi të kemi pranuar një herë se Bërësi i Gjithësisë duhet të jetë një Qenie e vetvetishme, të kthehemi të kërkojmë edhe për këtë Bërës një bërës tjetër?

Teoria e Qenies së vetvetishme mund të rrëzohet edhe kur merret në shqyrtim problemi i ekzistencës së Zotit, në qoftë se do të shiheshin edhe te Zoti ndikimet e ndryshimet që vërtetohen te Gjithësia. Zoti është krejt i kulluar, nga këto të meta, se përndryshe, nuk do të ishte Zot, por do të ishte një gjë kontingjente (e mundshme,) (*mumkin*).

Gabimi i Spenserit është, se ai e krahason Zotin me Gjithësinë. Prandaj kritika e tij është pa vend.

VII

Tani le ta vërtetojmë qenien e Zotit sipas sistemit të kontingjentit (*mesleki imkan*).

Çdo gjë në botë ndikohet; asgjë nuk ka mundur të përjashtohet nga ndikimi. Çdo gjë e ndikuar ka nevojë për ndikues. Atëherë, edhe bota ka nevojë për një ndikues, i cili duhet të jetë një qenie e domosdoshme. Qenia e

domosdoshme - do të jetë ose një qenie e mundshme, ose e pamundshme. Qenia e pamundshme nuk mund të ndikojë, sepse është jashtë mendjes ndikimi i një qenieje që nuk ekziston. Në qoftë se këtë ndikim e supozojmë si qenie të mundshme, atëherë kjo ose do të jetë krejt bota, ose një pjesë e saj, ose përndryshe, duhet të pranojmë vargjet e Gjithësisë deri në pafundësi si shkak e si rrjedhim të njëra-tjetrës. Supozimi i parë është absurd, sepse mëton që një gjë të jetë shkak i vetvetes. Edhe supozimi i dytë është absurd, sepse që një pjesë e botës, të ndikojë mbi të gjitha pjesët e saj, një nga të cilat është edhe ajo vetë, do të thotë që të ndikojë edhe vetveten; e kjo është absurde, pasi një gjë nuk mund të jetë shkak i vetvetes.

Po ashtu, është absurd edhe supozimi i tretë që vargjet e Gjithësisë deri në pafundësi të jenë shkak i rrjedha e shoqja-shoqes, pasi kjo përfton qarkullimin periodik, absurditeti i të cilit është provuar me demonstrimin e korelacionit (bashkëlidhjes) (*burhani tedajuf*), që në shqipe mund ta themi prova e bashkëlidhjes. Autori i këtij demonstrimi është filozofi islam, Ibni Sina-i, të cilin evropianët e kanë quajtur Avicena.

Për ta njohur mirë se cili ka qenë ky filozof i madh, le të këndojmë këtë strofë persisht, me të cilën poeti mistik Sinai* (*kudise sirrubu*) ia admiron virtytet e larta:

Ne khabem la xherem ni'met ne der dun-ja ne der xhennet

Hemi gjojem beher saat ç'i der ser-ra ç'i der dar-ra

Qi ja rab men Sinaira sanai dih tu der hiqmet

Tuvan qerdi berishq ajed ravani Bu Ali Sina.

"Unë nuk dua të mira as në dunja, as në xhennet;

* **Hakim ebul Mexhd Mexhdud ibni Adem Sinai** është prej poetëve persianë të shekullit të gjashtë. Ka lindur në vitin 473 (Hixhri) në qytetin e Mervit, Afganistanin e sotëm. Ka vdekur në vitin 545 (Hixhri) po në Merv.

Tinëzisht edhe faqësisht lutem gjithnjë: O Zot, epmë zotësi në dituri e filozofi, se Ti je ai Zot që shpirtin e Ebu Ali Sinas e zgjodhe në një mënyrë që ta kenë zili bota.”

Mirëpo, më parë na duhet ta njohim edhe lartësinë e Sinaiut e këtë na e paraqet Hazreti Meulanaja (Xhelaluddini Rumi) me këto vargje:

Attar ruh buved Senai du çeshmi-u

Ma peji Sinai ve Attar amedim.

“Attari është një shpirt e Sinaiu është si dy sytë e atij shpirti; ne erdhëm pas gjurmësh të Attarit e të Sinaiut.”

Pas këtyre dy strofave kujtojmë se është kuptuar lartësia e Ibni Sinait.

Atëherë, le ta dëgjojmë këtë filozof të lartë se si e provon absurditetin e qarkullimit periodik me demonstrimin e korelacionit që ka vendosur ai vetë: Shkakun që kemi në dorë sot le ta numërojmë si më të mbrapmin e vargut të shkaqeve të pasosura.

Shkaku më i mbrapëm është i bashkëlidhur me më të parin e, kur të vazhdojë vargu, na duhet që shkaku e mbrapëm ta parafytyrojmë sikur i mungon i mëparshmi; kjo gjë është absurde, sepse duhet të mendojmë rrjedhën të pashkaktuar. Nga dy të bashkëlidhurit (bie fjala, bir e babë), të përfytyrosh njerin pa sjellë ndër mend edhe tjetrin, është absurde.

* * *

Tash, ta vërtetojmë Qenien e domosdoshme sipas sistemit të qëllimit final.

Sistemi i qëllimit final dhe sistemi i shpikjes që vjen pas tij janë sisteme të Kur'anit të lartë. Mos kujtoni zotërinj, se dy sistemet e mëparshme janë kundër Kur'anit. Hasha!⁴³ Veçse

⁴³ Jo, aspak, në asnjë mënyrë.

për dy sistemet e fundit Kur'ani flet qartas e për dy të parët, tërthoraz.

Sistemi i pasardhjes dhe ai i mundësisë janë sisteme mendore që e mposhtin dhe e detyrojnë kundërshtarin të heshtë.

Sistemi i qëllimit final dhe ai i shpikjes, më fort se ta shtojnë e ta heshtin mendjen, e bindin dhe e kënaqin ndërgjegjen. Dy sistemet e para kanë aq autoritet, saqë mund t'i bëjnë të heshtin edhe ata që janë destinuar (paracaktuar) me rebelim të përhershëm (*shekaueti-ezelijje*)⁴⁴ e, dy sistemet e fundit janë burimi i kënaqësisë shpirtërore që e shtyn ndërgjegjen të pohojë e të vërtetojë.

* * *

Le të dëgjojmë pra sistemin e qëllimit final (*mesleki gaje*): Në fjalor, qëllimi final (*gaje*) ka kuptimin “anë e mbarim”; si term shkencor jep konceptin “pasoje e paraparë që përftohet nga një vepër.” Pas këtij shpjegimi, themi se në këtë botë “kontingjente” asgjë nuk bëhet kot; në çdo gjë shihet një pasoje plot me filozofi, një qëllim plot me urti e me dije; çdo gjë ka një mision të vetin, një detyrë e një shërbim, asgjë nuk është e kotë. Në këtë çështje kanë qenë të një mendjeje të gjithë dijetarët, filozofët e mendimtarët.

Meqenëse problemi qëndron kështu, a është e arsyeshme dhe e logjikshme, a është sjellje e pajtueshme me meritën njerëzore që librin e Gjithësisë, të mbushur plot me mistere filozofike t'ia mbështesim rastësisë (ashtu qëllloi vetiu) e ta mohojmë Autorin e administratorin e plotpushtetshëm? A s'është një gjë e habitshme për mendjen e njeriut që krijimin e Gjithësisë plot mrekulli e mistere t'ia atribuojë rastësisë, kur kjo mendje deri sot, jo vetëm që nuk ka pranuar, por as nuk ka guxuar të pretendojë që një vepër shumë e vogël u bë papandehur e pa mjeshtër?

⁴⁴ Ndoshta, është fjala për ateistët, si femohues, si kundërshtarë të përhershëm të fesë.

Të madhit Zot i qofshim falë, që për t'u dhënë dritë robve të Vet, ka parashtruar në Kur'an shumë prova për këtë sistem. Këtu po paraqesim disa për nderim:

“All-llahu'l-ledhi khalekas-semauati uel-erda ue enzele mine's-semai maen fe akhrexhe bihi mineth-themerati rizkan lekum = Allahu është ai që krijoi qiejt e Tokën, që ul së eprit ujë, me të cilin nxjerr fruta si ushqim për ju...” (Sure “Ibrahim”, ajeti 32)

“...Ue sekh'khare lekumu'l fulke li texhrije fil bahri biemrihi, ue sekh'khare lekumul'lejle uen'nehare...= Allahu është Ai që vuri nën urdhrin tuaj anije, me të cilën ju udhëtoni nëpër det me urdhrin e Tij; ka vënë në dispozicionin tuaj edhe natën e ditën, që të gëzoni qetësinë e të siguronit jetesën...” (Sure “Ibrahim”, ajetet 32, 33)

“Subhanel'ledhi khalekal'ezuaxhe kul-leha mimma tunbitul'erdu ue min enfusihim ue mimma la ja'lemune= S'ka farë të mete ai Zot, i Cili njerëzit, kafshët, bimët dhe çdo gjë tjetër nga ato që ju nuk i dini, i ka krijuar çift, mashkull e femër.” (Sure “JaSin”, ajeti 36)

Të gjithë këta shembuj na udhëheqin në rrugë të mbarë dhe na japin dritë që të mendojmë se asgjë në botë nuk është kot; çdo gjë është paracaktuar për një qëllim.

VIII

Vërtetimi i Qenies së Zotit të Amshuar sipas sistemit të shpikjes (*mesleki ibda*)

Shihet se të gjithë elementet e ndryshme janë trajtuar (*janë krijuar*) nga atomet lëndore, të cilat kanë një esencë. Ç'është ajo fuqi që po prej një brumi ka gatuar gjëra të panumërta që ndryshojnë midis tyre në cilësi, në ngjyrë, në formë e në

veçori? Ç'është ajo fuqi që po prej një substance ka nxjerrë në shesh “artet” e bukura e të mrekullueshme të Gjithësisë? A nuk shihet nevojë e domosdoshme për një krijues të plotpushtetshëm e të plotditur? Nuk mund të mëtohet (pretendohet) se ndryshimi i cilësisë rrjedh nga ndryshimi i situatës, pasi ndryshimi i situatës nuk e bën të nevojshme edhe ndryshimin e cilësisë. Por, edhe sikur ta pranojmë se ndryshimi i situatës e bën të nevojshme që të ndryshohet edhe cilësia, prapëseprapë mendja pyet se ç'fuqi është ajo që e shkaktoi ndryshimin e situatës.

“Subhane-rabbike rabbil-izzeti amma jesifune = Zoti i madhështisë e i lumturisë është i përsosur dhe nuk ka asnjë të metë e mungesë!” (Sure “Saffat”, ajeti 180).

Arti i përkryer e i mrekullueshëm që shihet në natyrë është vepra e Zotit. Me këto shpjegime vërtetohet se Qenia e Amshuar është aq e dukshme, saqë s'pranon asnjë dyshim. Edhe një njeri i rritur në vetmi në majën e një mali, po të jetë normal e në moshën madhore, në natyrën e tij ka intuitën që, me mendjen e vet të zbulojë qenien e Krijuesit të Amshuar (*qenien e Zotit*) që krijoi Gjithësinë. Besimin e Njësisë së Zotit, që predikon Islami, do ta gjejnë në ndërgjegjen e tyre dhe të gjithë ata biblikë që e kanë kuptuar realitetin. Pa thënë “një”, është jashtë natyrës të thuash “dy”. Politeizmi - po themi në pikëpamje filozofike - është largimi nga rregulla e natyrës. Mohimi i Zotit është rrëshqitja nga pasojat e arsyes, është rënia nga paja njerëzore.

Më lejoni zotërinj, t'ju parashtroj pak historinë e materialistëve që kanë rebeluar kundër arsyes e natyrës së urtë. Qysh në kohët shumë të lashta njerëzia e ka ndier nevojën për të kërkuar e për të hetuar realitetin e qenieve. Ky hetim ka përparuar krahas me përparimin e diturisë njerëzore, veçse këto hetime e kërkime për shumë kohë nuk mundën të hynin

mbas një kriteri filozofik. Këto studime morën ngjyrën filozofike vetëm kah shekulli VI para Krishtit.

I pari që flet mbi lëndën, është filozofi grek Losip e nxënësi i tij, Demokriti. Sipas doktrinės së tyre, lënda është e amshuar; pjesët origjinale që trajtonin format e ndryshme të saj quhen “e pacaktuara” (*apiron-hejula*). Doktrina e këtyre filozofëve është kjo: *E pacaktuara* (apiron-hejula) përbëhet nga atomet, që janë thërrime të imëta, të papjesëtueshme, të përhershme e që lëvizin vetiu. Origjina e objekteve është *e pacaktuara*. Kjo teori vazhdoi deri në shekullin XIX dhe për materialistët ishte aq e vërtetë, sa që njëherë njëlloj si objektet fizike. Sipas kësaj teorie janë zbërthyer krejt e janë studiuar të gjitha mbërthimet kimike.⁴⁵ Ata ishin të mendimit se elementet e trupave të përbërë ishin mbërthyer⁴⁶ vetëm brenda përpjesëtimit të caktuar. Bie fjala, uji përbëhet prej oksigjenit e hidrogjenit në përpjesëtim të caktuar - një oksigjen e dy hidrogjen. Ky përpjesëtim nuk mund të prishet në çdo formë qoftë. Të gjitha bashkimet e tjera mund të krahasohen me ujë. Raporti i një elementi me të tjerët është i qëndrueshëm dhe nuk ndryshon. Po elementi origjinal që është atomi, vallë ç’është në vetvete? Sipas teorisë së Losipit e të Demokritit, atomi është një grimcë e ngurtë që nuk mund të pjesëtohet e nuk mund të matet, sepse i mungojnë të tria të shtrimet (përmasat) gjeometrike (*gjatësia, gjerësia e thellësia*).

Kjo teori është hedhur poshtë nga dy pikëpamje:

- 1- Një gjë, sado e vogël që të jetë, mund të ndahet, në mos me mend, me imagjinatë.
- 2- Një gjë, që nuk ka përmasa gjeometrike, nuk mund të trajtojë (formojë) trupa me përmasa gjeometrike.

⁴⁵ Ndoshta, autori e ka fjalën për bashkimet kimike, komponimet.

⁴⁶ ishin bashkuar, ishin lidhur.

Për shkak të këtyre dy kundërshtimeve, filozofi anglez (U. Tomson) e hedh poshtë teorinë që thotë se eteri është një lëvizje impulsive. Që të shpjegohet më mirë kjo çështje themi: U. Tomsoni thotë që bota është e mbushur tejprtej me një lëndë të hollë, mbi të cilën nuk mund të ketë tjetër gjë më të hollë. Që të dyja këto, bota dhe lënda e hollë janë të ngjitura midis tyre. Atomi s'është tjetër veçse lëvizja impulsive që prodhohet në lëndën e hollë, që quhet eter e që e ka mbushur Gjithësinë tejprtej. Atomi, me lëvizjen e tij shumë të shpejtë ka fituar trajtën e ngurtë, që mund të ndihet. Nga një numër i madh atomesh janë trajtuar xehet (mineralet), bimët dhe shtazët.

Siç kuptohet nga shpjegimet që dhamë nga U. Tomsoni, lënda fillore (*fillestare*) është lëvizja eterike, që me përngjitjen (*bashkëimin*) e shqitjen (*shpërbërjen*) e saj, mbërthen e zbërthen trupat. Për një kohë bukur të gjatë pati sukses ky farë kauzaliteti (*sebebijet*), saqë disa fenomene të natyrës u njohën si të prejshkaktuara. Sipas kësaj u shpjeguan edhe shumë fshehtësira të qenësisë. Mirëpo, dikur u pa se teoria e sipërme nuk u konsiderua e mjaftueshme; megjithëkëtë, shkencëtarët iu mbajtën kësaj teorie derisa u gjet tjetra. Me të dalë në shesh sistemi i ri i kauzalitetit, u la pas dore hipoteza e Losipit dhe e Demokritit. Siç quhej ndryshe, teoria atomistike, e cila pati ushtruar autoritetin e vet për më shumë se dy mijë vjet në lëmin e shkencës, ra nga vlera, pasi mori më qafë dhe prapësoi shumë figura të dijes e të kulturës.

Dy janë shkaqet që e shtrënguan njerëzinë të hiqte dorë nga kjo teori:

- 1- Pamundësia për të gjetur shkakun e lëvizjes impulsive brenda eterit të qetë.

2- Pamundësia për të shpjeguar sesi një lagje atomeash ndehen (*radhiten, rendin*) pas të tjerësh në një përpjesëtim të caktuar, për të trajtuar bashkimet e ndryshme.

Eteri vetë është një hipotezë. Atëherë, është gabim që shkakun e botës (Gjithësisë) t'ia mbështetësh eterit, sepse me këtë mënyrë nuk bëjmë tjetër, veçse mbështesim një hipotezë mbi një tjetër, kur asnjëra nuk është e sigurt. Prandaj shkencëtarët e lanë këtë teori dhe e zëvendësuan me një të re, e cila është kjo: “Realiteti i çdo objekti të botës lëndore është fuqia. Burimi i çdo gjëje është fuqia.”

Kjo teori është dëshmia e fuqisë së amshuar nëpër teleskopin e materialistëve, sepse një fuqie që është e zonja të trajtojë bashkime me forma të ndryshme, nuk është e arsyeshme t'i mohohet dija dhe parapamja.

Mënyra se si u ndryshua mentaliteti (*mëndësia*) i materialistëve në formë të sipërdëftuar është marrë nga një raport që iu paraqit Ministrisë së Arsimit të Francës nga një grup dijetarësh të aftë të shekullit të sotëm (shek. 20). Në këtë raport, pasi paraqiten të gjitha pretendimet (*mëtimet*) e materialistëve dhe bëhen krahasimet logjike, shënohet ky konkluzion: “... Prandaj, të gjitha hipotezat e ndryshme të deritashme kundërshtojnë shoqja-shoqen dhe këto kontraste kurrsesi nuk mund të pajtohen.”

Kjo teori nuk mund të zbatohet mbi objektet e botës shqisore e kështu, as dija, as logjika nuk lejojnë që hipoteza të tilla të pranohen si të vërteta, përderisa nuk janë veçse disa lehtësira për të studiuar disa nga shenjat karakteristike të dukshme të gjërave. Sa për realitetin dhe indentitetin e lëndës, kjo mundet ta kapërcejë gardhin e së panjohurës.

Baza e doktrinës së ateizmit është materia, indentiteti i së cilës nuk dihet fare. Atëherë, ndjekja e kësaj rruge të gabuar a është një vepër logjike?

Duke marrë parasysh pohimin logjik se “nuk mund të akordohen (*të pajtohen*) dy kontraste”, themi se vetë ateistët e pohojnë se argumenti, mbi të cilin e mbështesin mohimin e Zotit, është një iluzion e prandaj vetvetiu vërtetohet se Zoti Është; përndryshe, duhet t’i akordojmë dy kontraste, që është absurd. Atëherë, sa drejt ka urdhëruar Zoti: “E fil-lahi shekkun = A ka dyshim në qenien e Zotit?”

IX

Ateistët e materialistët e mjerë, duke i rënë me not fantazisë së tyre, u rebeluan kundër arsyes. Zërin e lartë të natyrës së thjeshtë të ndërgjegjes së kulluar ata e mbytën në tallazet e errëta të fantazisë. Ata mohojnë Zotin, duke thënë se nuk është e mundur të besojmë në një qenie që nuk e shohim, kurse në anën tjetër nuk e marrin vesh që janë kah pohojnë qenien e mijëra gjërave që s’i shohin. Këta të shkretë, vallë, a do ta mohojnë edhe qenien e dritës? Le të marrim me mend një dhomë të errët, të cilën e ndriçojmë me një mënyrë që të mos kuptohet fare se nga vijnë rrezet e dritës. Në këtë rast nuk mund të thuhet se oda nuk ka dritë; megjithëkëtë, ajo që do të shihet brenda odës, e dimë të gjithë se nuk është drita, sepse nuk mund të përcaktohet. Mirëpo, cili është ai që guxon ta mohojë qenien e dritës në këtë odë? E, në qoftë se do të gjendej një mohues i këtillë, ky do të ishte anormal. Pushteti i Zotit (xh.sh.) është Dritë. “All-llahu nurus-semavati uel’erdi= Zoti është Drita e qiejvet dhe e Tokës.” (Sure “En Nur”, ajeti 35). Lartësia e dritës nuk mund të perceptohet me organin lëndor të të parit. Për të na e shpjeguar këtë hollësi, Kur’ani përmend ajetin “Len-terani”, më të cilin i Madhi Zot i tha Hazreti Musait: “*Kurrë nuk mundesh të më shikosh Mua.*” (Sure “El A’raf”, ajeti 143)

Gjatë shqyrtimit e analizave logjike, dalin përpara çështje që kërkojnë njëfarë përgjigjeje.

“Mendja e shkencëtarëve kompetentë ka mundur të peshojë gjëra shumë të rënda e, megjithëkëtë, këta shkencëtarë kanë mohuar Zotin! Si qëndron kjo punë?”

Jo, zotëri. Po të studiojnë shkencëtarët e përsosur (në qoftë se heqim dorë nga rrjedhat e kohës e të vendit), i gjejmë të përrulur në idenë e hyjnueshme të Divinitetit⁴⁷. Sado që këta njerëz nuk e kanë pasur fatin të marrin dritë nga Profetët ose nga trashëgimtarët e tyre e ta kuptojnë të vërtetën lakuriq, prapëseprapë, sikurse thamë më lart, kanë pohuar se sunduesi i vetëm është fuqia, e cila është një “cilësi e Zotit.”

Filozofët më të famshëm që kanë pasur kompetencë fjale për filozofinë metafizike, e kanë pranuar e vërtetuar Qenien e hyjnueshme⁴⁸. Të tjerët, ata që qëndrojnë në një shkallë më të ulët, me frazat e tyre të zhveshura nga termat teologjike, na japin të kuptojmë se edhe ata kanë qenë të shtrënguar ta pohojnë Divinitetin.

Po e përsërisim edhe një herë, mendja e vërtetë, gjykimi i shëndoshë (*akli-selimi*) e pohon të Vërtetën, qenien e Zotit. Dyshimi në Qenien e amshuar është shenja e të çmendurit, e pandjesisë (e apatisë) dhe e jonormalitetit. E vërteta e ajetit “E fil-lahi shekkun=A ka dyshim në qenien e Zotit?”, kurdoherë është e provuar.

Historia e filozofisë na paraqet personalitete të njohur, shumë prej të cilëve e kanë gjetur dhe e kanë shpjeguar si duhet të vërtetën. Disa të tjerë janë vërtitur rrotull së vërtetës, por nuk kanë mundur që ta shprehin. Shkaku i mungesës së të shprehurit mund t’i mbështetet dështimit të tyre për t’iu

⁴⁷ e qenies së Zotit.

⁴⁸ Zotin.

përshtatur Zbulesës profetike.⁴⁹ Rreptësia që kanë dëftuar disa dijetarë të mëdhenj evropianë kundër feve rrjedh nga yryshi i tyre, me të cilin kanë dashur të luftojnë bestytnitë e shfaqura nën maskën e fesë. Ata që janë zhveshur nga bestytnitë dhe e kanë diktuar⁵⁰ të vërtetën, kanë pushuar antipatinë kundër fesë dhe kanë pohuar të vërtetën që predikon kjo. Ata që e kanë studiuar kritikën, me të cilën Volteri ka mësyre fetë, dhe studimin e mënyrën, me të cilën ky filozof e përshkruan Kur'anin, e kanë kuptuar sesa i arsyeshëm është pretendimi ynë.

* * *

Të shikojmë se si e kanë vërtetuar Qenien e Amshuar disa filozofë:

***De Kartesi*⁵¹**

Që të kuptojmë rëndësinë e thënies së këtij filozofi të madh, më parë duhet ta njohim atë e të mësojmë diçka për jetën e tij. De Kartesi është nga filozofët e shekullit XVII. Ka lindur më 1596 edhe ka vdekur më 1650. Është një filozof prej gjakut francez që ka lënë gjurmë të pavdekshme në historinë e filozofisë. De Kartesi është njëri nga të dy gjenitë e filozofisë moderne, që ia ndërruan filozofisë drejtimin dhe e reformuan metodën e saj. Deri në atë kohë filozofia ishte përqendruar brenda doktrinės së Aristotelit. De Kartesi e zhveshi nga hipotezat dhe e modifikoi (përndryshoi) brenda bazave shkencore. Rruga që ka ndjekur ky filozof për të njohur *Qenien* (*Uuxhud*) dhe *Gjithësinë* (*meuxhudat*) nuk është ndjekur prej ndokujt tjetër më përpara.

Sistemi i De Kartesit ndryshon nga sistemi i Pirhonit – nga filozofët e Greqisë së moçme. I pari “*dyshimin*” e përdori si

⁴⁹ H. Ismeti e ka: ometimit (folje nga italishtja, anglishtja etj: 1. dështoj; 2. harroj, lë pas dore) të tyre që nuk i janë përshtatur revelatës.

⁵⁰ *diktoj* dalloj, shquaj; kuptoj.

⁵¹ Dekarti (Descartes Rene).

mjet për të arritur në të vërtetën, kurse i dyti e përdori si qëllim të filozofisë. Disa kritikë evropianë pretendojnë (mëtojnë) se edhe Pirhoni e ka përdorur dyshimin për të zbuluar të vërtetën. Sidoqoftë, këtij filozofi i prini dyshimi dhe gjatë gjithë jetës nuk mundi të vërtetonte asnjë të vërtetë. De Kartesi, i cili erdhi dy mijë vjet pas Pirhonit, nuk e kaloi jetën me skepticizëm, por nëpër rrugën e dyshimit zbuloi disa të vërteta.

Që të dalim në temë, le ta lëmë mënjanë komentimin e doktrinëve dhe të shpjegojmë argumentet e Dekartesit. Për të zbuluar argumentin vendimtar që të provonte qenien e Krijuesit, De Kartesi dyshoi për çdo gjë, madje edhe vetveten e vuri përkundrejt një pikëpyetjeje. Ai hoqi dorë fare nga Gjithësia dhe tërë vështrimin e vet e përqendroi në hetimin e vetvetes, ku u prir të zbulonte shumë çështje që deri atëherë kishin mbetur mister.

Duke studiuar vetveten, De Kartesi diktoi tri argumente subjektive për qenien e Krijuesit. Kur po kërkonte të diktonte këto tri argumente për qenien e Krijuesit, De Kartesi i parashtroi vetvetes këto dy premisa (*mukaddime*): a) *A ka Krijues gjithësia?* b) *Ç'është ky Krijues?*

Me këto premisa ai nuk desh të zhytej në errësirën e fantazisë, por kërkoj t'u dilte në krye të vërtetave fikse (të ngulitura) e me këtë dëshirë filloi të provonte veten e tij. Duke u thelluar në kërkime, gjeti në mendjen e tij dogma të ndryshme e imitime të trashëguara dhe atëherë, thotë: *“Kërkova të shkarkohem nga e gjitha kjo barrë. Që të dilja në të vërtetën fikse të diturisë, m'u desh të izoloheja nga çdo ndjenjë e trashëguar dhe kështu vendosa që vetëm të vështroj veten dhe të mendohem.”*

De Kartesi ndoqi këtë rrugë dhe e shtriu dyshimin e tij mbi çdo send. Dyshoi për qiellin që e kishte sipër; dyshoi për tokën që shkelte me këmbë; dyshoi...dyshoi...dyshoi...Për

çdo gjë dyshoi; dyshoi deri për ligjet e aksiomat matematike. “*Vallë, a ka kësi sendesh?*”, - pyeste vetveten. Nga këto shpjegime njeriut i vjen të thotë se De Kartesi ra nëpër tallazet e dyshimit dhe nuk qëndroi në të vërtetën. Mirëpo, për De Kartesin çështja është krejt ndryshe. Ky, duke rënë not nëpër valët e dyshimit, zbuloi *burimet e së Vërtetës*. Ai vetë thotë se, “*vetëm për një gjë nuk munda të dyshoj: Për qenien e vetvetes. Sadoqë dikur, - thotë De Kartesi, - pata vendosur që edhe vetja ime nuk ishte, por esencialisht (në të vërtetë) isha, sepse ndieja në veten time fuqinë e të menduarit. Me ta ndier këtë qenie të vërtetë timen, nuk munda të gjeja një tjetër mbështetje që të më vërtetonte të kundërtën. Atëherë paravënia ‘unë jam’ u bë për mua një e vërtetë e pakundërshtueshme. Duke e përfytyruar këtë të vërtetë, dyshimi që bëja për veten time u shfuqizua.*”

De Kartesi, nga lulishtja e tij plot dyshime, shpëtoi me një të vetme dogmë të qartë: “Besimi i qenies së vet.” Ky besim e përcolli De Kartesin në zbulimin e një të vërtete tjetër shumë të lartë: ai diktoi atë, *të Vërtetën supreme të Qenies Hyjnore*, që është i Plotpushtetshëm dhe pa asnjë të metë. De Kartesi, i shtyrë nga kjo vetëdije, tha: “*Sikur të mos kisha të ngulitur në natyrën time atë mirësi, në të cilën kuptoj qenien e një zati*⁵² *shumë më të përsosur se unë, qysh mund të përfytyrohet vullneti im që nuk jam i përsosur të arrij të vërtetën e përsosur e si mund të mendohet se unë e kuptoj që jam në dyshim?*” Kjo e vërtetë që arrita, - thotë De Kartesi, - është një nevojë e natyrës sime. Unë linda duke pasur me vete këto *emanate (ide)*.” Pasi arriti këtë përfundim të lartë, De Kartesi nisi të provonte se vetëdija dhe besimi për Qenien e domosdoshme nuk rrjedh nga arsyetimi i vet, po vjen nga zati i përsosur i All-llahut: “*Kur shqiptoj fjalën ‘Perëndi’, - thotë De Kartesi, - kam për qëllim një fuqi absolute që është e amshuar, sovrane e plotpushtetshme, që di çdo gjë, që ka krijuar Gjithësinë edhe mua. Kur*

⁵² *Zat*, nga arabishtja *dhatun* ka kuptimin “zotërues; thelb, esencë”.

i mendoj këto njohuri të vetëdijes sime, më shtohet edhe më shumë besimi se kuptimin që kam për Perëndinë që diktova, nuk e kam prej vetes sime. Është qenia e pasosur që e ka mbjellë këtë kuptim në ndërgjegjen time që i jam i sosur.”

De Kartesi, si një shkurtesë të shpjegimeve të mësipërme nxori tri argumente që provojnë qenien e Krijuesit:

1) Unë, megjithëse i njoh të metat e mia, ndiej qenien e një zati të pasosur dhe e shoh se këtë ndjenjë e ka mbëltuar (*e ka mbjellë*) tek unë po Ai zat që përmbledh në vetvete të tëra cilësitë e plotë.

2) Vetën time s’e kam krijuar unë, se po ta kisha krijuar vetën, do ta pajosja me të gjitha cilësitë e virtytet e larta që parakuptoj. Prandaj, e shoh që jam krijesa e një zati tjetër, i cili duhet të ketë të gjitha cilësitë e larta, se përndryshe, do t’i shtrohej edhe ai gjithë atij gjyqi që i shtrohem unë.

3) Unë, për qenien e Krijuesit kam një besim aq të qartë, sa është i qartë besimi im se shumica e këndeve të një trekëndëshi është baras me dy kënde të drejta.

* * *

Besimi i De Kartesit në Qenien e Amshuar është një argument i fuqishëm që dëshmon se Ajo (qenia) është shumë e dukshme. De Kartesi që dyshoi për çdo gjë, deri për vetën e vet, nuk mundi kurrsesi të bënte dyshim në qenien e Zotit, për të cilin pati një bindje të plotë; pra, Qenia e Zotit është aq në shesh (e dukshme, e qartë), saqë nuk pranon aspak dyshim.

Shënim i autorit: As De Kartesi nuk ka mundur t’i shpëtonte kritikës që historia e filozofisë i bën çdo filozofi. De Kartesi kritikohet sepse nuk mundi të shpëtonte nga dualizmi. Këtë gjë e studiojnë të gjithë studentët. Prandaj, e shohim të

nevojshme të jepen pak shpjegime për këtë çështje, që t'i kenë parasysh studentët tanë.

De Kartesi ka thënë: **“*Cogito ergo sum*”**, (*Meqë mendoj, do të thotë se jam*). Këtë frazë të De Kartesit e interpretuan ndryshe për ndryshe filozofët e pastajmë dhe gjejnë kundërshtim në mendimet e De Kartesit. Thonë, pra se De Kartesi pranoi qenien e vet sepse mendonte, *domethënë se mendja krijoka të qenët*. Por këtu, e vërteta i rrëshqet prej dore De Kartesit, pasi ajo kalon te Zoti, sado që ai thotë se idetë lindin bashkë me njeriun e nuk i krijon mendja e tij. Kjo akuzë, që i bëhet De Kartesit, u hyn fort në punë ateistëve, që e mohojnë Zotin. Ata kërkojnë të gjejnë të meta te De Kartesi, sepse ky njih Krijuesin e plotpushtetshëm, prej nga ai e merr gjithë dritën e arsyetimit. Harrojnë kundërshtarët e De Kartesit se me frazën **“*Cogito ergo sum*”** (*jam sepse mendoj*) ai e rrëzon teorinë e skeptikëve që thonë se *“nuk e dinë a janë a s'janë”*.

De Kartesi përgjigjet *“jam sepse mendoj”*, por De Kartesi nuk e merr të menduarit si burim të qenies së vet, po si provë. Sa për qenien e vet, Dekartesi e pranon si burim Zotin dhe thotë: *“Unë nuk e kam krijuar veten time, se, po ta kisha krijuar unë vetë veten time, e kisha pajosë atë me të gjitha virtytet e cilësitë e përsosura.”*

Në filozofi kemi dy skaje (terma-istilab) të kundërt:

Immanencë (*të qenët i vetvetishëm*) dhe transhendencë (*epërsi, të qenit suprem*).

Për t'i kuptuar këto dy skaje duhet të dimë se ata që njohin natyrën dhe Zotin janë ndarë dysh. Një palë besojnë se Zoti është brenda në natyrë, është vetë Gjithësia. Edhe njeriu që është një copë e natyrës, bashkë me mendjen e tij është një pjesë e Gjithësisë, pra edhe njeriu ka brenda në trup të tij një copë prej Zotit. Hasha! (*kurrën e kurrës!*) Këtij shpjegimi i

thonë *immanencë*. E kundërta e kësaj quhet *trashendencë*. Ata që besojnë në transhendencë akuzohen për dualizëm e ata që besojnë në immanencë, gjoja e kanë zhdukur dualizmin. Harrojnë këta të fundit se për të thënë *immanencë* duhen dy gjëra që të depërtojnë njëra mbi tjetrën; pra edhe këta e pranojnë dualizmin, por nuk e thonë. Kurse De Kartesi pranon Krijues e krijesa. Krijuesit ia njih pushtetin e dijen e plotë, kurse në krijesat nuk sheh ndonjë cilësi origjinale, por e pranon se çdo gjë që ka krijesa, i vjen nga Krijuesi dhe nuk ka asgjë të vetën; edhe qenia e krijesës është prej Krijuesit. De Kartesi nuk ka dualizëm, sepse në vetvete, ai nuk sheh asnjë fuqi. Me sistemin e tij, ai gjeti Qenien e Krijuesit të Amshuar, që është e qëndron vetvetiu. Kjo pikë nuk mund të shpjegohet si duhet e sa duhet në këta rreshta. Ata që kanë nevojë mund të kërkojnë gojarisht hollësi e shpjegime më të gjëra nga autori i konferencës “A ka dyshim në qenien e Zotit”, ose me të shkruar, nëpërmjet revistës “Zani i Naltë.” Këto shpjegime janë një dokument filozofik i Urdhërit të Zotit. “*E fil-labi shekkun = A ka dyshim në qenien e Zotit?*”

X

Në bisedën e kaluar⁵³ patëm shpjeguar metodën dhe suksesin e De Kartesit, i cili, me disa sqarime që pati dhënë me zotësinë e dijes së tij të gjerë, thua se vërtetonte kuptimin e ajetit të amshuar “**Inna aradnal-emanete...** - *Ne ua ofruam qiejve, Tokës dhe maleve që ta pranonin amanetin tonë...*” (Surja “El Ahzab”, 33)

Edhe me faktet subjektive që parashtroi, thua se interpretonte ajetin e Kur'anit: “*...ue fi enfusikum efela tubsirun - Provat që dëshmojnë Qenien e Krijuesit janë të gjalla në natyrë e në veten tuaj. A nuk e shihni?*” (Surja “Edh Dharijat”, 21)

⁵³ H. Ismeti i ka zhvilluar bisedat e veta publike në disa seanca në mjediset e xhamive të kryeqytetit, përpara dëgjuesve, shumica e të cilëve ishin njerëz me pak apo me aspak njohuri filozofike, por oratori nuk mund ta ulte nivelin shkencor të konferencave.

Sado zhvillim të paktë mendor që të ketë njeriu, këto studime të De Kartesit e bindin dhe i japin siguri të plotë për qenien e Zotit. Veçse, duhet ta dimë që njeriu është “njeri” sepse ka mend e jo pse flet. Imam Aliu (r.a.) ka thënë këtë fjalë të lartë filozofike: “***Lisanul akili min uera-i kalbihi, kalbul ahmaki min uera-i lisanihi*** - “Gjuha e të mençurit është prapa mendjes, kurse mendja e të trashit është prapa gjuhës.” Kjo do të thotë se mendari nuk bën dyshim në qenien e Zotit, kurse ai që e mohon Zotin, është i trashë.

Arsyetimet e De Kartesit janë subjektive (*enfusi*).

Tash le të studiojmë arsyetimet objektive (*afaki*) të Njutonit, duke marrë dritë, prej ajetit të lartë të Kur’anit: “*Senuribim ajatina fil afaki ue fi enfusihim* - Do t’u dëftojmë atyre fakte objektive e subjektive!” (Sure “Fusilet”, ajeti 53)

Kush është Njutoni?

Njutoni ka lindur më 1642 e ka vdekur më 1727. Njutoni është një nga gjenitë më të shquar të popullit anglez. Ai ka *zbuluar ligjin e tërheqjes*; parimet e tij janë baza e të gjitha studimeve shkencore të natyrës. Ato parime, përveç Ajnshtajnit, askush tjetër nuk ka mundur t’i kundërshtojë. Po edhe kundërshtimi i Ajnshtajnit aq shumë u kritikua, saqë⁵⁴ u cilësuan si një imagjinatë krejt pa vend. Përsa i përket krijimit të gjithësisë Ajnshtajni u pajtua me pikëpamjet e De Kartesit, veçse ky e trajtoi këtë dogmë, duke përdorur një metodë tjetër e jo sipas rrugës së De Kartesit.

Të dy këta gjeni - De Kartesit e Njutoni - vërtetuan Qenien e Amshuar, veçse De Kartesi e vërtetoi me argumente subjektive, kurse Njutoni, me argumente objektive. Ky i fundit ishte i njohur për arsyetimin e tij të pagabueshëm e për

⁵⁴ pikëpamjet e tij.

gojëtarinë bindëse. Kur e pyesnin dhe i kërkonin që t'u vërtetonte Krijuesin me prova të fuqishme e të kuptueshme, Njutoni iu përgjigjej pyetjeve duke thënë: *"Nuk është e logjishme që Gjithësinë ta sundojë një nevojë e verbër (darureti amja)."* *"Me gjithë favorizimet kohore e vendore, nuk mund të përfytyrohet dalja e vetvetishme në shesh e rregullit të harmonisë proporcionale (përpjesëtimore) të Gjithësisë. Gjithashtu, nuk është e arsyeshme t'i japësh probabilitet mendimit se harmonia e Universit nuk është efekt i një Pushteti të ditur e me vullnet."*

Këto shfaqje të shkurtra Njutoni i shtjellon duke thënë se: *"Është e pamundur që lëvizja aktuale (e vërtetë) e yjeve qiellorë të rrjedhë nga efekti (ndikimi) i atraksionit (tërheqjes) (xhadhibije); kurrsesi nuk ka dyshim, sepse atraksioni është kryekëput për t'i tërhequr yjet nga dielli. **E, sa për ta përshkuar interseksionin***⁵⁵ ***përmby ekliptikën e diellit, duhet medoemos një pushtet hyjnor."*** Pastaj thotë: *"Është fare e qartë se nuk ekziston ndonjë shkak natyror që të sigurojë drejtimin e përbashkët të të gjitha yjeve nga një anë e vetme pa ndonjë ndryshim. Pra, kur shihet ky rregull artistik e ky kujdes, është e pamundur të pandehet se nuk ka pushtet hyjnor."* *"Nuk ka asnjë shkak natyror, – thotë përsëri Njutoni, – që të mund të sigurojë udhëtimet e rregullta e përpjesëtimore të yjeve fiks e **rrotullues** e të ndjekësve të tyre dhe nuk ka dyshim që i gjithë programi i këtyre lëvizjeve kërkon një pushtet me kompetencë e me autoritet të pavarur. Medoemos dubet një fuqi e amshuar hyjnore që të dijë të peshojë sasisë e elementeve natyrore që ka gjithsecili yll, të caktojë energjinë e atraksionit për sa ka nevojë çdo yll, të caktojë distancat e duhura midis yjeve e diellit e, më në fund, të dijë edhe shpejtësinë e lëvizjes së çdo ylli."*

Dhe: *"Rregulli i mrekullueshëm që harmonizon e balancon edhe ato sende ndër pjesët e të cilëve shihen ndryshime të mëdha, nuk mund të jetë rrjedha e një rasti të verbër e të papandehur, (që qëllon vetvetiu), por*

⁵⁵ *interseksion* ndërprerje; (në gjeometri), pikë e ndërprerjes.

është një fakt i pakundërshtueshëm që dëshmon qenien e një pushteti të amshuar, i cili ka dituri të plotë e të hollësishme për mekanikën dhe gjeometrinë.”

Faktet e sipërdëftuara nuk janë të vetmit argumente që vërtetojnë Qenien e Zotit.

Çdo gjë që prekim është një fakt më vete. Për shembull, të ngjeshurit e yjeve. Thërrimet që kanë trajtuar yjet janë dy farësh: të ndritshme e të errëta. Ato që kanë pasur dritë vetiu, janë tërhequr më një anë dhe kanë formuar yjet me dritë.

Edhe thërrimet e errëta janë tërhequr më një anë tjetër dhe kanë formuar yjet pa dritë. *Që të dalë në shesh vetvetiu ky lloj krijimi, është gjë e pamundur, prandaj është e paarsyeshme të mos besojmë **se ka një Zot, dija e të Cilit nuk ka fund.***

“Një mrekulli tjetër e veprës së Krijuesit është mënyra e organizimit të shtazëve. Me se janë bërë organet e trupit të kafshëve? A ia merr mendja kujt se Ai që krijoi syrin, nuk i ka ditur ligjet e optikës (dituria që studion ligjet e dritës dhe organin e syrit)?! Ai që krijoi veshin, a thua nuk i ka ditur ligjet e akustikës (dituria që studion ligjet e zërit dhe organin e veshit)?!”

Njutoni pyet pastaj: “Instinkti i shtazëve nga e merr dritën, ku e ka burimin që i shtyn kafshët të veprojnë mbas dëshirës së tyre?” Në përgjigje të kësaj pyetjeje Njutoni bën një studim të hollësishëm e të gjatë dhe përfundon: *“Gjithë këto punë të mrekullueshme nuk na lënë dyshim fare se ka një Zot pa trup, që di çdo gjë e që ka pushtet të zhbijë çdo gjë.”*

Njutoni, që flet kështu, duket si të jetë i frymëzuar nga këto ajete të Kur’anit:

- a) “*Ue fil erdi ajatun lil muginin = Në Tokë ka prova për ata që kanë bindje* (Sure “Edh Dharijat”, ajeti 20)
- b) “*Ue min ajatibi kbalkus semauati uel erdi uakhtilafu elsinetikum ue eluanikum inne fi dhalike le ajatin lil alimin = Nga provat që*

dëshmojnë Zotin është krijimi i qiejve e i Tokës, ndryshimi i gjuhëve e i ngjyrave. Në këto argumente, pa dyshim ka mjaft prova për dijetarët.” (Sure “Err Rrum”, ajeti 22)

- c) *“Inne fi khalkis semauati uel erdi uakhtilafil lejli uen nehari le ajatin li ulil elbab = Me të vërtetë, në krijimin e qiejve e të Tokës, në ndryshimin e natës e të ditës ka fakte për të mençurit.”* (Sure “Ali Imran”, 190)

Njutoni, vlera e të cilit u shpjegua më lart, me një gjuhë dijetari, me kompetencë të madhe e me bindje të plotë na thotë se ***nuk është e arsyeshme të dyshosh në qenien e Zotit.*** Kjo thënie e tij vërteton kuptimin e ajetit të lartmadhëruar të Kur’anit: *“A ka dyshim në Qenien e Zotit?”* (Sure “Ibrahim”, ajeti 10)

Sido që për këtë të vërtetë të qartë nuk është e nevojshme të paraqitësh dëshmi, meqenëse një grup të rinjsh shqiptarë kanë rënë në kurthin e materializmit, që ka falimentuar me të gjithë teoritë e veta të trilluara kot më kot, për të nxjerrë në shesh të palarat e kësaj doktrine, e pamë me udhë të ballafaqojmë tezën tonë, mbështetur edhe në pikëpamjet që kanë paraqitur disa nga shkencëtarët e shquar të Evropës, për të cilët brezi i ri ushqen simpati e admirim të madh.

* * *

“De Kartesi, Njutoni e shokët e tyre që kanë besuar në një Zot, - Hafizi shtron pyetjen, - ç’pozitë kanë në fenë islame dhe a mund të njihen si myslimanë?”

Në përgjigje të kësaj pike themi se:

Në dispozitat islame ka një bazë që thotë: *“Kur nëntëdhjetë e nëntë myftinj gjykojnë një njeri për ateist duke sjellë argumente, e, një myfti i vetëm u kundërshton këtyre duke parashtruar argumente për pastërtinë e tij nga ateizmi, parapëlqehet gjykimi i dytë, meqenëse pafajsia (beraeti-dhimmeti) është fill (asl)”. Duke marrë parasysh këtë fill, na përket ta shqyrtojmë çështjen e të shohim nëse*

është e mundur të njihen për myslimanë njerëzit e mësipërm. Autori i “Ruhu’l-Bejanit”, Ismail Hakkiu* (*Allahu ia shenjtëroftë të fshehtat*) duke komentuar ajetin e Selisë dhe Mulla Fenaria (*Allahu ia shenjtëroftë të fshehtat*) duke komentuar suren Fatiha, japin mjaft shkoqitje të qarta në favor të këtyre rasteve, duke qenë të mendimit se këta njerëz mund të hyjnë në rrethin e imanit.⁵⁶ Ata thonë, pra se për ata njerëz që kanë besuar Zotin e amshuar, megjithëse kanë mohuar dërgatën profetike, më në fund, i Plotmëshirshmi Zot do të bëjë mëshirë të drejtpërdrejtë dhe do t’i falë e do t’i përcjellë në Xhennet. Sipas dispozitës së Sheriatit që u përmend më lart, duke parapëlqyer thënien e dy komentuesve të lartpërmendur, mund të themi se njerëzit që besojnë në Njësinë e Zotit mund të hyjnë në Xhennet, se sadoqë në sy të kësaj bote nuk mund të hyjnë në rrethin islam, por në Ahiret, mund të mos mbeten jashtë këtij rrethi.

Veçse duhet ditur se gjykimi që japin u përket atyre që nuk besojnë dërgatën profetike, kurse për ata që e besojnë këtë dërgatë, çështja ndërron: këta njerëz kanë merituar gradën më të lartë të Islamit, sepse kanë gjetur të vërtetën me hetim, që është mënyra e kërkuar prej fesë islame. Shumica e dijetarëve islamë, të shtyrë nga mëshira e madhe e Zotit kanë pranuar fenë e trashëguar ose të imituar, por disa të tjerë nuk e kanë pranuar fare këtë formë të fesë e të besimit. Feja islame është fe e lirë. Ajo predikon lirinë. Ajo e qorton pranimin e fesë së trashëguar prej prindërve e pa hetim e pa

* **Ruhul Bejan**, ky tefsir është shkruar në arabisht dhe persisht. Aty janë përfshirë mjaft vjersha gnostike në persisht. Autori i këtij tefsiri, Shejh Ismail Hakkiu është prej dijetarëve të periudhës osmane. Në Stamboll ka qenë i zënë me predikime e udhëzim dhe më pas shkoi në qytetin e Bursës, i cili është një prej qyteteve të Turqisë. Ishte burrë me natyrë mistike (sufiste) dhe po ashtu, tefsiri i tij është gnostik dhe me mjaft shije. Me ndërmjetësinë e besimeve, sufiu parapëlqehet të mendohej nga bashkëkohësit. Shejh Ismail Hakkiu ndërroi jetë në vitin 1127 h.

⁵⁶ mund të konsiderohen besimtarë myslimanë.

arsyetim. Kur'anî fisnik në shumë ajete urdhëron që të formojmë ide e besim të sigurt për qenien e Zotit të Amshuar duke hetuar veprat artistike e të mrekullueshme të Krijuesit. Në rast se na shfaqet ndonjë çështje e ndërlikuar që na sjell dyshim, duhet të pyesim dijetarët, sipas këtij urdhri të Kur'anit: “*Fes’elu ehledh-dhikri in kuntum la ta’lemun* = *Pyesni dijetarët kompetentë në qoftë se nuk dini!* (Sure “En Nahl”, ajeti 43)

Feja islame është lidhja midis Zotit e robit. Asnjë njeri i jashtëm nuk mund të ketë të drejtë ta këputë këtë lidhje. Prandaj kjo fe është universale, e gjithësishtme, përfshin të gjitha kohët e të gjitha vendet e botës. Islami nuk pranon tirani. Parimi themelor i kësaj feje është monoteizmi,⁵⁷ ai monoteizëm që nuk pranon fare dyshim, sikurse e shpjegon ajeti i lartësuar: “**E fil-lahi shekkun** = *A ka dyshim në Qenijen e Zotit?*”

XI

Një tjetër fakt që na e vërteton e na e forcon idenë e qenies së Zotit është inspirata (*frymëzim*) që duket ndër kafshët e insektet. Inspirata është cilësi natyrore; ajo duket në veprat e mrekullueshme të frymorëve, që habisin mendjen e njeriut. Po të studiohet me vëmendje mënyra sesi shtazët i rrisin të vegjlit, si i sigurojnë nga rreziqet, si kujdesohen për jetën e pjellës së tyre derisa t’i bëjnë të aftë të jetojnë me fuqinë e vet e pa ndihmën e të tjerëve, nuk mundet njeriu të rrijë indiferent (mënjandës) dhe të mos kërkojë Edukuesin e vërtetë e të ditur që u mëson këtyre nga një sistem të veçantë për çdo farë kafshe në përshtatje me rrethanat e jetës së tyre.

⁵⁷ *monoteizëm* besimi se Zoti është Një.

Materialistët e gjorë, kur pyeten se fazat e mrekullueshme të jetës së shtazëve dhe instinktet që u inspirohen, a nuk provojnë qenien e domosdoshme të Rregulluesit Universal, përgjigjen: “Këto cilësi të çuditshme që shihen ndër shtazë janë trashëgime të rrjedhura nga të parët e tyre.” Kjo përgjigje na nxit të mendojmë se ⁵⁸ nuk kanë ndërgjegje të kulluar, nuk kanë veshë e nuk kanë sy. Këta njerëz janë objekti, ku duket (gjen shprehje) ajeti kur’anor:

‘Khatemell-llahu ala kulubihim ue ala sem'ihim ue ala ebsarihim gishaue – Zoti i vulosi zemrat e veshët e tyre edhe në sy kanë perde e nuk shikojnë.’ (Sure “El Bekare”, ajeti 7)

Më tutje, materialistët, për të na mësuar edhe mënyrën sesi u shtjelluan e u plotësuan këto cilësi të shtazëve, thonë: Pas kalimit të një kohe shumë të gjatë, dalëngadalë, cilësitë e fituara u përvetësuan e u ngulitën vetvetiu te kafshët.

Natyrisht, është vendi për kritikën: Po përse vallë, cilësitë u plotësuan “pas shumë kohësh” e nuk u dukën qysh në fillim, kur nisi jeta e farës së tyre? E kanë menduar dhe e kanë pritur kritikën materialistët, prandaj, para se të pyeten, janë munduar të na përgjigjen: Derisa arritën në gjendjen e tyre të sotme, sasi të panumërta kafshësh të ndryshme janë zhdukur; ato që kanë mundur të shpëtonin, i janë përshtatur ligjit të evolucionit e modalitetit derisa janë normalizuar.”

Dihet se këto përgjigje të papërligjura nuk mund ta kënaqin ndërgjegjen e njerëzisë. Megjithkëtë, në shekullin modern, shkenca është zhvilluar e zgjeruar shumë në çdo degë e ka bërë kërkime e zbulime të habitshme edhe në zoologji. Po të studiohen me pak kujdes këto hetime e zbulime zoologjike, shihet se para së vërtetës së diktuar, ashtu si shkrihet kripa në ujë, falimentojnë edhe bien poshtë të

gjitha supozimet dhe hipotezat e pathemelta të materialistëve. Kur të paraqesim këtu më poshtë disa hetime zoologjike, do të kuptojnë lexuesit e ndershëm të “Zanit të Naltë”⁵⁹ se shekulli modern paralajmëron se doktrina e gabuar e materialistëve është kah perëndon përgjithmonë, sepse dëmtoi së tepërmi botëkuptimin e njerëzisë.⁶⁰

Të marrësh një nga një të gjitha kërkimet dhe zbulimet që kanë arritur shkencëtarët nuk është punë që bëhet me disa konferenca të përmbledhura si këto tonat. Prandaj parapëlqyem të përmendim vetëm pak nga ato, që kanë bërë shkencëtarët më të rinj për insektet.

Flutura

Siç dihet, ky insekt, derisa zhvillohet që të marrë emrin *flutur*, kalon disa metamorfoza:

- a) Flutura pjell vezët e saj përmbi një gjethe.
- b) Krimbi del nga vezët dhe ushqehet me gjethe.
- c) Nga krimbi del nusja (nimfa).
- d) Nuses i dalin krahët dhe bëhet flutur.

Ta marrim në shqyrtim e të mendojmë. Edhe në këtë rast lind një pyetje: Si ndodh që, kur doli krimbi nga veza, nëna e tij, flutura, ishte zhdukur? Si e dinte flutura dhe kush ia pati mësuar fluturës që u zhduk se pjella e saj që do të dalë vetiu nga veza, në fillim ka nevojë të ushqehet me gjethe e prandaj i vendos vezët mbi fletët e gjelbra, mbi gjethe? Cili

⁵⁹ Revista “Zani i Naltë” botohej nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Hafiz Ismeti i botonte konferencat e tij publike, në atë (revistë).

⁶⁰ Le t'i kujtojmë lexuesit tonë shkencëtarin bashkëkohor turk, Harun JAHJA, autorin e librit “Mrekullitë e Kur'anit”, i cili, sot, pas më shumë se 70 vjetësh vërteton shkencërisht atë që thoshte profesori ynë i madh, Hafiz Ismet Dibra në konferencat e tij publike në xhamitë e Tiranës.

mund të jetë mësuesi i këtij insekti përveç një Parashikuesi të Amshuar?

Në këtë dukuri, a nuk shkëlqen sekreti i ajetit: “A ka dyshim në Qenien e Zotit?”

Nekrofora

Është një krijesë e njohur tash vonë. Kjo krijesë, porsa të pjellë vezët, ngordh. Nekrofora nuk e ka fatin ta shohë pjellën e vet, as pjella të ëmën. Është vënë re se para se të lëshojë vezët, nekrofora mbledh insekte të ngordhura dhe i depoziton atje ku do të pjellë dhe kështu i përgatit ushqimin e parë pjellës së vet. Kjo ngjarje a nuk dëshmon hirin e një pushteti misterioz? Me këtë fakt a nuk provohet sekreti i ajetit: “A ka dyshim në Qenien e Zotit?”

Bombici

Të vegjëlit e këtij insekti, porsa të lindin, kanë nevojë të ushqehen si parazitë në shtatin e shtazëve të tjera; prandaj e ëma i lëshon vezët në shtatin e shtazëve.

Sfinksi

Të vegjëlit e këtij insekti, me të dalë nga veza, kanë nevojë të ushqehen me lëndë me origjinë prej frymorësh të gjallë. Prandaj, e ëma, pasi i lëshon vezët, gjuan insekte, të cilat nuk i ngordh, por i rreh mirë derisa t’i trullosë e t’i bëjë të pazonja për të lëvizur vendit. Kur çelin vezët, pjella e re gjen gati gjallesat, me të cilat ushqehet.

Eksileguja

Ky insekt është një nga më interesantët që e habit tepër mendjen e njeriut me mençurinë e frymëzuar. Këtë insekt e studion Mil Eduardi, profesor i Universitetit të Sorbonës në

Francë. Ai thotë: “Kjo kafshë e vogël fluturon në verë, jeton në vetmi, pjell vezët e veta pa prekur gjëkundi dhe ngordh sapo të lëshojë vezët. Eksileguja nuk e sheh pjellën e vet, as pjellat nuk e shohin nënën e tyre. Të vegjëlit janë larva pa këmbë e pa fuqi të mbrojnë veten, as nuk janë në gjendje të sigurojnë ushqimin e nevojshëm. Për të plotësuar zhvillimin fiziologjik, kanë nevojë të rrinë të qeta një motmot (një vit) në çerdhet e tyre, të cilat ua pati përgatitur e ëma kur ishte gjallë. Po që se çerdhja nuk i përmbush kushtet e nevojshme, ky insekt kishte për t’u zhdukur. Prandaj, është interesant ta vështrosh çerdhen se me sa kujdes është ndërtuar.

Eksileguja e përgatit çerdhen duke punuar për një vit për të hapur një vrimë të thellë në një copë dërrasë. Pastaj nis të mbledhë nga lulet e nga gjethet e bimëve e të depozitojë shujtën (*ushqimin*) që do t’u lypset larvave për një vit.

Kur afrohet koha e lëshimit të vezëve, eksileguja nis të radhitë një pjesë të ushqimit në fund të çerdhes; aty lëshon edhe një vezë dhe e mbulon me brumin të cilin e gatuan me pluhurin e dërrasës që e siguron gjatë gërryerjes. Pastaj, mbi këtë brumë shtron përsëri një sasi ushqimi që ka mbledhur e mbi të lëshon vezën e dytë që, gjithashtu, e mbulon me brumin e pluhurit të dërrasës si herën e parë. Duke e përsëritur disa herë këtë veprim shumë të kujdesshëm e shërbim të përkushtuar, arrin të ngrejë një ndërtesë me aq kate, sa është numri i vezëve që ka lëshuar. Pas këtij cikli veprimesh, eksileguja vdes. Të gjithë brezat që zhvillohen në çerdhen e familjes së tyre i përmbahen ecurisë së mënyrës së tyre të jetesës si edhe brezat pararendës. Ata e ruajnë me rreptësi racën e tyre.

Profesori Eduard që ka gjurmuar zhvillimin e këtij insekti dhe na informoi për shumë hollësira nga jeta e tij e

çuditshme, shton: *“Kjo panoramë e mrekullueshme duhet t'i trondisë të gjithë ata që kujtojnë se krijimi i Gjithësisë ndodhi vetvetiu dhe papandehur.”*

Përfundimi modest i Profesorit, që sapo e cituam, nga ana tjetër nënvizon edhe ligësitë e arsytimit të atyre që e mohojnë Krijuesin rregullimtar dhe mëtojnë se Gjithësia qenka krijuar vetiu. Ky Profesor i lartë, me frazën e fundit a nuk i shtrohet ajetit të madhërueshëm: *“A ka dyshim në Qenien e Zotit?”*

* ** *

Na duket vendi i përshtatshëm të paraqesim tani në formë deduksioni studimet e Dr. Gustav ZHULJESË për inspirimin (frymëzimin) e kafshëve. Doktor Zhulje, me veprën që ka hartuar kundër Darwinizmit e kundër përkrahësit të tij, Lamarkut, dëfton se zbulimet e reja janë kah udhëtojnë drejt idesë së divinitetit (hyjnorisë, të qenies së Zotit). G. Zhulje thotë: Frymëzimet që shihen në jetën e kafshëve, siç dihet, janë të panumërta. Edhe habia e mendjes përpara këtyre frymëzimeve është e pakufishme. Këto frymëzime i karakterizon një veçori e përbashkët: përpjekja për të siguruar jetën, por kjo përpjekje rrjedh vetvetiu e nuk është përfundimi i ndonjë arsytimi logjik të shtazëve. Frymëzimi natyror e përcjell kafshën në një finalitet (përfundim), ku nuk mund ta çojë as mendja, as edukata, as koha e gjatë. Me fuqinë e këtij inspirimi, çdo kafshë ruan individualitetin (vetësinë) dhe farën e saj. Duket se inspirimi është njësoj tek të gjithë individët e llojeve shtazore. Që ta tjetërsosh këtë inspirim është aq punë e vështirë sa tjetërsimi i llojit; prandaj themi se inspirimi është cilësia karakteristike dhe thelbësore e çdo lloji. Inspirimet shtazore janë të ndryshme, ashtu si ndryshojnë edhe organizmat fizikë të llojeve. Çdo inspirim i

përshtatet natyrës së llojit. Inspirimet nuk janë as pasojë e seleksionimit, sikurse pretendon Darvini, e as pasojë e mjedisit sikur thotë Lamarku. Atje ku shfaqet më qartë inspirimi ndër qeniet e gjalla është jeta e insekteve.

Dr. Faber*, në librin e tij që flet mbi jetën e kafshëve, ka provuar se me anën e teorive të Darvinit e të Lamarkut *është e pamundur të analizosh shkallën e ndryshimit të inspirimit të insekteve e patundshmërinë e këtij inspirimi*; në këtë të provuar ka parashtruar shumë argumente sensibilizuese

(ndjeshmëruese). Bergson*, dijetari i shkëlqyer i shekullit tonë (shek. XX) ka zbuluar një insekt të vogël me emrin *sitaris*, i cili i lëshon vezët e veta në çerdhen e një blete që quhet *entofer*. Nga këto vezë dalin dy krimba që rrinë në pritë dhe, porsa afrohet bleta mashkull, i ngjiten dhe jetojnë si parazitë në trup të saj (mashkullit) derisa vjen koha e çiftëzimit të bletëve. Kur përfundon procesi i çiftëzimit të bletët, krimbat shpërngulen nga meshkujt dhe u ngjiten bletëve femra, ku rrojnë si parazitë derisa pjellin bletët. Me të pjellë të këtyre bletëve, paraziti hiqet nga *bleta* femër dhe zë vend në vezët e bletës e kur çelin vezët, paraziti plotëson metamorfozën e parë dhe tani ushqehet me mjaltë.

Sa mrekulli! Sitarisi e di se në hojen (huallin) e bletës më parë kalon mashkulli; e di edhe se mashkulli do të takojë me femrën kur çiftëzohen; e di se femra bën vezët; e di, më në fund se aty në atë çerdhe bleta do të sjellë edhe mjaltë. Habia më e madhe është se sitarisi ka dijeni se pjella di t'i ndjekë këto faza. Shekulli modern, duke hetuar dukuri të habitshme të inspirimeve shtazore, po i detyron dijetarët t'i binden me

* **Faber** (Fabre, Fahbuhr, Jean Henri Casimir 1823 – 1915) natyralist francez, u mor tërë jetën me studimin e kandrrave dhe të merimangave.

* **Bergson Anri** (Bergson Henry, 1859 – 1941), filozof francez.

hir e me pahir Madhështisë së Zotit. Çelësin e këtyre zbulimeve të mrekullueshme ia ka dhënë Kur'ani i Madhëruar, i cili urdhëron në këtë ajet: *"Hatta idha eteu ala uadin nemli kalet nemletun ja ej-juban nemlud-khulu mesakinekum la jahtimennekum Sulejmanu ue xhunuduhu ue hum la jesh'urun"*, që do të thotë: Kur Hazreti Sulejmani me ushtrinë e tij arritën në një vend ku kishte shumë thnegla, një thnegël u tha shoqeve: *"O thnegla, hyni në tëbanat tuaja e mos rrini jashtë, që të mos ju shtypin Sulejmani e ushtarët e tij, që nuk dinë (se jeni ju këtu)."* (Sure "En Neml", 18)

Me këtë mënyrë Kur'ani i lartë, katërmbëdhjetë shekuj më parë na njofton punët e habitshme të insekteve dhe kjo gjë për njerëzit modestë e inteligjentë është një provë e qartë që dëshmon se burimi i kulturës së Hazretit Muhammedit është amshimi.

Himenoptera

(Hymenopteres Gaboyeurs)

Një tjetër gjallesë e habitshme, që dëshmon qenien e një Krijuesi Parashikues, është himenoptera.

Ky insekt, kur del prej veze, ka nevojë të ushqehet prej një qenieje tjetër të gjallë, e cila duhet që të mos lëvizë fare; përndryshe, po të lëvizë para çeljes dëmton vezët, e pas çeljes dëmton kandrrën (insektin, gjallesën e lindur). Nëna, që ta shmangë këtë rrezik, gjahun që zë, e injekton (i fut helmin) me një mënyrë që t'ia pengojë vetëm lëvizjen e jo ta mbysë. Kjo gjallesë e vogël, për të arritur në qëllimin që u përmend, po të kishte pasur idenë e parashikimit, do të gjykohej se ka dituri tepër të hollë, sepse që t'ia zhdukë gjahut të saj mundësinë e lëvizjes, duhet të dijë sasinë e helmit që lypset t'i injektojë për këtë qëllim.

Helmi nuk duhet të jetë as më tepër, as më pak, veçse aq sa lypset; përpjesëtimi i helmit ndryshon edhe sipas strukturës së presë. Në anën tjetër, për të caktuar edhe vendin se ku duhet të bëhet injeksioni, lypsen edhe njohuri të hollësishme për anatominë e fiziologjinë. Mirëpo, insekti i vogël nuk e ka mësuar prej kujt mjeshtërinë e hollë e të çuditshme sepse nuk i sheh fare prindërit e vet, të cilët kanë ngordhur para se të lindte pasardhësi, ashtu sikurse do të ngordhë edhe ky para pasardhësve të vet. Merret vesh, pra se veprimet e çuditshme që vihen re te himenoptera, nuk janë rezultat imitimi, as edukimi; përkundrazi, janë cilësi që gjenden në natyrën e insektit. Para veprave të këtij insekti përulet mendja e njeriut dhe pohon se udhëheqësi i këtij insekti është frymëzimi i Zotit.

Natyralistët thonë se ky inspirim është zakon shtazor që formohet dalëngadalë dhe, kur plotësohet, i mbetet trashëgim pjellës së re.

Faberi, që është një nga ata që kërkojnë hollësi për çdo gjë, *pretendimin e natyralistëve e gjen absurd (të pabazuar)* dhe thotë se, sado supozime që të pranojmë për nënën e parë të kësaj shtaze, prapëseprapë do të jemi të paaftë për të provuar origjinën dhe burimin e inspirimit që shfaqet te kjo gjallesë.

O natyralistë!

Rasti dhe nevoja - ashtu qëllon dhe ashtu e deshi nevoja - që i keni pranuar si fillim dhe burim të të gjitha ngjarjeve të natyrës kurrsesi nuk mund të na e shpjegojnë se si femra e parë e *himenopterës* mundi të gjente qendrën e sistemit nervor të gjahut të vet që kështu, të mos e mbyste prenë, por t'ia dobësonte funksionin e nervave që shkaktojnë lëvizjen. Nuk ka asnjë shkak që ta shtyjë këtë insekt të parapëlqejë qendrën nervore. Përse nuk mësyu më sipër ose më poshtë? Nuk mund të thoni: ky insekt, mbasi e mësyu prenë e saj në disa

vende, ia qëllloi edhe qendrës nervore, sepse po të mos e qëllonte shenjën për herën e parë, ishte në rrezik. Insekti është i pagabueshëm në veprimin e tij, për të siguruar ushqimin e pjellës.

Me këto studime të gjata *Faberi na provon se natyra e krijuar te kafshët nuk është pasojë e rastit dhe e nevojës që ka qëlluar verbërisht e papandehur*. Dr. Gustav ZHULJE që na transmeton studimet e FABERIT, thotë se është e pamundur të shpjegohet se si e përdor ky insekt gjilpërën e injeksionit - thumbin e helmit - e si u duk në krye të herës kjo kafshë e vogël.

U zgjatëm mjaft me këtë çështje; prandaj, që ta mbyllim, themi se nga studimet plot kompetencë të dijetarëve që përmendëm, del që *teoritë për agjentët e natyrës që zhvilluan krijesat e Gjithësisë - teori të shpifura nga fantazia e Darvinit dhe e Lamarkut**, janë kryekëput sofizma.⁶¹ Kur përpara mendjes sonë parakalojnë ngjarjet e ndryshme e të shumëllojshme të mbretëreshës “Gjithësi”, nuk mbetet rrugë tjetër, përveçse t’ia atribuojmë Mjeshtërit dhe Krijuesit të Amshuar. Të gjitha këto çudira janë vepra të atij Zoti të madh që na e shpjegon Kur’ani me fjalën e Hazreti Musait në këtë ajet: “*Rabbunal ledhi a’ta kul-le shej-in balkahu thumme beda*” që do të thotë: **“Zoti ynë është Ai që krijoi çdo gjë, pastaj e drejtoi.”** (Surja “TaHa”, 50)^{62 63} Prandaj: **“A ka dyshim në qenien e Zotit?” i përgjigjemi: Me të vërtetë, nuk ka dyshim në qenien e Zotit. Prandaj duhet të besojmë se ka Një Zot.**

XII

Zotërinj!

* **Lamark** (Lamark), botanist zoolog francez (vdiq më 1829).

⁶¹ *sofizëm argumentim ose përfundim logjik që duket i drejtë nga ana e jashtme, por që në thelb është i gabuar dhe përdoret për të shtrembëruar të vërtetën..*

⁶² *Shih edhe këtë përkthim: “Zoti ynë është Ai që i dha trajtën dhe natyrën e saj çdo gjëje (të krijuar) dhe më tej, i dha drejtimin (udhëbëqësinë).”*

⁶³ *Allahu e jep udhëbëqësinë e Tij me anë të të Dërguarve të Tij dhe të Shenjave të Tij.*

Kemi folur mjaft për temën tonë, “A *ka dyshim në qenien e Zotit?*”. Për të provuar se ka Një Zot, kemi parashtruar mjaft argumente mendore e dogmatike (***akli*** e ***nakli***).

Në analizën e fundit shtrohet edhe një herë pyetja: A ka ndonjë subjekt që e konsideron evidente propozitën “A ka dyshim në qenien e Zotit?”?

Në qoftë se ka, kush është? Ndër myslimanët ka një sekt mistik, sufitet, te besnikët e të cilit mbisundon shija. Sipas tyre, kush ia përshtat shijen shpirtërore Zbulesës profetike, në sy të Islamit numërohet njeri që ka zbuluar të vërtetën dhe shenjtërohet. Kryetarët e këtij sekti e quajnë evidente propozitën tonë. Udhëheqësin e sufiteve, Xhunejdin* nga Bagdadi, (iu shenjtëroftë sekreti) e pyetën: “-*Me ç'provë vërtetohet Krijuesi?*” Xhunejdi iu përgjigj: “-*Mëngjesi nuk ka nevojë për kandil.*”

Kryetarët e lartë të këtij sekti thonë se “*Zoti nuk duket sepse ka dalë shumë në shesh. Një gjë, kur e kalon kufirin, merr fytyrë të kundërt.*”

Edhe Hafiz Shiraziu thotë: “*Ai mik, veç të cilit nuk kam tjetër (mik), në lulishten e paraqitjes së Tij nuk ka ferra për mua. Sadoqë e vërteta e Tij është e fshehtë, në madhësinë e Vetes së Tij nuk ka fshehtësi.*”

Sipas sufiteve të vërtetë “*Hakku duket kudo*”⁶⁴. Prandaj, Muhjiddin Arabiu në kreun e Teuhidit, në “Fusus” thotë kështu:

“*Inne lil-hakki fi kul-li khalkin dhuhuren khassan fe huuedh-dhabiru fi kul-li mefhumin uehuuel-batinu an kul-li fehmin....*”

* **Xhunejdi**: Ebu'l Kasim ibn Muhammed ibnu'l Xhunejd el-Hazzazi: me prejardhje iraniane, i lindur në Nahavend. Gjatë jetës së tij, Xhunejdi ka qëndruar në Irak, në Bagdad, ku edhe vdiq në vitin 909. I është dhënë ofiqi shejhu 't taife (prijësi i grupit sufist).

⁶⁴ Hakku=Zoti

"ان للحق في كل خلق ظهورا فهو الظاهر في كل مفهوم و هو الباطن عن كل

فهم... " (فصوص الحكم (عفيفي)، ص 68)

Zoti ka një të shfaqur të posaçëm në çdo krijesë të Vetën (ka krijuar një mënyrë për t'u kuptuar, për t'u parë nga krijesat e veta). I Madhi Zot në çdo gjë të kuptueshme është i shfaqur dhe në çdo kuptim është i padukur e i fshehtë, sepse fuqia kuptimore e njeriut nuk është e aftë për të kapur të gjitha dukuritë e shkaqet e Zotit.

Një dijetar ka thënë: "*Në bukurinë që duket në çdo çast është fshehur përsosuria e Zotit, veçse, po t'ia them kujt bukurinë e Zotit që duket, do të dilnin njëqind ngatërresa.*".

Këto fjalë dëftojnë se bukuria dhe hija e Zotit është në shesh, por mendja e njeriut nuk e kupton dot.

Disa teologë thonë se është e mundur me e njoftë *zatin* e Zotit, ⁶⁵ por Imam Gazaliu* e Imamul Haremejni (Xhunejdi) dhe filozofë të tjerë janë në një mendje me sufitet për pamundësinë e njohjes së zatit të Zotit dhe rruga e vërtetë kjo është. Përse fuqia e mendjes së njeriut nuk e kupton ç'është *zati* i Zotit?

Përgjigjja është e lehtë. Që ta kuptojmë diçka duhet ta përfshijmë me mend. Mirëpo, krijesa është e përfshirë e Krijuesi është përfshirës. Pra, është e pamundur që e përfshira ta kuptojë përfshirësin.

Nga shkoqitjet që kemi dhënë deri këtu u vërtetua qenia e Zotit dhe gabimi i ateistëve. Edhe paganizmi është doktrinë e shtrembër, sepse Zoti është Një i Vetëm e mendja kurrsesi nuk mund ta pranojë ndryshe. Po të supozonim se kishte disa

⁶⁵ *zat*, nga arabishtja *dhatun* ka kuptimin zotërues; thelb, esencë. (shih se është shjeguar edhe më parë)

* **Ebu Hamid el- Gazali:** Ebu Hamid Muhammed el Gazali. Lindi në Tus të Horasanit, Persi, më 1058. Libri më i madh dhe më i famshëm i Gazaliut është "*Ihja Ulumi Din* – (Përtëritja e diturive fetare).

zota, atëherë këta (zota) ose kanë bashkëpunuar në krijimin e Gjithësisë, ose secili ka pasur pushtet të krijojë vetë. Në pranofshim të parën, vërtetohet pazotësia e secilit, pasi asnjëri nuk mundi ta krijonte vetë Gjithësinë, por pati nevojë për shokë. Në pranofshim të dytën, atëherë asnjëri nuk ka nevojë për shokun, bie fjala, në qoftë se e krijoi Gjithësinë njëri, të tjerët nuk lypsen.

Në rastin e parë, *dihen pranuar zota pa pushtet*, kurse, në rastin e dytë, *zota të panevojshëm*. Asnjëra nga këto cilësi nuk i përshtatet Zotit. Zoti duhet të jetë i plotë e i përsosur në çdo pikëpamje e i tillë, është vetëm Allahu.

Për të na përcjellë në këtë vendim të peshës mendore, Kur'ani parashtron shumë fakte.

Ideja e Unitetit të Amshuar ⁶⁶ ka lindur bashkë me njeriun, që predikon; prandaj e pranon atë natyra e njeriut, gjykimi i shëndoshë. Paganizmi e ateizmi janë gabimet e imagjinatës e të fantazisë. Kjo, zatën, kështu duhet të jetë dhe kështu e lyp arsyeja. Pa thënë një, s'thuhet dy e tre. Kur'ani, me shumë ajete argumenton se baza e feve është Uniteti.

Disa filozofë modernë janë kundër komunikatës hyjnore dhe thonë se njeriu nuk ka aftësi për të kuptuar një Zot.

Monoteizmi është rezultat i evolucionit të politeizmit e të paganizmit. Kjo teori që përhapur aq tepër saqë, po ta kritikoje ose po ta kundërshtojë atë, konsiderohej një guxim i madh.

Mirëpo gjermani i famshëm **Maks Myleri**, duke bërë fjalë për fetë e Orientit, në librin e tij "**Origjina e përparimi i fesë**", ⁶⁷ thotë:

“Në kohët primitive, njeriu ka adhuruar një Perëndi të kulluar, pa trup, pa vend e pa kohë. Politeizmi ka ardhur pas monoteizmit të kulluar (të

⁶⁶ e Njësisë së Zotit, se Zoti është Një

⁶⁷ Origjina e fesë dhe përparimi i saj

pastër). *Politeizmi është një doktrinë e krijuar nga intrigat e parisë fetare.*” Siç merret vesh, në shekullin XX një ushtimë filozofike po jep tallaze nëpër qiell në favor të Kur’anit të shenjtë e të shenjtërisë së predikimeve të tij.

“*Ue le ta’lemunne nebe-ebu ba’de hin*”. Pas një kohe do ta merrni vesh lajmin e Kuranit. (Surja “Sad”, 88)⁶⁸

* * * *

Për ta përfunduar fjalën tonë, po bëjmë një përmbledhje të temës që shkoqitëm. Ajeti i lartë: “*Kalet Rusuluhum e fil-lahi shekkun?*” “Tu thanë profetët - A ka dyshim në qenien e Zotit?” Me tekstin e tij, Kur’ani na dëfton se detyra e profetisë është të udhëheqë njerëzinë në rrugë të drejtë. Ky ajet me *isharet*, na mëson se besimi në Zotin është një dogmë e drejtë; me *delalet*, na mëson se mohimi i Zotit kërkon që të mohohet edhe krijesa. Me *iktida* në fund, na mëson se duhet besuar edhe në misionin profetik. Këtë besim na urdhëron Kur’ani. Besimi (imani), sipas Teftazaniut është trishkallësh: Besimi i imituar (*imani taklidi*); besimi me mbushamendje (*imani tahkiki*) dhe besimi me vështtrim (*imani ‘ajni*).

Besimi me imitim është besimi që nuk mbështetet në dituri e në kulturë, por që vjen duke parë të tjerët që e ushtrojnë. Shumë sekte islame nuk e pranojnë si të saktë këtë besim; edhe ajo pjesë që e njeh, që e pranon këtë farë besimi, mbështetet vetëm në mëshirën e madhe të Zotit; pra, është besimi i shkallës më të ulët. Besimi me mbushamendje është dy farësh: me arsyetim edhe me shijim. Besimi me arsyetim është ai që formohet me bindje duke hetuar rregullimin e Gjithësisë. Besimi me shije është dy farësh: i zbuluar e i pazbuluar. I zbuluar quhet ai besim që zbulon të fshehtën pa

⁶⁸ Shih edhe këtë përkthim: “Dhe ju, sigurisht do ta dini (do ta mësoni) të vërtetën e saj shumë shpejt.” Kuptimi, besojmë të jetë ky: Ka shumë gjëra që mund të mos i kuptojmë plotësisht. Por, vetëm po ndoqëm Rrugën e Drejtë, do ta arrijmë qëllimin në Jetën e Përtejme dhe atëherë, gjithçka do ta kemi të qartë.

e kaluar kufirin e shkencës. I pazbuluar quhet ai besim, me të cilin njeriu zbulon të fshehtën përtej gardhit të shkencës. Besimi me vështirim është besimi kur njeriut i hapen të gjitha perdet dhe e sheh të Vërtetën pa ndonjë pengim. Besimi me arsyetim na përfton bindjen shkencore (*ilmel jekin*); besimi i zbuluar na përfton bindjen me të parë (*'ajnel jekin*); besimi me vështirim na përfton bindjen e vërtetë (*hakkal-jekin*). Sejjid Sherifi (iu shenjtëroftë sekreti) i fllon tri shkallët e bindjes me këtë mënyrë: Dituria e njeriut se do të vdesë është bindja shkencore (*ilmul jekin*), shikimi i melekëve të vdekjes në mbarim të jetës është bindje me të parë (*'ajnul-jekin*) dhe vetë vdekja është bindje e vërtetë (*hakkul-jekin*). Allahu na bëftë nga besimtarët e *hakkul jekinit*! Amin!

FUND

DËFTUESI I LËNDËS

- 1- PARATHËNIE.....
- 2- HAXHI HAFIZ ISMET DIBRA.....
- 3- Ç'ËSHTË KUR'ANI?.....
- 4- A KA DYSHIM NË QENIEN E ZOTIT?.....